

Fjala e redaksisë

“Thirr në rrugën e Zotit tënd me mençuri e këshillë të bukur dhe diskuto me ta në mënyrën më të mirë.” (Kuran, 16:125)

Pesë vjet më parë, duke u nisur nga ky parim kuranor, e pamë të udhës ta hapnim një portal elektronik, që përmes tij ta njoftojmë popullin tonë me mirësitë dhe veçoritë e Islamit, fesë së Krijuesit të Madhërishtëm. Emrin ia patëm vënë “Shembulli”, duke pasur për qëllim me këtë krijesën më fisnike, Muhamedin, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, i cili vërtet është shembull për mbarë njerëzimin, madje në çdo çështje, siç thotë i Lartësuari në Kuran (33:21): *“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.”*

Rrjedhimisht jemi të urdhëruar ta pasojmë atë, nëse duam ta fitojmë dashurinë e Allahut, i Cili thotë: *“Thuaj (o Muhamed), nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t’ju dojë dhe t’jua falë mëkatet. Allahu është Falës i madh dhe Mëshirëplotë.”*(Kuran, 3:31)

Ndërkaq, Allahut i takon falënderimi dhe lavdërimi, i Cili na e mundësoi që tashmë ta qesim në dritë edhe këtë revistë periodike edukative e kulturore me të njëjtin emër, të cilën e pasuruam me tema të llojllojshme, në mënyrë që gjithsecili të gjejë në të sadopak atë që i intereson e kështu ta kënaqë kërshtërinë e tij.

Shembulli, në radhë të parë, e synon paraqitjen në mënyrë të duhur të mirësive të Islamit, që t’i njoftojë lexuesit me veçoritë e mrekullueshme të kësaj feje madhështore dhe njëherazi ngritjen e vlerave të mirëfillta, të cilat e zbukurojnë atë që pajiset me to.

E lusim Zotin të na e mundësojë që gjithnjë të jemi shembull i së mirës duke ndjekur shëmbëlltyrën e njerëzimit, Muhamedin, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, dhe të na bëjë thirrës në fenë tonë të vërtetë e të na pajisë me urtësi e këshillë të mirë!

Shpresojmë që ajeti vijues të na përfshijë edhe ne:

“E kush është më fjalëmirë se ai që i fton njerëzit drejt Allahut, bën vepra të mira dhe thotë: “Unë, me të vërtetë jam musliman.”(Kuran, 41:33)



shembulli

Revista “Shembulli”

Kryeredaktor:

Jusuf Kastrati

Redaksia:

Xheladin Leka

Fehmi Maloku

Jeton Koçinaj

Arsim Sylja

Jusuf Kastrati

Redaktor gjuhësor:

Jeton Koçinaj

Përgatitja kompjuterike:

Dorlir Kraja

E DO LUM

E do lum

IJD EL-INEZI

Vëlla dhe ti, motër! Kujto se nuk je duke jetuar në jetën e lumturisë, porse në një jetë përplot me rreziqe e brenga. Mjafton ta kuptosh realitetin e saj, kur kujton se ajo është burg për besimtarët dhe Xhenet për jobesimtarët.

Pyete veten edhe sa të ka mbetur për të jetuar, e sa shpreson të jetosh! Njëzet vjet? Dyzet? Apo më tepër?!

Vallë, si mund të shpresosh kaq gjatë kur sheh se befasitë po i godasin njerëzit ditë e natë?!

Medito rreth kësaj thënieje të të Dërguarit tonë, Muhamedit, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, sikur të jesh ti ai të cilit i drejtohen këto fjalë: “Jeto sa të duash, do të vdesësh! Duaje kë të duash, do të ndahesh prej tij! Puno ç’të duash, atë do ta gjesh!”

Paramendo se meleku i vdekjes të ka ardhur në këtë çast për të ta marrë shpirtin! A do të pajtohesh të vdisje në këtë gjendje?!

A ke menduar, vallë, për natën tënde të parë

në varr, ku do të qëndrosh i vetëm dhe kur dheu të bëhet shtrati yt? Kur bukuria jote të zhduket, kur epshet e tua të largohen dhe të mbesin vetëm keqardhja dhe pasojat?!

A mos e dëshiron Xhenetin dhe begatitë e tij, ndërkohë vazhdon të këmbëngulësh në mëkate?! Apo, mos vallë, e dëshiron lumturinë e kësaj bote dhe të tjetrës, e nuk largohesh nga shejtani dhe partia e tij?!

Shumë njerëz janë mashtruar nga butësia e Allahut dhe mëshira e Tij e gjerë. Ndërkaq kanë harruar se dënimi i Allahut është i ashpër dhe Ai është i Plotfuqishëm, Shpagimtar. Të tillët nuk punuan për ta fituar mëshirën e Allahut, por bënë vepra me të cilat arrihet hidhërimi dhe dënimi i Tij i dhembshëm.

Paramendo se i ke arritur të gjitha kënaqësitë dhe epshet e kësaj bote, kurse përfundimi yt të jetë Zjarri. A mendon se do të të kujtohen begatitë e kaluara duke qenë në Xhehenem?!

Kujtoje ditën kur kundër teje do të dëshmojnë dëshmitarët. Kur lëkura dhe

TURINË?!

Turinë

gjymtyrët e tua do të të zbulojnë... a do të gjesh vend për të ikur?! Dëshmitarët prej teje, kurse dëshmia kundër teje...! Shih pra, o njeri i giorë. Gjymtyrët me të cilat e për të cilat po i bën mëkate Allahut, në Ditën e Kiametit, do të dëshmojnë kundër teje!

Prandaj, falënderoje Allahun që ta ka zgjatur jetën dhe nuk ta ka marrë shpirtin duke qenë në humbje, devijim dhe pakujdesi!

Pendohu pra menjëherë dhe hiqe nga vetja pluhurin e pakujdesisë. Dije se porta e pendimit është e hapur, se Allahu është Bujar dhe se të mirat e kësaj bote shkojnë e vijnë! Gjithashtu ta dish se ai që pendohet për mëkatin është sikurse ai që nuk ka bërë fare mëkat, se Allahu veprat e këqija t'i shndërron në të mira dhe se Ai i gëzohet pendimit tënd!

Për fund, i përgëzoj të penduarit se Allahu i Madhërishëm i do ata.

Ai thotë në Kuran: "Me të vërtetë, Allahu i do ata që pendohen dhe ata që pastrohen."

Tashmë, a e kuptove se sa e madhe është fatkeqësia dhe sa e rëndë është çështja?!

"JETO SA TË DUASH,
DO TË VDESËSH!
DUAJE KË TË DUASH,
DO TË NDAHESH
PREJ TIJ! PUNO Ç'TË
DUASH, ATË DO TA
GJESH!"
—HADITH—

FEJA E SË VËRTETËS, SË MIRËS DHE SË BUKURËS

DR. XHAFFER SHEJH IDRIS

Islami është feja e së vërtetës, së mirës dhe së bukurës, ngase është absolutisht i vërtetë, plotësisht i mirë dhe tërësisht i bukur. Në të nuk ka kotësi, nuk ka ligësi dhe nuk ka shëmti, kurse në fetë e tjera e vërteta përzihet me të kotën, e mira me të keqen dhe e bukura me të shëmtuarën.

Islami është feja e së vërtetës, së mirës dhe së bukurës, për shkak të harmonizimit që ua bën këtyre tri vlerave, duke ia dhënë secilës vendin që i takon dhe duke i bërë mbrojtëse e ndihmëse të njëra-tjetrës. Një gjë e tillë nuk haset te doktrinën, kulturat dhe fetë e tjera, ngase atyre u japin pozita kundërthënëse dhe armiqësore, që e shkatërrojnë njëra-tjetrën në vend se ta ndihmojnë e ta përkrahin. Në bukurinë e arteve arsyetimin “ligjor” e shohin si mjet shpifjeje dhe rrënim vlerash; në bukurinë e shprehjes, qoftë poezi apo novelë, e shohin


mundësinë e fabrikimit të gënjeshtreve, promovimit të të këqijave si dhe shfaqjes publike të tyre.

Islami është feja e së vërtetës, së mirës dhe së bukurës, ngase Ai, për adhurimin e të Cilit na thërret, është i vërteti, Ai që e bën të mirën, Ai që është i bukur, bukurisë së të Cilit nuk i afrohet dot asnjë bukur. Allahu i Madhëruar është e vërteta e madhe, të cilës nuk i afrohet dot asnjë e vërtetë; Ai është i Pari pa fillim, i Fundit pa mbarim. Ai është i Dukshmi mbi të Cilin nuk ka asgjë, dhe i Padukshmi nën të Cilin nuk ka asgjë, Ai është Krijuesi i çdo gjëje. Zoti ynë është e mira në tërësi dhe e gjithë e mira është në dorën e Tij, kurse e keqja nuk i atribuohet Atij. Zoti ynë është i bukur dhe e do të bukurën.

I Dërguari, të cilin Ai na e dërgoi, është i vërtetë: ia njohim prejardhjen, lindjen,

“ISLAMI ËSHTË FEJA E SË VËRTETËS, SË MIRËS DHE SË BUKURËS, NGASE ËSHTË ABSOLUTISHT I VËRTETË, PLOTËSISHT I MIRË DHE TËRËSISHT I BUKUR. NË TË NUK KA KOTËSI, NUK KA LIGËSI DHE NUK KA SHËMTI, KURSE NË FETË E TJERA E VËRTETA PËRZIHET ME TË KOTËN, E MIRA ME TË KEQEN DHE E BUKURA ME TË SHËMTUARËN.”

formimin e tiparet. Madje, dimë aq detaje rreth tij, saqë askush tjetër në tërë botën nuk di për tjetërkënd. Ai nuk është si ata liderët e pretenduar në disa fe, ithtarët e të cilëve në disa raste nuk kanë as dëshmi historike se kanë ekzistuar. I Dërguari ynë ka qenë i pajisur me të gjitha tiparet e së



mirës, madje Allahu i Madhëruar për të ka thënë: “Ti je me virtyte madhore.” (El-Kalem, 4)

Gruaja e tij, Aisheja, që e njihte hollësisht, thoshte për të: “Morali i tij ishte Kurani!” (Shënon Ahmedî)

Ai ka qenë njeri i drejtë, besnik, i mëshirshëm, trim e durimtar. Ai i përmbushte premtimet, e mbronte të vërtetën dhe ishte me të çdoherë. Përveç Allahut, askujt nuk ia kishte frikën për ta thënë atë. Kishte pamje të bukur, shpirt të pastër dhe bisedë të ëmbël. Ai ishte njeri që gëzonte respekt.


Kurani fisnik, të cilin Ai na e shpalli, e flet të vërtetën, udhëzon në të, urdhëron për të mirën dhe ndalon nga e keqja, dhe krejt këtë e shpreh me një gjuhë e cila është në majë të elokuençës dhe retorikës: “Ne e kemi shpallur Kuranin me të vërtetën dhe ai ka zbritur me të vërtetën.” (El-Isra, 105); “Elif, Lâ, Mîm. Ky është Libri në të cilin nuk ka dyshim. Ai është udhërrëfyes për

të devotshmit.”(El-Bekare, 1-2); “Atij nuk mund t’i afrohet gënjeshtria nga asnjëra anë. Kjo është shpallje prej një të Urti që meriton të gjitha lavdet.”(Fussilet, 42); “Në të vërtetë, ky Kuran udhëzon drejt asaj që është më e miradhe u jep lajmin e gëzuar besimtarëve, që bëjnë vepra të mira, seata do të kenë shpërblim të madh.” (El-Isra, 9); “Të përkryera janë fjalët e Zotit tënd në vërtetësi dhe drejtësi; fjalët e Tij askush nuk mund t’i ndryshojë. Ai dëgjon çdo gjë dhe di çdo gjë.” (El-En’am, 115)

Kurani është i saktë në lajmet që rrëfen, i drejtë në urdhrat që jep dhe ndalesat që bën. “Allahu ka shpallur Fjalën më të bukur (Kuranin)...” (Zumer, 23)

Ai nuk është si librat e feve të tjera, në bazat, përkthimet dhe botëkuptimet e të cilave dyshojnë edhe vetë ithtarët e tyre.

Meqenëse këto tri vlera (e vërteta, e mira dhe e bukura) harmonizohen në Zotin e adhuruar, Profetin e dërguar dhe Librin e shpallur, atëherë më së miri do të ishte që të jenë të tilla (të gërshetuara) edhe në jetën e njerëzve. Andaj, këto vlera në Librin e Allahut dhe në Sunetin e të Dërguarit ne i gjejmë të përputhura me njëra-tjetrën:



-virtytet morale përshkruhen me bukuri: “...durim i mirë. Allahut i kërkoj ndihmë kundër asaj që po tregoni ju.” (Jusuf, 18); “Prandaj, duro, me durim të hijshëm.” (El-Mearixh, 5)

-fjala përshkruhet me të mirë, e cila është botëkuptim estetik. E, po me të përshkruhet edhe vepra: “Largoje të keqen me atë që është më e mira...” (El-Mu'minun, 96); “...dhe njerëzve do t'u thoni fjalë të mira...” (El-Bekare, 83); “Ti (Muhamed) thirr në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të bukur dhe diskuto me ta (kundërshtarët) në mënyrën më të mirë...” (Nahl, 125)

Nuk ka mospërputhje ndërmjet përfitimit prej ndonjë gjëje dhe shijimit të bukurisë së saj, madje kështu edhe duhet të jetë: “Kafshët Ai i ka krijuar për ju. Njëpërmjet tyre ju siguron rroba të ngrohta dhe dobi të tjera. Prej tyre ju ushqeheni dhe shikoni pamje të bukura, kur i ktheni nga kullota dhe, kuri nxirrni në kullotë. Ato mbajnë barrët tuaja deri në vende të largëta, tek të cilat ju do të arrinit me mundim të madh; me të vërtetë, Zoti juaj është i Butë dhe Mëshirëplotë.” (Nahl, 5-7); “Ata thanë: “Lutju Zotit tënd që të na shpjegojë çfarë


ngjyre të ketë ajo!” Musai tha: “Ai thotë se ajo duhet të jetë lopë me ngjyrë të verdhë të ndezur, të cilën e pëlqejnë shikuesit”. (Bekare, 69); “A ka më të mirë se Ai që ka krijuar qiejt dhe Tokën dhe lëshon për ju nga qielli ujë, me të cilin krijon kopshte të mrekullueshme?! Ju nuk mund t'i bëni pemët të rriten (pa këtë ujë). Vallë, a ka krahas Allahut zot tjetër?! Jo, por ata janë njerëz që i veshin (Allahut) të barabartë me Atë!” (Neml, 60)

Meditorreth këtij ajeti fisnik në të cilin Allahu i Madhëruar na urdhëron të shikojmë-vështrojmë në frytet e bimëve dhe pjekjen e tyre. “...Vështroni frytet e tyre kur formohen dhe piqen...” (El-En'am, 99)

Shikimi dhe vështrimi në këto fryte nuk mund të jetë i zhveshur nga bukuria dhe kënaqësia e syrit. Ashtu siç janë fakte hyjnore krijimi dhe ushqimi me to, fakt është edhe bukuria e tyre, ama për ata që besojnë. Shih se si Allahu i Madhëruar e ka sinkronizuar urdhrin për t'i shikuar këto fryte me urdhrin për ta dhënë zekatin: “... hani frutat e tyre kurdo që të prodhojnë dhe jepni atë që është detyrë në ditën e vjeljes së tyre!...” (El-En'am, 141)

Fatlum është ai që ka grua tek e cila gërshetohen morali i mirë me dukjen e bukur: “...ajo që, kur e shikon, të gëzon; kur e urdhëron, të bindet dhe kur ti nuk je i pranishëm, ajo e ruan pasurinë tënde dhe veten e saj.” (Shënon Ibn Maxhe)

Këto vlera, ashtu siç përshkruhen me njëra-tjetrën, në fenë tonë janë edhe mjete të njëra-tjetrës. Kështu, thirrjen në të mirë patjetër duhet ta bësh duke e ndërtuar mbi të vërtetën, e cila nuk mund të jetë ndryshe vetëm se e shoqëruar me të hijshmen dhe



THIRRJA ISLAME NUK ËSHTË NDRYSHE VETËM SE ME FJALË TË BUKURA, TË CILAT KËNAQIN VESHIN DHE E PUSHOJNË SHPIRTIN. “...DHE NJERËZVE U THUANI FJALË TË MIRA...” (EL-BEKARE, 83);

“TI (MUHAMED) THIRR NË RRUGËN E ZOTIT TËND ME URTËSI E KËSHILLË TË BUKUR DHE DISKUTO ME TA (KUNDËRSHTARËT) NË MËNYRËN MË TË MIRË...” (EN-NAHL, 125)

të bukurën. Ja për shembull, tregimet e Kuranit e kanë përmbajtjen dhe stilin më të bukur, por kurrsesi nuk janë pjellë e fantazisë dhe imagjinatës. Ato janë tregime të vërteta. Për t'u realizuar këshillat dhe mësimet etiko-fetare ato rrëfejnë realitete e nuk sajojnë të pavërteta. “Ne të tregojmë ty (Muhamed) historinë më të bukur...” (Jusuf, 3); “Në tregimet e atyre (të dërguarve) ka këshilla për ata që janë me mend. Ky (Kuran) nuk është tregim i trilluar, por ai është vërtetues i atyre (librave) që janë shpallur para tij, është shpjegues i çdo gjëje dhe udhërrëfyes e mëshirë për njerëzit besimtarë.” (Jusuf, 111)

Thirrja islame bëhetvetëm me fjalë të bukura, assesi ndryshe. Aso fjalë që e kënaqin veshin dhe e pushojnë shpirtin. T'i rikujtojmë ajetet e lartpërmendura: “... dhe njerëzve do t'u thoni fjalë të mira...” (El-Bekare, 83); “Thirr në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur dhe diskuto me ata në mënyrën më të mirë!” (Nahl, 125)

Por, fatkeqësisht disa nga vëllezërit tanë, Allahu i faltë!, thirrjen tek e vërteta dhe e mira më e madhe (adhurimi i Allahut

të Madhëruar dhe kapja për Sunetin e të Dërguarit) po e shoqërojnë me vrazhdësi dhe mënyrë të pasjellshme, pasojë e së cilave janë largimi dhe bezdisja e njerëzve të ndershëm prej tyre. Të tillët a nuk e kanë medituuar fjalën e Allahut të Madhëruar drejtuar të Dërguarit të Tij; “Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishte i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj falua atyre gabimin, kërkoji falje Allahut për ta dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme.” (Ali Imran, 159)

O Zot! Allahu i Madhëruar sikur po i thotë të Dërguarit të Tij: Po të vazhdoje të përshkruheshe me të gjitha tiparet e së mirës që posedon dhe të vazhdoje të thërrisje në të vërtetën në të cilën thërret, por duke u treguar i vrazhdë dhe i rëndë, njerëzit, të cilët tani janë me ty, do të të largoheshin. Po përse? Sepse ata janë të ndershëm dhe kanë respekt për veten e tyre, kështu që nuk pranojnë të nënçmohen dhe përbuzen, madje as nga një njeri që ka personalitet, siç ishte i Dërguari, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të. Por, jo të gjithë njerëzit janë kësisoj. Ka që nuk respektojnë vetëm se duke qenë

të nënshtruar dhe të nënçmuar. A nuk ka thënë Allahu i Madhëruar për popullin e Faraonit: “Kështu, ai e frikësoi popullin e vet. Ata iu nënshtruan atij, sepse ishin vërtet një popull i pabindur.”(Zuhruf, 54)

Sa bukur është thënë:

*Nëse e nderon të ndershmin, do ta përfitosh,
Por, nëse e nderon të pasjellsmin, do ta rebelosh.*

Thirrjes së të Vërtetës u përshtaten njerëzit e kategorisë së parë: të ndershmit. Ata janë që e besojnë, e bartin me përgjegjësi, me forcë dhe me trimëri, kështu që janë mu ata që na duhen kur i thërrasim dhe i ftojme. Ndaj, t'i thërrasim me metodën dhe mënyrën që u përshtatet, sepse vetëm kështu i afrojmë. Sa u përket të pasjellsmëve, që pajtohen me poshtërimin dhe nënçmimin, nuk ka mirësi tek ata dhe as që pritet ndonjë hair prej tyre.

Opozitë e tyre janë njerëzit që fjalën e butë dhe mirësjelljen i marrin si arsye për t'i vënë njerëzit në greminën e politeizmit dhe risisë (bidatit), ndërsa i lumtur është personi të cilin e ka bekuar Allahu për të thirrur tek Ai në mënyrën më të mirë.

Vetëm atëherë bukuria është e lëvduar dhe e preferuar. Ajo është shoqëruesja e së vërtetës dhe së mirës. Por, kur ajo del nga ky kontekst, respektivisht merret si mjet i rrënimt të vlerave, atëherë Islami e ndalon, atë dhe dëfrimin me të. Për këtë shkak ndalohet shikimi i disa imazheve a fotove të bukura dhe dëgjimi i disa zërave a melodive të tilla, ngase i shërbejnë të keqes, respektivisht merren si mjete për t'i tërhequr njerëzit kah politeizmi dhe amoraliteti. Për këtë është i ndaluar shikimi në gratë e huaja, ngase dëfrimi me bukurinë e tyre mund të jetë një nga

rrugët që çojnë në shkatërrimin e nderit dhe moralit. Por, kjo gjë (ndalesa) nuk vlen ndërmjet bashkëshortëve. Përkundrazi. Përderisa është dëfrim i lejuar, Islami thërret në të, madje e konsideron edhe si mjet të ruajtjes së nderit. Po kështu edhe zërat e bukur, të cilët mund të jenë shkak për t'i zgjuar ndjenjat e shpirtit apo për të shpërfillur ndonjë vlerë apo virtut moral. Zëri përkëdhelës i femrës apo ullaçimi i saj me zë të ëmbël mund të jetë tërheqës dhe t'i bëjë njerëzit të mendojnë për të, madje qofshin edhe gra të dërguarish. Për këtë shkak, Allahu i Madhëruar i ka ndaluar gratë e të Dërguarit, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, të bëjnë një gjë të tillë: ”O gratë e të Dërguarit! Ju nuk jeni si gratë e tjera. Nëse i frikësoheni Allahut, mos flisni me përkëdheli, që të mos ju dëshirojë ai që ka zemër e shpirt, por flisni drejt dhe në mënyrë të ndershme!”(El-Ahzab, 32)

Kështu mund të thuash edhe për mjetet dhe llojet e muzikës. Allahu i Madhëruar ka thënë: “Ka disa njerëz që sajojnë tregime të kota, për të shmangur (të tjerët) nga rruga e Allahut me paditurinë e tyre e për t'u tallur me të. Njerëz të tillë i pret dënimi poshtërues.” (Llukman, 6)

Ibn Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të) ka thënë: “Për Allahun, (me këtë ajet) është (për qëllim) muzika!”

Falënderimi i takon Allahut që na ka udhëzuar tek e vërteta, na i ka lehtësuar rrugët e së mirës, si dhe na ka bërë të dëfribemi me bukurinë e fjalës, krijimit dhe botëkuptimeve!

Përshtati: Dr. Sedat ISLAMI



Optimist :)

edhe pse në buzë të greminës!

XHELADIN LEKA

Përse të mos jemi optimistë? A mos ka thënë ndokush se optimizmi është i ndaluar? Apo, mos ndokush guxon të thotë se sot nuk ka vend për optimizëm...

Që kur pikëllimi, ankthi e verdhësia e fytyrës janë bërë shenjë e pandashme e muslimanit... Kush ka thënë, a kush do të pretendonte se fytyra e ngrysur është shenjë e imanit...

A ka kush brengoset më shumë për pasuesit e tij sesa vetë i Dërguari i Allahut? E si pra ai buzëqeshte, madje dhe qeshte, gëzohej, bënte shaka e luante me shokët e tij, kurse gjendja e tyre materiale nuk krahasohej me persianët dhe romakët, perandoritë e të cilëve konsideroheshin dy superfuqitë e asaj kohe. Bile-bile kjo gjendje e shoqëronte të Dërguarin e Allahut gjatë gjithë jetës së tij, me gjithë ato luftëra dhe torturime që i përjetonin muslimanët.

Nëse kjo nënkupton diçka, do të nën-

kuptonte se ç'ndikim të madh ka optimizmi në jetën e besimtarit. Por, jo optimizmi i barkmëdhenjve, të cilët hanë, pinë, qeshin e luajnë gjatë gjithë kohës, pa bërë asnjë punë të dobishme. I tilli nuk është gjë tjetër vetëm se i mashtruar dhe teveqel!

Jo optimizmi i atyre të cilët mëkatojnë ditë e natë, saqë të mbushet mendja se janë krijuar vetëm për lojë e shfryrje epshesh, madje pas gjithë kësaj thonë: "Allahu është falës i madh!"

As optimizmi i atyre të cilët e kalojnë kohën nën hije pemësh dhe pastaj thonë: "Vërtet ndihma e Allahut është afër!"

Optimizëm i kërkuar është ai kur muslimani punon pa ndërprerë e nuk pushon; atëherë kur bën projekte dhe i realizon; kur mëson, e atë që e ka mësuar e praktikon. Vetëm pas gjithë këtij mundi ai ka me se gëzohet dhe ka çfarë shpreson.

Muslimani i tillë qesh dhe gëzohet,

“Si të mos gëzohet ai që bën tregti me Krijuesin? Si të mos i qeshë fytyra atij që për çdo ditë nuhat aromë të luleve e trëndafilave?”

E si të mos jetë i lum- tur ai, të cilit lumturia i troket në zemrën e tij çdo minutë e çast.”

por asnjëherë nuk e zbraz kokën nga preokupimet dhe detyrimet! Bën shaka dhe luan, por asnjëherë nuk i harron obligimet me të cilat është i ngarkuar!

Atij goja i buzëqesh, fytyrën e ka plot shend e verë, edhe pse në zemrën e tij rënkojnë më se një mijë plagë! Ai është i qetë e i heshtur, ndonëse në zemrën e tij flasin më se një mijë plagë!

Optimistin e tillë kur e sheh në adhurime dhe punë të hajrit, të duket se nuk ka angazhim tjetër pos tyre. Kur e sheh sa lodhet dhe sa mundohet, të duket se të gjitha punët e umetit i ka mbi kokë. Madje, edhe pas gjithë kësaj sakrifice, ai vazhdimisht e ul dhe kritikon veten. Aq shumë kërkon prej saj (vetes), sa detyrohesh ta mëshirosh dhe t'i japësh kohë për qetësi dhe rehati, duke harruar se ai nuk qetësohet ndryshe vetëm se në gjendjen që është!

E përse të mos jetë optimist, kur e vërteta që ai bart është shtytësi kryesor i optimizmit, pas së cilës çdo gjë është asgjë.

Amaneti që mban mbi supë e bën më të fortë se toka dhe kodrat, të cilat nuk pranuan ta mbajnë atë.

Shpërblimin që do ta arrijë, jo vetëm xhini

që nuk ia di fundin, por asnjë njeri.

Po qe se dikush do të lidhte ndonjë kontratë pune me ndonjë agjenci botërore për ndonjë rrogë marramendëse, me siguri se do të ndihej i privilegjuar dhe do të përjetonte gëzim të paharruar. Nëse e tillë është gjendja e këtij personi për diçka të ulët nga mbeturinat e kësaj bote, cila do të ishte gjendja e atij që ka bërë kontratë me Krijuesin e çdo gjëje, paga e së cilës është Xheneti, gjerësia e të cilit është më e madhe se qiejt dhe toka, ku do të jetë përgjithmonë?!

Si të mos gëzohet ai që bën tregti me Krijuesin? Si të mos i qeshë fytyra atij që për çdo ditë nuhat aromë të luleve e trëndafilave? E si të mos jetë i lumtur ai, të cilit lumturia i troket në zemrën e tij çdo minutë e çast.

Optimist, sepse asnjëherë nuk ndihet i vetmuar, ngaqë është në shërbim të së vërtetës, e ai i cili i shërben asaj është nën mbrojtjen e Allahut. E, ai që është me Allahun, nuk ka nevojë për dikë tjetër.

Ai çdoherë ka parasysh se Allahu nuk do ta humbë e nuk do ta përlulë. Andaj, pas çdo vështirësie, e pret lehtësimin. Pas çdo pengese, e sheh zgjidhjen. Pas çdo terri, e sheh dritën. Ai nuk e humb shpresën sepse shpreson në Allahun, dhe kjo i mjafton.

Për të burgu është më i gjerë se bota, izolimi është veçim me Allahun, prangosja është liri dhe çlodhje, ndërsa injorimi nga njerëzit është ngritje dhe privilegj.

Atij edhe gremina i duket fushë e gjelbëruar dhe në fund të saj e sheh rrugën duke ndriçuar. Ai është optimist, edhe nëse dallgët e kanë dërguar në buzë të greminës, sepse bash aty e sheh optimizmin e premtuar!

E pëlqente ngjyrën e gjelbër

Një besimtar e ftonte një mik të tij t'i bashkëngjitej për në xhami. Ishte e premtë. Thërriste ezani i xhumasë.

-Eja të shkojmë në xhami, se është ditë e premtë. Duhet ta falim xhumanë, - i tha ai.

-Ti e di se unë nuk shkoj në xhami, - ia ktheu miku.

-E di, por vërtet do të më interesonte arsyeja.

-Epo... nuk e di. Mbase rrethi mund të ketë ndikuar paksa, por gjithsesi unë kujdesem që pantallonat e hekurosura të mos më prishen gjatë përkuljeve në namaz, - ia ktheu ai.

-Po bën shaka! Vërtet për këtë nuk shkon në xhami?!

-I tha besimtari duke buzëqeshur.

-E kam shumë sinqerisht, - iu përgjigj miku.

-Ti e di se unë kujdesem shumë për veshjen time dhe se veçanërisht e pëlqej ngjyrën e gjelbër.

Vërtet miku i tij ishte shumë sqimatar. Gjithnjë vishte rroba të gjelbra dhe të hekurosura me shumë kujdes.

-Po a ke qenë ndonjëherë në xhami? - i tha mikut.

-Kur kam qenë i vogël ndonjëherë shkoja me gjyshin, po atëherë nuk mendoja për pantallonat. Por tani nuk besoj se do të kisha shkuar.


Besimtari u zhgënjye nga kjo që dëgjoi dhe u bë pishman që e filloi këtë bisedë.

Dy muaj më vonë, besimtari dëgjoi se më në fund miku i tij kishte shkuar në xhami, andaj vajti menjëherë atje. Vërtet, miku ishte në xhami, para të gjithë safave të renditur. Edhe këtë herë kishte një petk të gjelbër.

Besimtari iu afrua ngadalë dhe me zë të ulët i pëshpëriti: "Më pate thënë se nuk do të hysh në xhami?!"

Mirëpo, miku i tij nuk i përgjigjej, ngase ishte i shtrirë në tabut dhe i mbuluar me një pëlhurë të gjelbër, i bërë gati për t'iu falur xhenazja...

Përktheu: Arsim SYLA



IBRAHIM IBN ED'HEMI

dhe

dhe njeriu gjynahqar

Përcillet se një njeri vajti tek Ibrahim ibn Ed'hemi dhe i tha:

-O babai i Is'hakut! Jam duke i bërë zullum vetes sime (me mëkate), andaj më trego diçka që është qortim për mua dhe shpëtim për zemrën time!

-Në qoftë se i pranon dhe u përmbahesh pesë parimeve, s'do të të dëmtojë asnjë mëkat dhe nuk do t'u ndabesh kënaqësive, - i tha Ibrahim.

-M'i trego parimet, o babai i Is'hakut! – i kërkoi ai.

-I pari: *Nëse dëshiron t'i mëkatosh Allahut, mos e ha furnizimin e Tij!* - ia ktheu Ibrahim.

-E ç'të ha pra, kur dihet se çdo gjë që gjendet në tokë është furnizimi i Tij?! – ia priti gjynahqari.

-Eb, more njeri! A është e drejtë që ta hash furnizimin e Allahut, kurse në anën tjetër i mëkaton?!

– e pyeti Ibrahim.

-Jo, aspak nuk është e drejtë! Ma trego të dytin! – i kërkoi ai.

-Nëse dëshiron t'i mëkatosh Allahut, mos bano në asnjë vend të Tij! – ia ktheu Ibrahim.

-Po kjo qenka më e vështirë se e para! E ku të banoj, kur dihet se lindja, perëndimi dhe ç'ka ndërmyet tyre janë të Allahut?! – ia priti ai.

-A është e drejtë që ta hash furnizimin e Tij, të banosh në tokën e Tij dhe t'i mëkatosh?! – e pyeti Ibrahim.

-Jo, nuk është! Ma trego të tretin! – tha njeriu.

-Nëse dëshiron t'i mëkatosh Allahut i furnizuar nga Ai dhe banor në tokën e Tij, atëherë gjej ndonjë vend ku nuk të sheh Allahu dhe aty bëji mëkat! – ia ktheu Ibn Ed'hemi.

-O Ibrahim! Po si t'i përmbahem këtij (parimi) kur dihet se Ai i sheh të gjitha fshehtësitë?! – e pyeti njeriu.

-Po a të duket e drejtë që ta bash furnizimin e Tij, të banosh në tokën e Tij dhe t'i mëkatosh, ndërkohë që të paka ty dhe veprën tënde?! – e pyeti Ibrahim.

-Jo, nuk është fare e drejtë! Ma trego të katërtin!

-Kur të të vijë Meleku i Vdekjes për të ta marrë shpirtin, thuaji: Më afatizo pak, sa të pendohem sinqerisht dhe të bëj vepra të mira për Allahun! – e porositi Ibrahim.

-Ai kurrsesi nuk do të pranojë një gjë të tillë, - ia ktheu.

-Eh, more njeri! Nëse nuk mund ta shtysh vdekjen për t'u penduar dhe e ditke se kur të të vijë ajo nuk mund të vonohet, si shpreson të shpëtosh?! – e pyeti Ibrahim.

-Ma trego të pestin! – i tha ai.

-Kur të të vijnë zëbanitë (melekët e ndëshkimit) në Ditën e Kiametit për të të dërguar në Zjarr, mos shko me ta! – ia ktheu Ibrahim.

-Ata nuk më lëshojnë e as që e pranojnë këtë nga unë, – ia priti ai.

-Ani si shpreson të shpëtosh?! – e pyeti Ibrahim.

-Mjaft më, o Ibrahim! Kërkoj falje nga Allahu dhe tek Ai pendohem, - ia ktheu i sapopenduari.

Pas kësaj, ky njeri e shoqëroi Ibrahimin në ibadet (adhurim ndaj Allahut) derisa i ndau vdekja.

Marrë nga libri: "Kitab et-tenabin", Ibn Kudame.

‘Eh, more njeri! Nëse nuk mund ta shtysh vdekjen për t'u penduar dhe e ditke se kur të të vijë ajo nuk mund të vonohet, si shpreson të shpëtosh?!’

Floktarja e bijës së FARAONIT



Ibn Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të) ka përcjellë se i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, ka thënë: “Natën që u ngrita në qiell nuhata një aromë të këndshme! Thashë: “Ç’është kjo aromë e këndshme, o Xhibril?!” Ai ma ktheu: “Është aroma e floktares së bijës së Faraonit dhe e bijve të saj.” Thashë: “Ç’është puna e saj?!” Më tha: “Përderisa po ia krihte flokët të bijës së Faraonit, i ra krehri nga dora dhe tha: “*Bismilab (Me emrin e Allahut).*”

- (Me) Të babait tim?! - e pyeti e bija e Faraonit.

- Jo, me të Zotit tim, tëndin dhe të babait tënd; me të Allahut, - iu përgjigj ajo.

- Paske Zot tjetër përveç babait tim?! - i tha ajo.

- Po, - ia ktheu asaj.

- A t’i tregoj atij (babait) për këtë? - e pyeti.

- Tregoj! - ia ktheu.

Kur ajo e lajmëroi Faraonin, ky (i fundit) e thirri menjëherë atë dhe e pyeti: “Filane, mos vallë ke ndonjë Zot tjetër përveç meje?!”

- Po! Zoti im dhe yti është Allahu, - iu përgjigj ajo.

Në këtë rast ai urdhëroi që të sillej një enë e gjerë prej bakri dhe të vlohej. Pastaj u morën bijtë e saj dhe i hodhën në të, një nga një.

- Kam një kërkesë nga ti! - i tha ajo.

*“Oj nëna ime!
Hidhu, se dënimi i dynjasë është më i
lehtë sesa ai i ahiretit.”*

-Ç'kërkesë? - ia ktheu Faraoni.

-Dëshiroj t'i bashkoni eshtrat e mia me ato të tim biri në një rrobë të vetme dhe të na varrosni së bashku, - iu përgjigj ajo.

-Do të bëjmë ashtu, - i tha Faraoni.

Ata vazhduan t'i hidhnin bijtë e saj në enën e gjerë, derisa në fund i erdhi radha fëmijës së saj të vogël, i cili ende ishte foshnjë gjiri. Ajo pothuajse filloi të lëkundej për shkak të (dhembshurisë ndaj) tij. Por, fëmija i tha: “Oj nëna ime! Hidhu, se dënimi i dynjasë është më i lehtë sesa ai i ahiretit.” [Hadithin e shënojnë Ahmedi, 3/309; Taberaniu në El-Kebir, 12279, 12280; dhe Ibn Hibani, 2892, 2893.]

Dobitë e hadithit

1. *Durimi dhe qëndrueshmëria në kohë sprovash.*
2. *Shpërblimi është paralel me llojin e veprave.*
3. *Shpërblimi i madh i takon atij që është i qëndrueshëm në fe dhe nuk i trembet qortimit të asnjë qortuesi. “Vërtet, ata që janë të durueshëm do të shpërblehen pa masë.”*
4. *Lejohet që muslimani të kërkojë ndonjë çështje në të cilën ka dobi, madje edhe nga tagutët, siç kërkoi kejo grua, që ta varrosë hirin e saj me të bijve.*
5. *Allahu u gjen rrugëdalje miqve të Vet gjatë mundimeve dhe vështirësive.*
6. *Vërtetimi i kerameteve të miqve të devotsbëm të Allahut.*
7. *Disa keramete janë të jashtëzakonshme.*

Shkëputur nga libri

“60 kaisaten rauaba En-Nebijju ue as'habuhu”,

Muhamed ibn Hamid



PORTRETI I NJË ISH-ROKERI

**“E FALËNDEROJ TË LARTËSUARIN QË MË KA BËRË
RRUGËDALJE EDHE ATËHERË KUR S’ËSHTË PARË NDONJË
ZGJIDHJE NË HORIZONT.” ~ FERKI SHALA**

FERKI SHALA ka lindur më 28 gusht 1963, në Mitrovicë. Ai është i biri i çiftit Fahri Shala, nga Tiranë, dhe nënës Sadije, nga Novi Pazar. Është baba i dy vajzave, Ilda dhe Rejallda. Ai u bë i njohur përmes muzikës, si vokalist me zë kumbues. Mirëpo tash e disa vite gjëja që ai më së shumti e urren është muzika. Bendi me të cilin këndonte Ferki quhej “TNT”, në kuptimin e një dinamiti shpërthyes. Vërtet Ferki shpërthente me zërin e tij. Këngët e tij ende janë të njohura, mirëpo ai është bërë shumë pishman, madje, s’do as të mendojë për atë pjesë të jetës së tij. “Kuptohet se muzika është arsyeja kryesore

që unë jam bërë i njohur, mirëpo, tash e një kohë të gjatë jam plotësisht i dëshpëruar nga karriera muzikore, dhe, natyrisht, i penduar thellë.” – thotë ai.

E braktisi muzikën mu kur e kishte prekur majën më të lartë të sukseseve.

Kur ndokush e braktis profesionin në të cilin ka qenë shumë i njohur në publik e që ka qenë i lidhur ngushtë me të, gjëja e parë që na bie ndërmend është dështimi i ndonjë projekti apo dëshpërimi i tij me rezultatet e dobëta. Ndërkaq, te Ferki ndodhi diçka e jashtëzakonshme. Ai e ndërpreu përnjëherë dhe përnjëmend karrierën e tij muzikore, siç thamë, mu në kohën kur ishte në majat e

sukseseve. Këtë hap të vendosur e ndërmoi në një moment shumë të papritur për publikun: “Në kohën kur ne, bendi “TNT”, e nxorëm albumin jubilar, të dhjetin me radhë, “Luje belin lujë”, unë u gjenda në një situatë të vështirë. Ishte kompletuar krejt incizimi i këtij albumi, madje edhe spotin e kishim kryer, kurse unë kisha filluar të fal të pesë kohët e namazit. Ka pasur diku një javë apo dhjetë ditë ndërmjet prezantimit të albumit dhe kohës kur unë kisha filluar të falem rregullisht.”

Por, si ndodhi me të vërtetë lënia e muzikës e zëvendësuar me praktikimin e fesë islame në tërësi?


Saktësisht para 10 vjetësh (2005), teksa po rrinte i vetëm në banesën e tij, mëngjesin e arriti zgjuar. Kishte hyrë koha e namazit të sabahut, kur nga xhamia u dëgjua thirrja e ezanit. Ferkiu u prek shpirtërisht nga kjo thirrje, ndaj vendosi ta falte së paku këtë sabah në jetën e tij, ndonëse s’e kishte idenë si duhej falur. Meqë ishte vetëm dhe s’e shihte askush, vendosi të falej si të mundte. Por, pikërisht ky namaz ia ndërroi krejtësisht rrjedhat e jetës së tij dhe të familjes. Shumë shpejt edhe gruaja e tij e vajzat filluan të falen me të. Ky hap do të bëhej çelësi i lumturisë, siç pohon vetë Ferkiu, jo vetëm për të, por për tërë familjen e tij: “E falënderoj të Lartësuarin që më ka bërë rrugëdalje edhe atëherë kur s’është parë ndonjë zgjidhje në horizont.”

Megjithatë, duhet përmendur edhe një provë të madhe me të cilën u ndesh për hir të Allahut protagonistin ynë, Ferki Shala, pas ndërprerjes së karrierës së tij muzikore. Vetëkuptohet, duke qenë artist i zoti, ishte mësuar me jetë luksoze. Por, tash, që po tërhiqej, si do të jetonte? Nga do t’i siguronte të ardhurat? Ai, që në fillim, kishte vendosur t’i mbështetej vetëm Allahut për

të gjitha problemet që do ta ndiqnin, e le të bëhet ç’të bëhet. Jetonte në një periudhë të rëndë financiare. Bashkë me familjen ditën e kalonte me nga tri-pesë euro, madje shpeshherë duke marrë edhe borxhe. Kishte ardhur një ofertë tepër sfiduese. Gjithçka varej nga një “PO” e Ferkiut, që do ta nxirrte veten dhe familjen nga vështirësitë financiare që gjendeshin. Ngjarjen, që u bë publike kohë më parë në disa portale, e tregon vetë Ferki Shala, përmes një statusi të tij. Bëhet fjalë për jo më pak se 60.000 euro të refuzuara, vetëm për të mos rënë edhe një herë në haramin nga i cili kishte dalë përgjithmonë, muzika!

Këngëtari apo bartësi i grupit “TNT”, Ferkiu e refuzoi koncertin në vlerë prej 60 mijë eurosh, siç thamë, vetëm, dhe vetëm që muzika është haram.

Në një status ai e ka përshtuar të gjithë ngjarjen, që, edhe përkundër gjendjes së rëndë ekonomike, nuk ka pranuar të rikëndojë.



"Sapo isha udhëzuar. Ende kisha dilema. Refuzoja koncerte dhe organizime muzikore, por kriza ekonomike më kishte kapluar. Mu atë ditë më thirrën nga Anglia, për fundvit dhe për tri netët e Vitit të Ri, që të bëja muzikë. Refuzova, por më thanë se këtë fundvit parashohin ta paguajnë bendin 60 mijë euro, plus bakshishet. Nuk ua dhashë përgjigjen. Kjo më ngacmoi (cytje nga shejtani: shko vetëm edhe këtë herë, jepu fund herëve të tjera). Por, ja ç'më rëndoi edhe më shumë: më thirri gruaja e më tha se duhen disa gjëra për familjen...

Të them të drejtën, në xhep nuk i kisha as dy euro. Vendosa ta bëja një praktikë të të Dërguarit, sal-lallahu alejhi ue selem, të fal namaz për t'u qetësuar...

Dhe, me të dalë nga xhamia, më thirri një numër i panjohur. Më tha: "A jeni Ferkiu? "Po", - i thashë.

Më pyeti ku mund të takoheshim? I tregova. U takuam. M'u prezantua dhe më tha: "Jemi studentë dhe kemi dashur të të përkrahim, ngase kemi dëgjuar se jeni udhëzuar dhe e keni lënë muzikën, ndërsa gjendja ekonomike ju është vështirësuar." Nuk më lejoji t'i bëja më shumë pyetje. Më la një zarf dhe iku...

Me t'u ndarë, e hapa zarfin, qenë 600 euro, që të gjitha nga 5 dhe 10 euro. Në ato momente më është rrotulluar Mitrovica duke m'u mbushur sytë me lot. Kjo ishte e pabesueshme. S'kam fjalë ta shpjegoj. Dhe vazhdon: I jam drejtuar Allahut me plot zemër: elhamdulillah, elhamdulillah, elhamdulillah! I patëmeta je, o Allah. Furnizimi është vetëm në dorën Tënde.

Në ato momente më rithirrën nga Anglia. Tashmë edhe e kishin rritur shumën. Por, tani isha i vendosur për të thënë "JO". Unë jam musliman dhe për mua muzika ka marrë fund.

Shokët e mi të bendit këmbëngulnin: Si po e lë këtë mundësi. Po na lë pa bukë, e fjalë të ngjashme... U thashë: "Nga sot Ferkiun e keni vëlla, e jo shok të muzikës, të alkoolit, e të haramit.

E mbarova me ta dhe shkova në dyqan. Lava disa borxhe dhe i mora gjërat që m'i kërkoi gruaja. Kur hyra në shtëpi, gruaja mbeti pa fjalë. Më pyeti:

"Prej nga të gjitha këto?" Iu përgjigja: "Ja, grua, ç'të sjell Islami: refuzova një mbrëmje harami, Allahu m'i dhuroi këto me hallall."

Vallahi, tërë Londrën e tërë botën të ma jepnin atëbotë, s'do ta kishte vlerën e kësaj. Vetëm Allahu e di sa i lumtur jam ndier... (Në ato momente, teksa rrëfente, lotët nuk i ndaleshin nga sytë vëllait tonë, Ferkiut).

Kjo ndodhi qe shkak që gruaja vendosi të mbulohet, elhamdulillah.

facebook

Revista "Shembulli" ka zhvilluar një bisedë të shkurtër për t'u njohur më për së afërmi me jetën e tashme të Ferkiut.

Shembulli: Kohët e fundit nuk jeni prezent. A mund të na thoni me se po merreni konkretisht tash e disa vite?

Ferki Shala: Po mendoni praninë mediale. Mund të them që edhe kohët e fundit jam goxha aktiv, por jo në të gjitha mediet dhe normalisht jo si më parë. Më shumë më gjeni në ato që janë vërtet të pavarura dhe në disa të tjera që promovojnë vlera të mirëfillta!

Shembulli: Si po e kaloni jetën tash prejse keni

bërë ndryshime rrënjësore, kur jeni mësuar të jeni gjithnjë në qendër te medieve, ndërkohë që tash nuk shiheni fare? A po i mungoni ju publikut apo publiku juve?

Ferki Shala: Keni te drejtë, se s'jam si më parë në skenë, por s'keni të drejtë kur thoni se kam humbur fare... Ndryshimi është se kam zbritur nga skena në publik dhe tani po e bëj jetën bashkë me 'publikun', dhe as unë e as ata s'po ndiejmë mungesë.

Shembulli: Një kohë, pasi e latë karrierën prej këngëtarit shumë të njohur e të suksesshëm, me sa di, merreshit me gjëra shumë të thjeshta, siç është

shitja e mjalitit. *Çfarë mund të na thonit për këtë, si ndibeshit?*

Ferki Shala: E kam thënë edhe në disa intervista të tjera se s'ka qenë e lehtë ta ndryshosh mënyrën e jetesës, por nuk është e pamundur. Madje, me ndihmën e Allahut, çdo gjë është e lehtë. E falënderoj të Lartësuarin që më ka bërë rrugëdalje edhe atëherë kur s'është parë ndonjë zgjidhje në horizont.

Shembulli: Dimë se i keni dy vajza. A është shtuar numri i anëtarëve të familjes suaj?

Ferki Shala: Po, i kam vetëm dy vajza, por Allahu më përgëzoi me nipin, Ensarin, dhe mbesën, Hana.

Shembulli: Tash çfarë ju intereson më së shumti në jetë dhe cila është dëshira juaj e vetme?

Ferki Shala: Më së shumti në jetë më intereson, si çdo besimtar, të kryej më së miri rolin për të cilin më krijoi Zoti. Pra, ta përsos moralin tim dhe ta shtoj adhurimin ndaj Allahut, sepse, siç e dimë të gjithë, ditët në këtë botë i kemi të numëruara dhe s'kemi kohë për të humbur!

Dëshira ime e vetme? Hahaha. Dëshirat nuk i kam të reduktuara, kam shumë, dhe, për realizimin e tyre, lutem çdo ditë e çdo natë... Sigurisht, nëse këtë grumbull dëshirash do ta përmblihdhja me një fjalë, janë: njerëzit (edhe unë bashkë me ta) të jetojmë jetë të mirë në këtë botë dhe të dalim faqebardhë para Allahut, Zotit tonë Falës e Mëshirues!

Shembulli: Në Kosovë është bërë shprehi të thuhet se ata që e praktikojnë fenë në mënyrë të vendosur janë ekstremistë dhe vehabistë, që po e prishin tolerancën ndërfetare. Cila është përgjigja juaj për këtë?

Ferki Shala: Etiketimet fatkeqësisht 'pinë ujë' në pjesën më të madhe të popullit, sepse shumica nuk interesohen në esencë për çfarë po bëhet fjalë, por mjaftohen me tituj gazetash, lajmesh ose me muhabete kafenesh. Pjesën e vehabizmit dhe

ekstremizmit mendoj që e kanë shtjelluar mjaftueshëm hoxhallarët përmes ligjëratave të tyre (që mund t'i gjeni në "youtube" dhe "Peacstv") dhe vetë Bashkësia Islame e Kosovës. Ndërkaq, toleranca fetare mendoj se, jo që s'është e prishur, por është shembull në rajon!

Shembulli: Po ashtu thuhet edhe se ata që janë kapur fort për fenë islame po paguhen me para të majme. Ndërkaq ju jeni shembull që i keni lënë paratë dhe luksin për t'u përkushtuar sa më shumë fesë. Cila është porosia juaj për këtë?

Ferki Shaka: Materialistët në "logjikën" e tyre kanë vetëm një inspirim, vetëm një gjë që i vë në lëvizje. Ajo është paraja, bota materiale! Ata s'mund ta shpjegojnë jetën e të tjerëve veçse me jetën e tyre. Ata zgjohen në mëngjes që të fitojnë, të punojnë e të ndërtojnë. Fotoqafohen për t'u dukur dhe prapë janë të pakënaqur, sepse jeta e tyre s'ka kuptim dhe i lodh shumë. Pak nga ata e prekin dashurinë, e s'po flas për adhurimin, që është kulmi i dashurisë. Besimtari ka një Zot që e ka krijuar, të Cilin e adhuron me çdo qelizë të tij. Ngrihet në mëngjes dhe shkon ta falënderojë Zotin dhe ndihet më mirë se multimilioneri.

Shembulli: A keni në plan ndonjë projekt të ri, ndonjë ilabi a diçka tjetër?

Ferki Shala: Projekti i ri le të mbetet sekret.

Shembulli: Cila është porosia dhe dëshira juaj për muslimanët në botë sot, kur dihet se gjendja e tyre nuk është aspak mirë?

Ferki Shala: Dëshira ime është të mbizotërojë paqja dhe harmonia, jo vetëm aty ku janë muslimanët, por në tërë botën. Allahu na udhëzofte e na e shtofte besimin dhe sinqeritetin! Amin!

Intervistoi: Febmi Maloku

Islami m'i ofroi të gjitha përgjigjet

Intervistë ekskluzive me personin nga Dominika që e pranoi Islamin

A mund të prezantoheni, ju lutem?

Quhem Sulejman Shillingford. Jam 63 vjeç. Jam i martuar dhe kam tetë fëmijë, elhamdulillah. Kam lindur në një ishull të vogël të Karaibeve, afër Amerikës Qendrore, të quajtur Dominika. Islamin e kam përçafuar në vitin 1975, në moshën 24 vjeçare, kur isha duke i mbaruar studimet në universitet. Jam i dyti nga Dominika që e ka pranuar Islamin.

Na njoftoni me vendin tuaj.

Dominika është një ishull i vogël në Karaibe, rreth 4 orë udhëtim me aeroplan nga Majami, Florida. Është një vend i krishterë, me 99.9% të tillë. Shumica e tyre janë katolikë, të cilët udhëheqës të tyre e konsiderojnë papën që është në Romë. Shumica e popullit ka prejardhje afrikane. Ata kanë qenë skllëvër afrikanë, të cilët në këtë vend u sollën nga skllavopronarët evropianë, afërsisht 500 vjet më parë. Traditat tona janë të ngjashme me ato të afrikano-amerikanëve në SHBA.

Ekonomia e Dominikës është e bazuar në turizëm dhe bujqësi, ngase toka është jashtëzakonisht e pëlleshme. Ndërkaq, turistët vijnë për ta shijuar bregdetin dhe motin tropikal të shoqëruar me reshje shiu. Moti është i nxehtë, me lagështirë



gjatë verës e i butë në dimër. Temperaturat mesatare gjatë gjithë vitit sillen rreth 20–35 shkallë celsius.

Po fëmijëria juaj? Na flisni diçka për të.

Jam rritur si i krishterë, në një familje të pasur. Familja ime ishte fisi më i madh në ishull. Kam mësuar në një shkollë të krishterë, mësuesit e së cilës ishin të krishterë nga Amerika dhe Kanadaja. Gjyshi im ishte pronar i madh tokash, prandaj pjesën më të madhe të fëmijërisë sime e kam kaluar në fermë me babanë, duke e punuar tokën. E mbillnim dhe kultivonim panxharsheqerin, limonin e athët, bananen, portokallin, portokallin e hidhur, dhe pemë të tjera për t'i eksportuar

në Britaninë e Madhe. Në atë kohë, Dominika ende ishte koloni angleze, andaj prodhimet tona i dërgonim në Britaninë e Madhe.

Kam pasur shumë shokë dhe, natyrisht, sikur çdo fëmijë, kemi luajtur, jemi argëtuar, e nganjëherë kemi bërë edhe sherre të vogla!

Cili ishte shkaku kryesor që ju shtyri ta përqaqonit Islamin?

Unë, siç ju tregova pak më parë, jam bërë musliman më 15 janar 1975. Në atë kohë isha duke e mbaruar fakultetin ekonomik. Isha thellësisht i zhgënjyer me krishterimin, përkatësisht besimin e trinisë dhe me çoroditjen shoqërore, respektivisht imoralitetin. Po ashtu shfrytëzimi i të varfërve përbënte një shqetësim për mua. Në Islam i gjeta përgjigjet e këtyre çështjeve, të cilat e luhatën besimin tim të mëparshëm. Në Islam, njëshmëria e Allahut, vlerat etike dhe morale ishin

“Në Islam, njëshmëria e Allahut, vlerat etike dhe morale ishin të shtjelluara shumë qartë. Isha duke hulumtuar, e Islami m’i ofroi të gjitha përgjigjet e pyetjeve që kisha.”

të shtjelluara shumë qartë. Isha duke hulumtuar, e Islami m’i ofroi të gjitha përgjigjet e pyetjeve që kisha.

Si u prit kjo nga të afërmit dhe shoqëria juaj?

Nëna dhe babai ishin disi të lumtur kur e kuptuan se unë e kisha ndërruar fenë. Ata vërejtën një ndryshim tek unë. Islami është fe e natyrshmërisë, andaj, nëse e zbatoni atë me sinqeritet, njerëzit do ta kuptojnë se ju jeni serioz në këtë punë dhe do ta vërejnë ndryshimin.

Shokët e mi nuk u besonin syve. Unë u



“Këshilla ime për lexuesit e revistës suaj është që të kapen pas Kuranit dhe Sunetit të të Dërguarit tonë të dashur, Muhamedit, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të. Këtu qëndron sukseksi. Mbajini zemrat të lidhura me ahiretin. Mundohuni ta praktikoni Islamin gjithmonë, pavarësisht sfidave të jetës.”

largova nga gjërat e këqija që i bëja dhe nga shoqëria që kisha, mirëpo i gjeta shokët e rinj në vëllazërinë e Islamit.

A e kanë pranuar Islamin anëtarët e tjerë të familjes?

Babai im e ka shqiptuar shehadetin para se të vdiste. Bashkëshortja dhe fëmijët e mi janë muslimanë, elhamdulillah, por pjesa tjetër e familjes sime ende janë të krishterë.

Nëna më thoshte se besonte që Kurani ishte shpallje nga Zoti dhe se Muhamedi, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, ishte i dërguar i Tij, por ajo kurrë nuk e përqafoi Islamin. Ajo ishte si Ebu Talibi, xhaxhai i të Dërguarit, sal-lallahu alejhi ue sel-lem: ajo nuk e mohonte Islamin, madje i ndihmonte muslimanët. Nganjëherë gatuate për ne dhe na e lironte shtëpinë për ta falur namazin e xhumasë, në kohën kur nuk kishim xhami në vendin tonë.

Sa është numri i muslimanëve në Dominikë? A mendoni të ktheheni atje dhe përse keni vendosur të vini në Arabinë Saudite?

Tani në Dominikë janë rreth 200 muslimanë në një popullatë prej rreth 70,000 banorësh. Ka dy xhami të vogla, por asnjë në kryeqytet. Unë tashmë jetoj në Britaninë

e Madhe, prej nga jam shpërngulur në Arabinë Saudite. Shkaku i ardhjes sime në Arabinë Saudite është që fëmijët e mi ta mësojnë, insha-Allah, arabishten dhe Kuranin mu në vendburimin e Islamit. Shpresoj se një ditë do të kthehem në Dominikë, që ta thërras popullin tim në Islam.

Për fund, me se do t'i këshillonit lexuesit e revistës sonë?

Këshilla ime për lexuesit e revistës suaj është që të kapen pas Kuranit dhe Sunetit të të Dërguarit tonë të dashur, Muhamedit, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të. Këtu qëndron sukseksi. Mbajini zemrat të lidhura me ahiretin. Mundohuni ta praktikoni Islamin gjithmonë, pavarësisht sfidave të jetës. Sigurisht që ju e dini më mirë gjendjen në Kosovë dhe si duhet të veproni. Islami na i zgjidh të gjitha problemet, prandaj kërkoheni diturinë e fesë dhe kujtojeni ditën kur do të dalim të vetmuar para Allahut.

E lusim Allahun të na i japë librat e veprave tona në dorën e djathtë! Amin!

Ramazani erëzon



ULVI FEJZULLAHU

Lavdërimet dhe falënderimet i takojnë Allahut, i Cili na e ka përmbushur premtimin e Tij dhe na ka bërë trashëgimtarë të Tokës. Kështu, ne mund të banojmë në Xhenet ku të duam. Eh, sa shpërblim i shkëlqyer që është për të përkushtuarit dhe vepërmirët!

Paqja, mëshira dhe bekimet qofshin mbi Muhamedin, prijësin e të devotshmëve, familjen dhe shokët e tij deri në Ditën e Gjykimit.

Takua do të thotë “përkushtim i drejtë” përmes së cilës besimtari e synon frikë-respektin ndaj Allahut të Lartësuar, duke u vetëpërmbytur prej gjynaheve dhe veprimeve të ulëta, të ndaluara nga Ai, dhe duke vepruar çdo të mirë, që Ai ka urdhëruar.

Agjërimi është një ndër shtyllat baza të Islamit, për kryerjen e të cilit u urdhëruan besimtarët, ashtu siç qenë urdhëruar edhe popujt e mëhershëm: “...me qëllim që të mund të bëheni të devotshëm.” (Bekare, 183)

Agjëruesi është i përkushtuar në garën e devotshmërisë, nëse rreh të përjetojë dhe shijojë gëzim dhe lumturi. Muslimanit i lumturohet shpirti sepse aktiviteti i tij do të jetë për të marrë një mbiemër cilësor, një shprehje të bukur artistike me karakteristika lavdërimi, epitetin “i devotshëm”.

Është më se e natyrshme që njeriu ta shfaqë gëzimin në momente të veçanta. Disa u gëzohen çështjeve të kësaj bote të përkohshme, e disa kënaqen kur u jepet rasti për ta shpalosur adhurimin ndaj Allahut përmes asaj që Ai ka urdhëruar.

Pa dyshim, besimtari i përkushtuar gëzohet kur mysafiri thërret dhe i troket në derë. Me nderimet më të larta, me shprehjet më të bukura, me zemërgjerësinë më të madhe dhe me respektin më të sinqertë i uron mirëseardhje.

I Dërguari, sal-lallahu alejhi ue selem, ka thënë: “*Ju erdhi Ramazani, muaji i bekuar. Allahu jua ka obliguar agjërimin e tij. Në të hapen dyert e qiellit, mbyllen portat e*

“Allahu në këtë muaj e ka (privilegjuar) një natë, që është më e mirë se një mijë muaj. Ai që privohet nga të mirat e kësaj nate, është privuar nga çdo e mirë.”

~Hadith

Xhehenemit dhe prangosen shejtanët. Allahu në këtë muaj e ka (privilegjuar) një natë, që është më e mirë se një mijë muaj. Ai që privohet nga të mirat e kësaj nate, është privuar nga çdo e mirë.” (Shënon Nesaiu, sahih)

Pse mos të gëzohet besimtari me muajin erëdhënës së bereqetit, dhuratave, namazit, durimit, faljes, pendimit, devotshmërisë, mëshirës, pastërtisë, bamirësisë, fitores dhe ngadhënjimit?

Mirë se vjen, mysafir i nderuar! Inshallah edhe ne i gëzohemi Ramazanit, muajit më të vlefshëm.

Mirë se vjen, pas një pritjeje të gjatë e të përmallshme!

Mirë se vjen, mik përmallues! Zemrat tona do të kënaqen me erën tënde të këndshme. Me vizitën tënde do të pastrohemi nga gjynahet dhe do të na i mbulosh të metat tona.

Allahu i Lartësuar thotë: “Thuaj: Me dhuntinë e Allahut dhe mëshirën e Tij - vetëm me këto le të gëzohen! Kjo është më e mirë se ajo që grumbullojnë.” (Junus, 58)

Agjërues i nderuar!

Dymbëdhjetë muajt i shëmbëllojnë të bijve të Jakubit, alejhim selam: muaji Ramazan në mes muajve të tjerë është si Jusufi, alejhi selam, në mes vëllezërve të vet. Ashtu siç ishte Jusufi, alejhi selam, më i dashuri tek i ati, Jakubi, kështu muaji Ramazan është ndër muajt më të zgjedhur të Krijuesit. Jusufi, alejhi selam, ishte i sjellshëm dhe i mëshirshëm me vëllezërit. Edhe përkundër sjelljes së tyre të egër, ai me butësi dhe falje i mishëroi duke u thënë: “Sot s’ka qortim për ju; Allahu do t’ju falë. Ai është më i mëshirshmi i mëshiruesve!” (Jusuf, 92)

Pikërisht kështu ky muaj do të jetë falje dhe mëshirë për besimtarët, prangosje për shejtanët.

Gëzoju faljes së Allahut të Lartësuar. Gëzohu që Ai ta dha mundësinë e përmirësimit dhe pendimit. Gëzoju hapjes së portave të Xhenetit dhe mbylljes së atyre të Xhehenemit.

Vëlla agjërues!

Era e këndshme e Ramazanit po arrin. Ç’pret pra? Lidh kontratë (marrëveshje) për ripërtëritjen e imanit duke i pranuar porositë dhe mesazhet vijuese:

Porosia e parë:

Largohu nga bisedat dhe polemikat e panevojshme në shtëpi.

Çdo paqartësi dhe problem mundohu ta evitosh para Ramazanit. Në shtëpinë tënde krijo atmosferë të qetë duke bërë vepra me të cilat është i kënaqur Allahu i Lartësuar.

Shtëpia ku banon dhe mbrohesh është begati e Allahut dhuruar ty. I Plotfuqishmi thotë: “Allahu ju ka dhënë shtëpi për të banuar.” (Nahl, 80)

Porosia e dytë:

Ringjalle shpirtin, mendjen dhe trupin tënd me agjërime. Shpirtit tërhiqja vërejtjen për jetën e shkurtër, mendjen largoje nga ephset, kurse trupin përmbaje dhe kontrolloje nga ushqimet dhe pijet (e tepërta).

Porosia e tretë:

Mbaje gojën mbyllur dhe vetëpërbahu nga fjalët e tepërta. Mendoje atë që thua. Allahu i Lartësuar thotë: “... për çdo fjalë që ai thotë, ka pranë vetes një mbikëqyrës të gatshëm (për ta shënuar atë).” (Kaf, 18)

Allahu i Lartësuar t'i dhuroi dy sy e dy veshë, por vetëm një gjuhë, që të flasësh më pak.

Porosia e katërt:

Ripërtërije ndjenjën e kujdesit ndaj farefisit. Trego respekt dhe mirësi ndaj prindërve. Kujdesi ndaj tyre është detyrim. Allahu i Lartësuar thotë: “Ne e urdhëruam njeriun t'u bëjë mirë prindërve të vet.” (Ahkaf, 15)

“Dhe frikësojuni Allahut, me emrin e të Cilit ju kërkoni të drejta të ndërsjella dhe ruani lidhjet farefisnore.” (Nisa, 1)

Porosia e pestë:

Largohu nga gjynahet. Mos e lejo veten

të bëhesh pre e mëkateve. Largoju çdo rrugë a rrugice që mund të të shpjerë në të keqen. Shpejto në pendim të sinqertë duke mos i kundërshtuar dhe tejkaluar kufijtë e Allahut të Lartësuar.

“Këta janë kufijtë e Allahut, andaj mos i shkelni ata! Ata që shkelin kufijtë e Allahut, pikërisht ata janë keqbërësit.” (Bekare, 229)

Agjërues i ndershëm!

Në fund, e lus Allahun e Lartësuar, me emrat e Tij të bukur dhe cilësitë e Tij të larta, të na ndihmojë në përmendjen dhe falënderimin e Tij të sinqertë. Allahu im, na mundëso që në këtë muaj ta shijojmë kënaqësinë e adhurimit Tënd.

Me admirim dhe kënaqësi shijojeni Ramazanin e erëzuar me mirësitë e Allahut drejt kopshteve të larta.

“Ata nuk do ta dëgjojnë as zërin më të lehtë të tij (Xhebenemit) dhe do të banojnë ku ata të dëshirojnë. As tmerri më i egër e më i madh (në Ditën e Kiametit) nuk do t'i shqetësojë ata dhe melekët do t'i takojnë ata (me përshëndetjen): “Kjo është dita juaj e premtuar.” (Enbija, 102- 103)



Agjenda e muslimanit gjatë Ramazanit

VALDET KAMBERI

PËR TË ARRITUR SUKSESE NË MUAJIN E BEKUAR RAMAZAN dhe për të depozituar sa më shumë shpërblime tek Allahu i Lartësuar, patjetër duhet përpiluar një program, i cili do përfillur. Mu për këtë po jua paraqesim agjendën vijuese, e cila do t'ju ndihmojë shumë për të dalë fitimtarë në këtë muaj të begatë.

Pika e parë: Koha e syfyrit

1. Zgjidimi para agimit, një apo gjysmë ore më herët.
2. Zgjidimi për ngrënien e syfyrit, duke pasur parasysh bereqetin e tij.
3. Avdesi, falja e dy rekateve, lutjet dhe kërkimfalja (istigfari).
Allahu ka thënë: "Dhe në syfyr (nga mbarimi i natës) ata kërkonin falje për mëkate."
(Dharijat, 18)
4. Shkuarja në xhami, për ta falur namazin me xhemat (meshkujt).
5. Përsëritja e ezanit pas myezinit dhe leximi i lutjes përkatëse pas përfundimit të tij, si dhe përsëritja e Muhamedit, sal-lallahu alejhi ue sel-lem, me salavate.
6. Kryerja e dhikrit pas namazit.
7. Lutja, namazi i duhasë, përmendja e Allahut dhe leximi i ndonjë pjese nga Kurani.
8. Koha në mes namazit të duhasë dhe atij të drekës është e lirë.
Mund të shfrytëzohet për lexim, punë, nxënie përmendsh, lexim të ndonjë tefsiri apo libri të haditheve ose thjesht për pushim.

Pika e dytë: Namazi i drekës

1. Përsëritja e ezanit pas myezinit dhe leximi i lutjes përkatëse pas përfundimit të tij, si dhe përshëndetja e Muhamedit, sal-lallahu alejhi ue sel-lem, me salavate.
2. Falja e katër suneteve para namazit farz dhe dy pas tij.
3. Lutja dhe dhikri pas namazit.
4. Leximi i ndonjë pjese nga Kurani.

Pika e tretë: Ikindia

1. Përsëritja e ezanit pas myezinit dhe leximi i lutjes përkatëse pas përfundimit të tij, si dhe përshëndetja e Muhamedit, sal-lallahu alejhi ue sel-lem, me salavate.
2. Pushim, ngase edhe trupi ynë ka të drejta.
3. Kujdesi për punët e shtëpisë dhe ndihma ndaj bashkëshortes, që edhe ajo të ketë mundësi të përfitojë në këtë muaj të shenjtë.
4. Para akshamit për disa çaste të bëjmë lutje dhe të lexojmë Kuran.

Pika e katërt: Akshami (iftari)

1. Shkuarja për ta falur namazin e akshamit në xhami.
Për fat të keq, kjo, gjatë Ramazanit, pak po përfilllet nga ne.
2. Çelja e agjërimit me hurma (ata që kanë mundësi).
Në mungesë të tyre, atëherë me ujë, duke e ndjekur traditën e Muhamedit, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të.
3. Përsëritja e ezanit pas myezinit dhe leximi i lutjes përkatëse pas përfundimit të tij, si dhe përshëndetja e Muhamedit, sal-lallahu alejhi ue sel-lem, me salavate.
4. Tubimi me familjarët në sofrën e iftarit.

Pika e pestë: Jacia

1. Përsëritja e ezanit pas myezinit dhe leximi i lutjes përkatëse pas përfundimit të tij, si dhe përshëndetja e Muhamedit, sal-lallahu alejhi ue sel-lem, me salavate.
2. Falja e namazit në xhami.
3. Falja e namazit të teravive.
4. Ndeja me familjarët.
5. Leximi i ndonjë pjese nga Kurani para gjumit.
6. Fjetja sa më herët, që të kesh mundësi për t'u ngritur i freskët për adhurim.

TY

O LËNËS

I AGJËRIMIT!

BURIM KOÇINAJ

O lënës i agjërimit!

S'di kah t'ia filloj... Jam thellësisht i pikëlluar kur të shoh që s'po agjëron, o rob i Allahut! Me mosagjërim po e rrënon një obligim të madh fetar, një shtyllë të Islamit!

Dëshiroj të të flas, që mos të të shembet ndërtesa e quajtur *Islam*.

O ti që i ke thënë vetes *musliman*! Ja, të erdhi rasti ta dëshmosh Islamit tënd.

Kur Muhamedi, *lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të*, i përmendi shtyllat e Islamit, mes tjerash tha: "...*agjërimi i Ramazanit*."

O lënës i agjërimit!

Vallë, për shkak të nxehtësisë s'po agjëron?! Ndoshta mendon se do të të mbulojnë djersët, e do ta kesh të vështirë?!

A mos e ke harruar Ditën e Kiametit kur njerëzit do të pëmbeten në djersët e tyre?! Mos harro se, ai që djersitet në këtë dynja duke i kryer urdhrat e Allahut, do të freskohet atë ditë, që është e rëndë për mosagjëruesit!

A nuk e ke kujtuar Ditën kur zjarri i Xhehenemit do të vërshojë e dëshiron t'i



gllabërojë të gjithë njerëzit?!

Vallë, a nuk e di madhësinë e Xhehenemit?! Muhamedi, *lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të*, ka treguar se atë Ditë do të hidhet Dielli dhe Hëna në Xhehenem. Tani, a e kuptove se sa i madh është ai?

E ti, o lënës i agjërimit, me se do ta mbrosb veten tënde?

Mos mendon se mund të të shpëtojnë pasuria, pozita e familja?! Jo! Kurrsesi. Atë Ditë të shpëton vetëm puna e mirë që e ke bërë për hir të Allahut. Të shpëton agjërimi, o rob i Allahut! Agjërimi do t'i thotë Allahut: "*O Zoti im! Unë e privova atë nga ushqimi dhe epsi gjatë ditës, andaj pranoje ndërmjetësimin tim për të!dhe do t'i pranobet ndërmjetësimi*." Ti, o mosagjërues, nuk e ke me vete këtë ndërmjetësues, për faktin se e ke shpërfillur.

O lënës i agjërimit!

A nuk e di se ai që ia kthen shpinën Këshillës së Allahut të Madhëruar do të ketë jetë të mjeruar, jetë me plot brenga e mërzi. Allahu i Madhëruar ka thënë: "Kushdo që i kthen shpinën Këshillës Sime, do të ketë jetë të

“KUSH PUNON VEPËR TË KEQE OSE E NGARKON VETEN ME GJYNAHE, PASTAJ KËRKON FALJE PREJ ALLAHUT, DO TË GJEJË SE ALLAHU ËSHTË FALËS E MËSHIRËPLOTË.”

KURAN, (NISA, 110)

mjeruar dhe Ne, në Ditën e Kiametit, do ta ringjallim të verbër. Ai do të thotë: “O Zoti im, përse më ringjalle të verbër, kur unë kisha të shikuar më parë? (Allahu) do t’i thotë: “Kështu të erdhën shenjat Tona dhe ti i harrove ato e po kështu sot do të jesh i harruar.” (Taha, 124-126)

O lënës i agjërimit!

A nuk e di se ai që e braktis agjërimit, pa ndonjë arsye, është fundosur në një mëkat shumë të madh?!

Imam Dhehebiu, *Allahu e mëshiroftë!*, ka thënë: “Muslimanët janë të dakorduar se ai që e lë agjërimit e Ramazanit, pa qenë i sëmurë, konsiderohet më i keq se ai që bën imoralitet dhe ai që pi alkool. Në fakt, ata hedhin dyshime mbi Islamin e tij dhe mendojnë se ai mund të jetë nga ata që nuk janë muslimanë dhe nga ata që e shkatërrojnë realisht Islamin.”

A nuk e di se artikulli i Allahut është i

shtrenjtë?! Artikulli i Allahut është Xheneti nën të cilin rrjedhin lumenj, ku në të njerëzit do të jetojnë përgjithmonë!

Hyrja në Xhenet është e lidhur ngushtë, o rob i Allahut, me praktikimin e obligimeve që i ke ndaj Tij.

A nuk e di, o lënës i agjërimit, se Xheneti i ka tetë porta! Për Allahun, më thuaj, në cilën do të hysh, ndërkohë s’ke namaz, s’ke agjërimit e sadaka. Me se dëshiron të hysh në Xhenet?!

O lënës i agjërimit!

Ja përse këmbëngul që ti të agjërosh. Në këtë muaj:

- Prangosen shejtanët.
- Është zbritur Kurani.
- Hapen portat e Xhenetit dhe mbyllen portat e Zjarrit.
- Në të është Nata e Kadrit, Natë kjo më e mirë se një mijë muaj.



- Sadakaja në Ramazan është nga sadakatë më të mira.

- Umreja në Ramazan e ka shpërblimin e haxhit.

- Atij që e agjëron Ramazanin me besim dhe duke shpresuar (*shpërblim prej Allahut*), i falen mëkatet e kaluara.

- Është një portë në Xhenet që quhet *Rejjan*, në të në Ditën e Ringjalljes hyjnë vetëm agjëruesit.

- Agjëruesi ka dy gëzime: Një në iftar dhe një në Ditën kur do ta takojë Zotin e tij.

- Agjërimi do të ndërmjetësojë për robin në Ditën e Kiametit.

- Agjërimi është mburojë kundër zjarrit të Xhehenemit.

- Atij që agjëron një ditë në rrugë të Allahut, Ai ia largon fytyrën e tij me këtë ditë nga Zjarri shtatëdhjetë vjet.

- Tri lutje janë të pranuar: Lutja e agjëruesit, atij që i është bërë padrejtësi dhe udhëtarit.

- Era e gojës së agjëruesit tek Allahu është më e mirë sesa era e parfumit.

- Allahu liron çdo ditë grupe njerëzish nga zjarri i Xhehenemit.

- Atij që falet me imamin (*në namazin e teravisë*), derisa ai të mbarojë, do t'i shkruhet sikur të jetë falur gjithë natën.

- E shumë e shumë vlera e privilegje të tjera...

O lënës i agjërimit!

Vallë, edhe pas gjithë kësaj s'do të agjërosh?!

Mos të të mashtrojë shejtani, kinse ka kohë kur do t'i kthehesh Zotit tënd, ngase shumica e atyre që vdesin sot janë të rinjtë!

Vdekja s'të pyet. Ajo të vjen befas, e ti s'mund ta shtysh afatin e saj. Allahu i Madhëruar ka thënë: "Çdo popull ka afatin e vet. Kur t'i vijë koha e fundit, ata nuk mund ta shtyjnë, qoftë edhe për një çast dhe as nuk

mund ta shpejtojnë." (El-Araf, 34)

O lënës i agjërimit!

Të ta them edhe këtë: A nuk e di se në Somali dhe në vendet me varfëri të skajshme njerëzit vdesin urie?!

Por megjithatë agjërojnë. Ndoshta këtë s'e ke ditur?!

E ti, o lënës i agjërimit, sa e sa të mira Allahu t'i dhuroi, e, megjithatë, ende s'i bindesh Atij!

Vallë, përse kjo mosmirënjohje ndaj Zotit tënd?!

O lënës i agjërimit!

Eja... eja e kthehu te Krijuesi yt!

Bashkoju edhe ti karvanit të agjëruesve!

Përjetoji edhe ti kënaqësitë e agjërimit!

Dhe mos harro se Allahu nuk të obligon me një gjë të cilën s'mund ta kryesh! Allahu i Madhëruar ka thënë: "Allahu nuk e ngarkon askënd përtej fuqisë që ka." (El-Bekare, 285)

Dhe në fund, o rob i Allahut, e lus Allahun të të udhëzojë e të kthehesh tek Ai i penduar para se të të vijë *vdekja* e ti je mospërfillës ndaj urdhrave të Tij!

Mos harro se Allahu e do pendimin tënd, andaj kthehu tek Ai i penduar në këtë muaj! Allahu i Madhëruar ka thënë: "Kush punon vepër të keqe ose e ngarkon veten me gjynahe, pastaj kërkon falje prej Allahut, do të gjejë se Allahu është Falës e Mëshirëplotë." (Nisa, 110)

Dhe në fund: *Çdo falënderim i përket Allahut, Zotit të botëve.*



AGJËRIMI DHE SHËNDETI JUAJ

Agjërimi gjatë muajit Ramazan është i dobishëm për shëndetin tuaj, po qe se kryhet siç është i paraparë.

Kur trupi juaj ka mungesë ushqimi, ai fillon ta djegë yndyrën për të prodhuar energji. Kjo mund të çojë në humbjen e peshës. Megjithatë, nëse agjëroni për një kohë tepër të gjatë, trupi juaj mund t'i zbërthejë proteinat e muskujve për energji, gjë që nuk është e shëndetshme.

Dr. Razin Mahruf-i, një mjek anestezist nga Oxford-i, thotë se ka një lidhshmëri të fortë në mes të dietës dhe shëndetit. “Ramazani nuk është menduar gjithmonë si një mundësi për humbjen e peshës, për shkak se më shumë është theksuar aspekti shpirtëror sesa ai shëndetësor”, thotë ai. Sidoqoftë, kjo është një mundësi e shkëlqyeshme për përfitimin e të mirave shëndetësore.

Burimi i energjisë

Ndryshimet të cilat ndodhin në trup përgjatë agjërimit varen nga gjatësia e tij (agjërimit).

Trupi hyn në fazën e agjërimit rreth tetë orë pas ushqyerjes së fundit, atëherë kur lukthi përfundon absorbimin e vlerave ushqyese nga ushqimi.

Në gjendjen normale glukoza e trupit, e cila është e depozituar në mëlçi dhe muskuj, është burimi kryesor i energjisë së trupit. Gjatë agjërimit, kjo depozitë e glukozës përdoret e para për prodhimin e energjisë. Më vonë, gjatë agjërimit, atëherë kur harxhohet glukoza, burimi tjetër me radhë për prodhimin e energjisë është yndyra.

Në një agjërim që zgjat shumë ditë ose javë, trupi fillon t'i përdorë proteinat për energji. Kjo teknikisht njihet si “vuajtje urie”, gjë e cila është e dëmshme. Këtu përfshihen proteinat, të cilat lirohen nga zbërthimi i muskujve, çka është dhe arsyeja pse njerëzit që *vuajnë urie* duken shumë të thatë dhe të dobët.

Sidoqoftë, ju nuk mund të arrini në fazën “vuajtje urie” përgjatë Ramazanit, për shkak se agjërimi ndërpritet për çdo ditë (në iftar).

Tranzicion i lehtë

Për shkak se agjërimi i Ramazanit zgjat vetëm nga agimi deri në mbrëmje, energjia e trupit mund të zëvendësohet me ushqimet përpara agimit e pas mbrëmjes.

Kjo gjë mundëson një kalim të lehtë: nga përdorimi i glukozës, në përdorimin e yndyrës, si burim energjie; si dhe e parandalon zbërthimin e muskujve në proteina.

Dr. Mahrufi thotë se përdorimi i yndyrës për energji ndihmon në humbjen e peshës. Kjo i mbron muskujt dhe e ul nivelin e kolesterolit. Përveç kësaj, humbja e peshës rezulton në kontrollim më të mirë të diabetit dhe e ul shtypjen e gjakut.

“Gjithashtu ndodh edhe procesi i detoksifikimit, sepse çdo helm i grumbulluar në yndyrën e trupit tretet dhe hiqet nga trupi”, thotë dr. Mahrufi.

Pas disa ditësh agjërimi, në gjak paraqitet një nivel më i lartë i endorfinës, e cila ju bën më vigilent dhe ju bën të ndiheni përgjithësisht

mirë.


Konsumimi i balancuar i ushqimit dhe lëngjeve gjatë natës është po ashtu i rëndësishëm. Veshkat janë shumë efikase në mbajtjen e ujit dhe kripës në trup, siç është sodiumi dhe potasiumi. Sidoqoftë, këto mund të humben përmes djersitjes.

Për ta parandaluar zbërthimin e muskujve, ushqimet duhet të përmbajnë mjaft burim energjie, siç janë karbohidratet dhe një sasi yndyre.


“Dieta juaj gjatë agjëritit duhet të jetë e ngjashme me mënyrën se si duhet të ushqeheni edhe jashtë Ramazanit”, thotë dr. Mahrufi. “Ju duhet të kenë një dietë të balancuar, me proporcione të duhura të karbohidrateve, yndyrës dhe proteinave.”

Përktheu: Mr. Gëzim Zeqiri

<http://www.nhs.uk/Livewell/Healthyramadan/Pages/fastingandhealth.aspx>



Agjërimi gjatë muajit Ramazan është i dobishëm për shëndetin tuaj, po që se kryhet siç është i paraparë.




Vallë, ti je *Abdul-Mexhidi?!*

DR. MUHAMED EL-HUDEJRI

Një student imi studionte në Fakultetin e Mjekësisë dhe merrte pjesë edhe në mësimet që i mbaja në xhami. Ishte shumë i zellshëm, si në mësimet e fakultetit, ashtu edhe në mësimet që i merrte nga unë, saqë nganjëherë vinte me rroba të punës në xhami, për të mësuar. Pas përfundimit të fakultetit, shkoi në Kanada për t'i vazhduar studimet.

Në një nga pushimet e tij erdhi dhe më vizitoi. Kërkova prej tij të më tregojë diçka nga ajo që kishte parë. Më tha: “Do të ta tregoj një ngjarje të çuditshme.” Pastaj, nisi të rrëfejë: “Me mua në spital punojnë dy mjekë kanadezë muslimanë. Një ditë prej ditësh i ftova në shtëpinë time dhe filluam të bënim muhabet. U kërkova të më tregonin se si e kishin pranuar Islamin. Njëri nga ata e filloi tregimin e tij, duke thënë: “Ngjarja si e kam përqaftuar Islamin është e çuditshme! Një ditë, ndërsa isha duke ecur në një rrugë të mbushur përplot me dyqane dhe me njerëz të shumtë, pashë një zezak, që mbante ca libra në dorë dhe i shpërndante në një mënyrë të çuditshme. Gjithsecilit që kalonte pranë tij ia lëshonte si me forcë ndonjë libër në dorë dhe në mënyrë paksa të ashpër i thoshte: “Merre! Merre! Mëso!

Njihe të vërtetën! Kjo është feja e Allahut!” Edhe mua, në të njëjtën mënyrë, ma la një libër në dorë. Posa e mora librin, e flaka në shportën më të afërt që pata. Por, para se ta hidhja, e lexova titullin “The Holy Quran (Kurani i shenjtë)”. Më pas, u ktheva në shtëpi. Në mbrëmje, kur rashë për të fjetur, thashë me vete: “Ai njeri pretendonte diçka, pos kësaj më paraqiti edhe dëshmi, duke thënë se ai ishte libri i së vërtetës, ndërsa unë jam njeri që di të logjikojë. Përse nuk e mora atë libër ta lexoj?! Në qoftë se do të kisha gjetur diçka të mirë në të, do ta kisha marrë, e në qoftë se do të kisha gjetur diçka të keqe, do ta kisha lënë. Unë jam i aftë ta dalloj të vërtetën nga e kota. Vërtet ai nuk u soll mirë me mua, por një gjë e tillë nuk do të duhej të më shtynte ta bëja atë gabim.” Atë natë mezi e prita mëngjesin që ta gjeja atë njeri dhe t’ia merrja një kopje të atij libri. Kur zbardhi mëngjesi, dola në atë vend dhe po e kërkova njeriun që shpërndante libra. Por, për fat të keq, nuk e gjeta. E kërkova librin në shportë, por shporta ishte zbrazur. Pastaj vazhdova ta kërkoj atë njeri në të gjitha rrugët e asaj lagjeje, por nuk e gjeta askund. E kërkova të nesërmen, por më kot. Të pasnesërmen gjithashtu, por prapë nuk e gjeta. Kureshtja për ta lexuar atë libër më shtoej gjithnjë e më tepër. Prandaj, së paku



**“Një javë të tërë
nuk lexova tjetër,
pos këtij libri.
Kur e mbarova
leximin, kuptova
se vërtet kjo është
feja e drejtë!”**

dy herë në javë kaloja asaj rruge, me shpresë se do ta takoja. Kjo zgjati plot tre muaj. Pas tre muajsh, prej së largu, e pashë një njeri duke shpërndarë libra. Vajta me shpejtësi tek ai, dhe pashë se ishte bash ai që po e kërkoja. Por, kësaj radhe në dorë kishte ca fletushka. Ai i shpërndante si herën e kaluar, duke ua lëshuar njerëzve furishëm në duar, duke u thënë: “Merre! Merre! Lexo! Njihe të vërtetën. Kjo është e vërteta! Kjo është feja e Zotit!” Madje, hynte edhe nëpër dyqane dhe ua shpërndante në po atë mënyrë dhe me plot vullnet, mburrje e krenari. E ndala dhe i thashë: “Ma pate dhënë një libër të titulluar “The holy Quran”, por më ka humbur. A ke mundësi të ma japësh një të atillë? I thashë ashtu, ngaqë nuk doja ta merrte vesh se e kisha hedhur në shportë. Më tha: “Nuk më kanë mbetur më! Po deshe, merre këtë fletushkë. Nuk kam tjetër gjë.” Por, unë i thashë se patjetër më duhej ai libër. Më tha: “Mirë, meqë po ngul këmbë, atëherë pritme sa t’i kryej këto fletushka, pastaj shkojmë së bashku në shtëpi dhe ta jap kopjen time personale.”

Kur e mbaroi shpërndarjen e fletushkave, shkuam në shtëpinë e tij. Ma solli librin dhe më tha: “Kjo është kopja ime personale, megjithatë po ta jap ty!” E mora me kujdesin më të madh që kisha. Menjëherë shkova në shtëpi dhe gjëja e vetme me të cilën u angazhova ishte leximi i këtij libri. Fillova ta lexoja që nga faqja e parë. Një javë të tërë nuk lexova tjetër, pos këtij libri. Kur e mbarova leximin, kuptova se vërtet kjo është feja e drejtë! Atëherë, shkova në Qendrën Islame që gjendej në qytetin tim, Toronto dhe ua tregova ngjarjen time. Ata më sqaruan si të hyj në fenë islame dhe falë Allahut u bëra musliman.”

Tashti, dëgjojeni çështjen më të çuditshme! Kur përfundoi së treguari ngjarjen si e

“Ky njeri mund të mendonte se puna që po bënte është e vogël, por kush e di se sa e sa njerëz mund ta kenë pranuar Islamin, duke qenë ky shkaktar!”

kishte pranuar Islamin, mjeku tjetër e pyeti atë: “Njeriu në fjalë, mos quhej Abdul-Mexhid?” Tha: “Po! Abdul-Mexhid!” Tha: “SubhanAllah! I njëjti njeri ishte shkaktar edhe për udhëzimin tim!” Por, miku im (mjeku apo ish-studenti nga Arabia Saudite) nuk më tregoi si e kishte përqafuar fenë islame ky i fundit. Mbase mund ta ketë marrë prej tij ndonjë libër a fletushkë dhe ajo të jetë bërë shkak për ta pranuar Islamin.

Tregimi ende nuk ka mbaruar! Përkundrazi, sapo ka filluar!

Në vitin 2005, bashkë me një grup njerëzish të tjerë, shkuam në haxh nëpërmjet një shoqate humanitare. Të gjithë pjesëtarët

e grupit ishin sauditë. Por, në ditën e Arafatit, ndërsa qëndronim nën tenda, në mesin tonë vëreja një zezak të veshur me ihram. Atë e kisha parë në ditët e mëparshme të haxhit. Nuk e kisha vënë re, ngaqë isha i zënë me dhikër (përmendje të Allahut), se ishte ditë Arafati, ditë kjo të cilën që të gjithë haxhilerët e kalojnë duke e përmendur dhe duke e lutur Allahun sa më shumë. Kur erdhi mbrëmja dhe deshëm të largoheshim nga Arafati, i bëmë gati ushqimet dhe gjësendet për t’u nisur drejt Muzdelifës. Por, mjaft gjatë e pritëm autobusin. Pastaj, me të parë se autobusi po vonohej së tepërmi dhe nuk dihej edhe sa do të duhej të pritnim, u kthyem dhe u ulëm në formë rrethi në tendë. Zezaku u ul përballë meje. Unë, meqë doja ta heqja mërzinë që mbretëronte aty, pyeta: “Prej nga është ai vëllai atje?” Njëri nga fqinjët e mi ia përktheu, ngase nuk dinte arabisht. Më tha: “Jam nga Kanadaja.” Thashë: “Më vjen mirë!” Mandej e pyeta si po ecte misioni i thirrjes islame në Kanada? Ai m’i dha ca përgjigje të shkurtra. I thashë: “Do të ta tregoj një ngjarje që i ka ndodhur një njeriu në Kanada, dhe ia tregova në mënyrë të plotë, madje edhe e imitoja shpërndarësin e librave, ndonëse nuk e njihja njeriun që po më qëndronte përballë. Por, subhanAllah...



me të treguar se mjeku, pasi që e kishte lexuar librin, kishte shkuar në Qendrën Islame dhe ishte bërë musliman, zezaku që më qëndronte përballë e uli kokën dhe filloi të qante! Papritmas, m'u duk sikur dikush më zgjoi nga gjumi dhe po më thoshte: "Vallë, të jetë ky njeri ai për të cilin po flet!" Në atë moment e pyeta: "Vallë, ti je Abdul-Mexhidi?!"

"Po, unë jam Abdul-Mexhidi!!!" – ma ktheu ai. Thashë: "Ti je burri nga Kanadaja, që i fton njerëzit në Islam?!" Tha: "Po, unë jam ai!"

Mjeku saudit më kishte treguar se ky njeri rregullisht i veçon nga tri orë në ditë vetëm për t'i thirrur njerëzit në fenë e Allahut. Ia thashë këto fjalë dhe e pyeta nëse ishte e vërtetë kjo gjë. Ai e pohoi. Pastaj vazhdoi, duke thënë: "Unë nuk di arabisht, madje as që kam shumë njohuri fetare. As Kuranin nuk e kam mësuar, sepse nuk kam pasur dhe aq mundësi. Por, vazhdimisht shpërndaj libra dhe fletushka rrugëve dhe nuk e di kush bëhet musliman, e kush jo. Ja, tani e

mora vesh nga ti që dy mjekë qenkan bërë muslimanë, duke qenë unë shkaktari!"


Kështu pra, tregimi u bë aktual. Dikur thashë me vete: SubhanAllah! Ndoshta Allahu deshi ta nderojë këtë njeri në ditën e Arafatit e ta gëzonte duke e përgëzuar rreth asaj që kishte bërë Ai nëpërmjet këtij.

Ky njeri mund të mendonte se puna që po bënte është e vogël, por kush e di se sa e sa njerëz mund ta kenë pranuar Islamit, duke qenë ky shkaktar!

Prandaj, vëllezër të nderuar! Ftojini njerëzit në rrugën e Allahut, në fenë e Krijuesit, në fenë e vërtetë!

Shikojeni këtë vëlla! Edhe pse i mungonin disa nga metodat e thirrjes, si: butësia, buzëqeshja dhe fjalët e ëmbla, por, meqë qëllimin e kishte të pastër dhe të çiltër, Allahu bëri që prej punës së tij të rezultojnë këto fryte madhështore!

Përktheu: Jusuf Kastrati



"Po, unë jam ai!"



UDHËTIMI IM PËR NË FILIPINE

NAIF ES-SULEMI

Shkova ta vizitoja një mik timin në Jordani, mirëpo asnjëherë nuk më kishte shkuar ndërmend se po më priste një udhëtim i çuditshëm.

Ndërsa po shëtitnim së bashku, më tregoi se një grua filipinase, që punonte në atë vend, e kishte pranuar Islamin. Ajo punonte si shërbëtoreshë në një familje, mirëpo kishte pasur disa probleme me njerëzit te të cilët punonte. Miku im i kishte dalë në ndihmë duke ia zgjidhur problemet. Më pas e kishte ftuar në Islam, përmes një thirrësi musliman nga Filipinet, i cili përkthente. Me të parë madhështinë e Islamit dhe dëshirën e zjarrtë të mikut tim që ajo ta përqafojë fenë islame dhe të shpëtojë nga dënimi i Allahut, ajo kishte vendosur të bëhej muslimane.

Miku im tregonte: “Kur filluam t’ia themi shahadetin, ajo mezi e shqiptoi nga gëzimi. Kur e mbaroi atë, e uli kokën dhe filloi të qante me ngashërim. Kjo gjë na preku jashtë mase. Ne na kaploi një ndjenjë e thellë gëzimi, kështu që të gjithë filluam të qanim së bashku, duke e kujtuar

madhështinë e kësaj feje, e cila i çliron zemrat nga pikëllimi e vuajtjet dhe atyre u dhuron lumturi.

Pasi u ndal paksa nga të qarët tha: “Teksa e thosha shahadetin, më kaploi një dridhje e çuditshme. M’u duk sikur u bëra tjetër njeri. Një barrë e rëndë m’u hoq nga gjoksi



NAIF ES-SULEMI

dhe u ndjeva shumë e gëzuar dhe e lumtur. Më duket sikur e tërë bota u bë imja.”

Pas disa ditësh i erdhi koha e kthimit në vendin e vet, ngaqë i kishte mbaruar kontrata e punës. Ia paguam biletën e udhëtimit dhe i dhamë ca para për nevoja personale, sepse Islami na mëson ta ndihmojmë njëri-tjetrin.

E përcollëm deri në aeroport. Ajo na kërkoi që ta vizitojmë në atdheun e saj kur të kemi mundësi, për ta përcjellë mesazhin islam edhe në fshatin e saj, në jug të Filipineve, banorët e të cilit ishin të krishterë dhe nuk dinin asgjë rreth fesë islame.

Pasi kaluan disa muaj, ajo më lajmëroi se prindërit dhe familja e saj ndiheshin shumë të lumtur që e kisha ndihmuar dhe isha kujdesur për vajzën e tyre sa ishte në vend të huaj, larg familjes. Mirëpo, lajmi që më gëzoi më së shumti ishte që prindërit e saj kishin vendosur të hynin në radhët e besimtarëve, të bëheshin muslimanë. Ata kërkonin që unë të shkoja tek ata, në mënyrë që ta shqiptonin shehadetin për t'u bërë muslimanë. U përpoqa t'ua dërgoj ndonjë hoxhë nga Filipinet, por

I DËRGUARI I ALLAHUT,
MUHAMEDI, PAQJA DHE
LAVDËRIMI I ALLAHUT QOFSHIN
MBI TË, KA THËNË:

**“PO QE SE ALLAHU UDHËZON
NDOKËND NËPËRMJET TEJE,
ËSHTË MË MIRË PËR TY SESA TA
KESH PASURINË E KËSAJ BOTE.”**

~ HADITH

nuk pranuan. Thoshin se duan ta pranojnë Islamin përmes atij, sjellja dhe mirësia e të cilit u bënë shkak që ata ta duan këtë fe madhështore.

U mendova rreth kësaj. Më në fund vendosa t'i vizitoj.”

Pasi ma tregoi këtë ngjarje, miku më tha se kishte vendosur të udhëtonte për në Filipine dhe dëshironte ta shoqëroja në këtë udhëtim.

U mendova për një kohë të shkurtër dhe



“NURI I ISLAMIT MENJËHERË UA KISHTE PUSHTUAR ZEMRAT DHE GJURMËT E TIJ ISHIN SHFAQUR NË FJALËT DHE VEPRAT E TYRE. KJO ËSHTË FEJA E NATYRSHMËRISË SË PASTËR, FEJA E ALLAHUT TË MADHËRISHËM.”

vendosa ta shoqëroj, pasi që shpresoja se mos bëhesha shkaktar që dikush ta pranojë Islamin e të fitoja shpërblim të madh nga Allahu, sepse i Dërguari i Allahut, Muhamedi, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, ka thënë: *“Po qe se Allahu udhëzon ndokënd nëpërmjet teje, është më mirë për ty sesa ta kesh pasurinë e kësaj bote.”*

Iu mbështetëm Allahut dhe u nisëm me shpresë se Ai do t’i hapte zemrat e robërve të Vet dhe do t’i udhëzonte në fenë e vërtetë, me të cilën e dërgoi Muhamedin, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, për t’i nxjerrë njerëzit nga errësirat e mosbesimit në dritën e Islamit.

U nisëm drejt fshatit Rohas, në jug të Filipineve. Ndërkaq, vajza që ishte bërë muslimane dhe thirrësi filipinas po na prisnin në “Aeroportin e Manilas”, që është dhe kryeqyteti i Filipineve, për të shkuar së bashku në atë fshat, ku do të përjetonim një udhëtim të papërshkrueshëm.

Hipëm në avion dhe po fluturonim mes qiellit dhe tokës. Kalonim mbi vende të ndryshme, e poshtë nesh qëndronin krijesa madhështore të Allahut: detet, oqeanet, shkretëtirat, kodrat, pyjet e lumenjtë. Ah, sa çaste të këndshme, që e mahnitin mendjen e njeriut dhe e bëjnë ta njohë madhësinë e Krijuesit, Allahut të Lartësuar. Kur hyri koha e namazit, morëm avdes dhe filluam të falemi. Me ne u falën edhe tre vëllezër muslimanë që gjendeshin në avion. Shumica e udhëtarëve ishin të krishterë. Ndërsa faleshim, të gjithë njerëzit na shikonin dhe ndiheshin të mahnitur. Pasi e mbaruam namazin, e falënderuam Allahun që na zgjodhi në mesin e gjithë njerëzimit, duke na bërë muslimanë, dhe e lutëm Atë të na i çelikosë zemrat në fenë e Tij, që ta takonim faqebardhë. Po ashtu, e lutëm Allahun që t’i udhëzojë edhe ata jomuslimanë, në mënyrë që edhe ata ta shijojnë lumturinë në të dy botët dhe të shpëtojnë nga dënimi i përjetshëm.

U kthym në ulëset tona. Miku im ishte ulur në fillim të avionit, kurse unë përpigështa t’ia shpjegoja mirësitë e Islamit një të riu filipinas, të ulur pranë meje, ngaqë shpresoja se do të ndikonte ndonjë fjalë imja që ai të dilte nga errësira dhe të hynte në dritën e Islamit. Papritmas, derisa isha duke folur me të, erdhi miku im dhe më kërkoi t’i shkoja pas. Fytyra i qeshte dhe ndihej shumë i gëzuar. Nuk dija ç’kishte ndodhur, çka e kishte bërë mikun tim të ndihej aq i gëzuar.

E ndoqa pas, derisa arritëm te një njeri trupmadh, që nuk ishte filipinas, por amerikan i krishterë. Udhëtonte për ta vizituar familjen e gruas së vet filipinase. Miku im, ndërsa i paskësh falur dy rekate namaz vullnetar pranë tij, ky (amerikani)

qenkësh mahnitur me bukurinë e namazit. Miku im, me të mbaruar namazin, e kishte parë këtë njeri tek i buzëqeshte. Atëherë miku ishte ngritur dhe e kishte përshëndetur me buzëqeshje, duke shpresuar që ky njeri do të hynte në radhët e muslimanëve. Kishte filluar të bisedonte me të, derisa ai e kishte shfaqur mahnitjen e tij me lëvizjet që i kishte parë dhe i kishte treguar se shpresonte t'i mësonte këto lëvizje, që edhe ai të vepronte ashtu. Miku ishte gëzuar shumë dhe kishte filluar t'ia shpjegonte Islamit dhe mirësitë e tij, derisa Allahu ia kishte hapur zemrën për ta përqaftuar atë (Islamit). E kishte shqiptuar shehadetin: *Eshbedu en la ilabe il-Allah ne eshbedu enne Mubameden resulullah*, pastaj e kishte përqaftuar dhe kishte ardhur të më thërrasë mua që ta përshëndes, sepse tashmë ai ishte bërë vëlla yni.

Pas kësaj filluam t'ia plotësojmë kërkesën që kishte, t'ia mësonim namazin. Miku im filloi të falej ngadalë dhe i thoshte amerikanit, tashmë musliman, që të vepronte sikurse ai. Mandej, ai vazhdoi t'ia mësojë atij fenë islame, kurse unë i shoqërova cazë. Pastaj shkova tek ulësja ime për ta vazhduar bisedën me filipinasin që ishte i ulur pranë meje, por, për fat të keq, ai kishte rënë në një gjumë të thellë, ndaj nuk desha t'ia prish gjumin. U ula, dhe më vonë edhe mua më kishte zënë gjumi.

Kur mbërritëm në aeroport, na mirëpritën thirrësi filipinas e vajza që e kishte pranuar Islamit, dhe na treguan se ishin martuar me njëri-tjetrit. Kjo gjë na gëzoi shumë dhe u lutëm që Allahu t'u japë jetë të lumtur dhe pasardhës të devotshëm.

Hipëm në një taksì për të shkuar në ndonjë hotel, për të kaluar një natë pas një udhëtimit të gjatë. Gjatë rrugës filluam

të bisedonim me taksistin. E kuptuam se ai ishte i krishterë, kështu që nisëm t'i flasim rreth fesë islame. Ai na dëgjonte me vëmendje. Në fund të bisedës e pyetëm në dëshironte ta përqaftonte Islamit. Pranoi të bëhet musliman, e shqiptoi shehadetin dhe menjëherë filluan t'i rridhnin lot gëzimi.

U gëzuam shumë dhe e falënderuam Allahun që na nderoi duke na bërë thirrës në rrugën e Tij.

Përqaftimi i Islamit nga ky njeri, pos që na gëzoi shumë, na e shtoi forcën dhe vullnetin dhe dukej një fillesë e mbarë në udhëtimin tonë të begatë.

Shkuam në një hotel të vjetër dhe, atë natë, pushuam aty. Të nesërmen, në orën tetë të mërkurës, shkuam në stacionin e autobusëve për t'i rezervuar biletat dhe për të udhëtuar drejt fshatit të vajzës muslimane, në jug të Filipineve. Mirëpo, kur mbërritëm, të gjitha biletat ishin shitur, kështu që na u desh të prisnim një dy orë, për të udhëtuar me autobusin e radhës. U ulëm në një vend ku nuk kishte shumë njerëz dhe hëngrëm darkë. Pranë nesh kaloi një burrë. Miku im e ndali atë për t'i folur rreth Islamit. Falë Allahut, pas bisedës ai pranoi që të bëhej musliman, kështu që e tha shehadetin dhe ne i dhuruam një libër. Pas pak kaloi një tjetër burrë. E ftuam të ulej me ne për të biseduar. Pranoi menjëherë. Pasi e njohëm me fenë islame, edhe ky u bë musliman. Por jo vetëm kaq. Gjatë qëndrimit tonë dyorësh afër stacionit, Islamit e pranuan pesë burra. Zemrat na u mbushën përplot gëzim e lumturi kur e pamë mirësinë e Allahut dhe shpëtimin e këtyre njerëzve nga errësira e mosbesimit, duke hyrë kështu në nurin e Islamit. I tërë falënderimi dhe lavdërimi i takon Allahut, të Gjithëmëshirshmit!



Erdhi koha për t'u nisur. Hipëm në autobus dhe u nisëm për te caku. Udhëtimi zgjati plot dhjetë orë. Kur hyri koha e sabahut, i kërkuam shoferit ta ndalojë autobusin për ca kohë, që të mund të faleshim. U falëm dhe e vazhduam rrugën. Mbërritëm në një qytet të vogël, afër fshatit. Shkuam në një hotel, ku i lamë gjërat tona dhe darkuam. Më pas hipëm në një karrocë trirrotëshe dhe u nisëm drejt fshatit. Gjatë rrugës na lajmëruan se banorët e fshatit dhe të fshatrave të tjera përreth ishin mbledhur në një vend të madh, të mbuluar nga tri anë, dhe me padurim po e prisnin mbërritjen tonë. Kur arritëm, para se të hynim, e lutëm Allahun, i Cili na mundësoi t'i vizitojmë këta njerëz, që t'ua hapë gjokset për ta pranuar Islamit dhe të na begatojë në fjalët dhe veprat tona.

Kur hymë, pamë burra e gra, që na pritën ngrohtësisht. Ishin afro pesëdhjetë veta. U ulëm. U folëm për Islamit, mirësitë dhe rregullat e tij. Pastaj u folëm edhe për fenë e krishterë, se si është shtrembëruar dhe u treguam se Islami është feja e vërtetë,

e cila na e shpjegon çdo paqartësi. Kur e mbaruam bisedën, i pyetëm ata a donin ta përfaqonin fenë islame. Falë Allahut të Madhërishëm, të gjithë pranuan pa ngurrim dhe e shqiptuan shehadetin. E madhëruam dhe e falënderuam Allahun për këtë mirësi madhështore. Ishte kënaqësi e papërshkrueshme! U ngritëm në këmbë, u përqaftëm dhe ua uruam hyrjen në fenë e Allahut, e cila do t'ua shndërrojë jetën nga vuajtjet në lumturi. Fytyrat u shndritnin pasi qenë të ngrysur. U ulëm sërish dhe ua sqaruam kuptimin e shehadetit dhe disa rregulla të Islamit. Në fund u treguam që duam të organizojmë një drekë në ditën e nesërme në shenjë falënderimi ndaj Allahut që i udhëzoi në Islam dhe për t'i nderuar këta muslimanë të rinj.

Të nesërmen u tubuan të gjithë në të njëjtin vend. Por u befasuam kur pamë se shumë vajza, që deri dje kishin qenë të zbuluara, tani e kishin vendosur shaminë. Nuri i Islamit menjëherë ua kishte pushtuar zemrat dhe gjurmët e tij ishin shfaqur në

fjalët dhe veprat e tyre. Kjo është feja e natyrshmërisë së pastër, feja e Allahut të Madhërishëm.

Thirrësit filipinas i kishim dhënë një shumë parash për të blerë një dele dhe për ta therur atë sipas Islamit, dhe për disa gjëra të tjera. E përgatitëm ushqimin dhe u shërbyem atyre. Pasi që drekuam, na shërbyen me çaj. Pastaj u folëm për shtyllën e dytë të Islamit, namazin. Ua mësuam praktikisht avdesin e namazin, dhe secilit i dhuruam nga një libër, në të cilin shpjegohej avdesi dhe namazi në gjuhën filipinase. Biseduam edhe pak. Më pas banorët u bënë gati të shkojnë me karroca nëpër shtëpitë e tyre para se të perëndojë dielli.

U përshëndetëm me ta dhe e lamë një takim për ditën e nesërme.

Ditën e tretë i gjetëm sërish të tubuar në atë vend. Këtë herë numri i tyre ishte shtuar. Kishin ardhur edhe të krishterë të tjerë për ta pranuar fenë islame. Edhe ata, falë Allahut, e thanë shehadetin dhe hynë në Islam. U gëzuam të gjithë. Edhe atyre ua shpjeguam disa rregulla islame. Pastaj i përgëzuam se do t'ua ndërtojmë një xhami në fshat, në mënyrë që të falen aty. Po ashtu të shërbente për ta mësuar fenë islame dhe për të pasur kah të drejtohen ata që dëshirojnë ta përqafojnë fenë e pastër islame. Ata u gëzuan shumë për këtë lajm dhe kërkuan që ta bëjmë sa më shpejt që të jetë e mundur. Për ta nderuar vajzën filipinase, e cila u bë shkak që këta njerëz të hyjnë në radhët e besimtarëve muslimanë, vendosëm t'ia ndërtojmë një shtëpi pranë xhamisë, ku do të jetonte me burrin e saj musliman, thirrësin filipinas.

Në fund të këtij takimi vendosëm që secilit prej tyre t'i jepnim nga një shumë parash dhe nga një dhuratë. Përafërsisht qenë 70

veta: burra, gra e fëmijë. Dhuratat ia dhamë vajzës filipinase, që t'ua shpërndajë atyre, ngaqë ajo, siç thamë, ishte shkaku kryesor që këta njerëz të dalin nga errësira e mosbesimit në dritën e besimit të vërtetë, në fenë e Allahut Fuqplotë. Ajo u jepte dhurata secilit, një nga një, derisa lot gëzimi dhe krenarie i rridhnin pandërprerë nëpër fytyrë.

Në fund u përshëndetëm. Ata u larguan për të shkuar në shtëpitë e tyre. Nuk pushuan së përshëndeturi me dorë, derisa u larguan tërësisht.

Mbetëm vetëm ne, thirrësi filipinas, grujat e tij me prindërit dhe vëllezërit e saj. Mandej shkua ta shikojmë një vend për ndërtimin e xhamisë dhe vendosëm ta blejmë. Pastaj u kthyem në hotel. Udhëtimin e kisha të nesërmen, kurse miku im vendosi të qëndrojë edhe disa ditë, për t'i kryer procedurat e blerjes së tokës. Pasi u kthyem në hotel, na lajmëruan se kishte ardhur edhe një grup i të krishterëve nga disa fshatra të largëta dhe e kishin pranuar Islamit. Kjo na e shtoi edhe më shumë gëzimin. Vërtet përgëzimet në këtë fshat nuk kishin të ndalur!

Të nesërmen mora rrugën për t'u kthyer në shtëpi. Kësisoj mbaroi udhëtimi, në të cilin i kalova ditët më të lumtura të jetës sime.

Kaluan disa muaj dhe xhamia u ndërtua. Numri i jomuslimanëve që shkojnë ta përqafojnë Islamit në atë xhami po shtohet gjithnjë e më tepër. Për gjithë këto mirësi i tërë falënderimi dhe lavdërimi i takon vetëm Allahut, Zotit të Gjithësisë.

Përktheu: Jusuf Kastrati



O ju që e falni sabahun!

SALIH EL-HUDEJRI

“Kryeje namazin prej kthimit të Diellit (nga gjysma e qiellit) deri në errësirën e natës dhe këndo Kuran në agim; me të vërtetë, falja e mëngjesit është e dëshmuar (nga engjëjt).”

~ Kuran, (El-Isra, 78) ~

Falënderimi i takon Allahut, paqja dhe mëshira e Tij qofshin mbi të dërguarin Muhamed, familjen dhe shokët e tij.

Grupi i suksesshëm..., fytyrat e tyre shndrisin, ballët e tyre ndriçojnë, koha e tyre është përplot bereqet. Po qe se je nga ata, falënderoje Allahun për dhuntitë që t'i ka dhënë. Nëse nuk bën pjesë në grupin e tyre, atëherë e lus Zotin të të bëjë të tillë! E di se cilët janë ata?!

Ata janë falësit e sabahut! Janë të kujdesshëm ndaj këtij obligimi, e ruajnë këtë adhurim. Me të e presin ditën, me të e çelin ditën, për ta dëshmojnë melekët. Ai që e fal sabahun me xhemat konsiderohet

sikurse të ishte falur tërë natën...

Ja, i tillë është namazi i sabahut, të cilin Allahu i Lartmadhërishëm e quajti Kuran:

“Kryeje namazin prej kthimit të Diellit (nga gjysma e qiellit) deri në errësirën e natës dhe këndo Kuran në agim; me të vërtetë, falja e mëngjesit është e dëshmuar (nga engjëjt).”

(El-Isra, 78)

Kujdesi ndaj këtij namazi është nga shkaqet e hyrjes në Xhenet. Sa e sa gradë i fiton njeriu kur merr avdes për këtë namaz! Sa e sa shpërblime ka ecja për kryerjen e tij! Mandej, në kohën pas tij zbret bereqeti. I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Tij qofshin mbi të, ka thënë: “O Allahu

im, jepi bereqet umetit tim në mëngjesin e hershëm.” [Ahmedi, Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Ibn Maxheja.]

Falësit e sabahut janë ata të cilët i përgjigjen thirrësit të Allahut, kur ai thotë: “Ejani në namaz, ejani në shpëtim!” Paqja qoftë mbi këta njerëz, të cilët e kuptuan se namazi është më i mirë se gjumi, e ndjejnë domethënien e adhurimit. Andaj, ata i pritën ditët e lumtura, të përgëzuar dhe të forcuar. I Dërguari, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: “Përgëzoji me dritë të plotë Ditën e Gjykimit ata që ecin në errësirë për të shkuar në xhami.” [Tirmidhiu dhe Ebu Davudi]

O ju që e falni sabahun!

Fituat shpërblim të madh. Asnjëherë mos mendoni se pasuesit e epsheve dhe kënaqësive të përkohshme e kanë arritur lumturinë! Vallahi, ata kurrë nuk do të jenë të lumtur. Porse, luteni Allahun t’ju ndihmojë, falënderojeni dhe drejtojuni Atij! I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: “Ai që e fal jacinë me xhemat konsiderohet sikurse ta ketë kaluar gjysmën e natës në namaz, kurse ai që e fal sabahun me xhemat konsiderohet sikurse ta ketë kaluar tërë natën në namaz.” [Muslimi]

O ju që e falni sabahun!

Përgëzime për ju! Do të kënaqeni në Xhenet duke e shikuar Fytyrën e Allahut të Lartmadhërishëm. I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Tij qofshin mbi të, ka thënë: “Do ta shihni Zotin tuaj siç po e shihni Hënën: s’do të shtyheni për ta shikuar Atë. Andaj, ai që mund ta ruajë namazin para lindjes së diellit dhe atë para perëndimit le ta bëjë!” Pastaj, lexoi: “...madhëroje Zotin tënd e falënderoje Atë

para lindjes së diellit dhe para perëndimit.” [Hadithin e shënojnë Buhariu dhe Muslimi] (Kaf, 39)

O ju që e falni sabahun!

A nuk jeni të kënaqur që, ndërsa njerëzit vrapojnë pas pasurisë dhe grave, ju të ktheheni përplot gjallëri, kohë të begatshme, shpirt të pastër, dhurata të ndryshme, të hyni në kopshte dhe të zbresë mbi ju mëshira. I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Tij qofshin mbi të, ka thënë: “Ai që i fal dy namazet e freskëta (sabahun dhe ikindinë) do të hyjë në Xhenet.” [Hadithin e shënojnë Buhariu dhe Muslimi] Po ashtu, ka thënë: “Nuk do të hyjë në Zjarr ai që falet para lindjes së diellit dhe para perëndimit të tij.” [Muslimi.] Me këtë është për qëllim namazi i sabahut dhe ai i ikindisë.

O ju që e falni sabahun!

Jeni nën përkujdesjen e Allahut. Shpirtrat tuaj janë të mirë. Trupat i keni përplot me energji. I Dërguari, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: “Ai që e fal sabahun është nën mbrojtjen e Allahut.” [Muslimi] Gjithashtu, ka thënë: “Kur njeriu bie në gjumë, shejtani ia lidh në kokë tri nyje dhe i thotë: ‘Fli, ngase ke natë të gjatë përpara!’ Nëse ngrihet dhe e përmend Allahun, i zgjidhet njëra nyjë; nëse merr avdes, i zgjidhet tjetra; nëse ngrihet dhe e fal namazin, i zgjidhen të gjitha nyjat dhe bëhet aktiv e shpirtdëlirë. Në të kundërtën bëhet shpirtlig dhe përtac.” [Mutefekun alejhi]

O ju që e falni sabahun!

Ju mjafton si nder dëshmia e melekëve të të Gjithëmëshirshmit. I Dërguari, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, ka thënë:

*“Nuk do të byjë në Zjarr ai që falet para lindjes së diellit
dhe para perëndimit të tij.”*

~ Hadith ~

“Melekët ndërrohen te ju natën e ditën dhe takohen në namazin e sabahut dhe atë të ikindisë. Pastaj ngrihen ata që kanë bujtur te ju. Zoti i tyre i pyet, edhe pse e di më së miri: Si i latë robërit e mi? Ata i thonë: I lamë duke u falur dhe i patëm gjetur duke u falur.” [Mutefekun alejhi]

O ju që e falni namazin e sabahut në veçanti dhe ju që faleni me xhemat në përgjithësi, ju përgëzoj se, avdesi juaj është ngritje pozitash, ecja juaj për në xhami është fitim shpërblimesh dhe ulja juaj aty është mëshirë dhe paqe nga Zoti juaj. I Dërguari, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: “Atij që shkon në xhami Allahu ia ngrit nga një pozitë në Xhenet sa herë që shkon.” [Mutefekun alejhi] Po ashtu, ka thënë: “Namazi që falet me xhemat është njëzet e pesë herë më i mirë sesa namazi që falet në shtëpi ose në vendin e punës. Kjo është kështu, ngase kur njeriu e përkryen avdesin dhe niset për në xhami, me qëllim që ta falë namazin, për çdo hap që bën i ngrihet një shkallë dhe i fshihet një mëkat. Derisa është në namaz, melekët pareshtur luten për të, duke thënë: “O Zot, mëshiroje atë!”, deri sa nuk e prish avdesin. Madje, konsiderohet se është në namaz edhe gjatë pritjes së vetë namazit.” [Mutefekun alejhi] Ky është motërzimi i Buhariut. Kurse, në një hadith tjetër, të cilin po ashtu e shënojnë Buhariu dhe Muslimi, thuhet: “Namazi që falet me xhemat është njëzet e shtatë shkallë më i mirë sesa namazi që falet vetëm.”

Gjithashtu ka thënë: “A dëshironi t’ju

udhëzoj me se Allahu i shlyen mëkatet dhe i ngre pozitat?!” Ata iu përgjigjën: “Dëshirojmë, o i Dërguari i Allahut.” Ai u tha: “Me plotësimin e avdesit në veshitësi, me hapat e shumtë për në xhami dhe me pritjen e namazit një pas një. Kjo është ribat për ju, kjo është ribat për ju, kjo është ribat për ju (vigjilencë në rrugën e Allahut)!” [Muslimi]

Paqja qoftë mbi ata që e ruajnë namazin e sabahut, pasi që lanë ndejat dhe muhabetin e natës dhe e fituan shpërblimin e madh. Ndonjërin prej tyre e sheh tek përgatitet qysh natën për namazin e sabahut: kurdis alarmin, bie me avdes e i zbaton sunetet e tjera. E, po pati frikë se nuk do të mund të zgjohet për ta falur atë, këshillon dikë që ta zgjojë. Por, para së gjithash, është besimi ai i cili ia gjallëron zemrën. Nëse ndonjëherë e vonon ndonjë çështje nga fjetja herët, zgjohet me shpejtësi për t’u falur. Të tillët kanë shpërblim madhështor tek Allahu pasi që e falën namazin e sabahut në kohën e duhur, duke u kujdesur për të. Qëndruan të atillë dhe kësisoj përfituan tek Allahu i Lartmadhërisëm nëpërmjet veprës më të dashur.

Abdullah ibn Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të) ka thënë: “E pyeta të Dërguarin e Allahut, paqja dhe mëshira e Tij qofshin mbi të, se cila është vepra më e dashur tek Allahu i Lartësuar? M’u përgjigj: “Namazi në kohën e vet.” [Mutefekun alejh]

Këta janë burra të vërtetë e besimtarë të sinqertë. Zoti ynë ka thënë:

“Në xhamitë, që Allahu ka urdhëruar të ngrihen e të përmendet aty emri i Tij, Atë e lavdërojnë në mëngjes dhe mbrëmje, njerëz, të cilët shitblerja nuk i pengon për të përmendur Allahun dhe të cilët falin namazin dhe japin zekatin dhe të cilët kanë frikë nga Dita (e Kiametit), kur zemrat dhe shikimet do të jenë të shqetësuara. (Këta shpresojnë) që Allahu t’i shpërblejë sipas veprave më të mira që kanë bërë e t’ua shtojë dhuntinë e Tij. Allahu i jep kujt të dojë, pa llogari.” (En-Nur, 36-38)

Ndërsa, të mjerët ata që e humbën namazin, u treguan të shkujdesur ndaj tij dhe e vonuan nga koha. Ah sikur ta dinin se ç’mëkat të madh kanë kryer dhe sa shpërblime kanë humbur! I Lartmadhërishti thotë:

“Mjerë për ata që falen, të cilët ndaj namazit të tyre janë të pakujdesshëm.” (El-Ma’un, 4-5)

Po ashtu thotë: “Pas atyre erdhën breznit, që e braktisën faljen e namazit dhe ndoqën epsheet e veta. Ata do të pësojnë dënimin e madh, përveç atyre që pendohen, që besojnë dhe bëjnë punë të mirë. Këta do të hyjnë në Xhenet dhe nuk do t’u bëhet kurrfarë padrejtësie.” (Merjem, 59-60)

Ndërsa i Dërguari, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: “Gjëja e parë për të cilën do të llogaritet rob i Ditën e Gjykimit është namazi. Po qe se atë e ka në rregull, ka shpëtuar dhe ka korrur sukses. Por, nëse atë nuk e ka në rregull, ka humbur dhe është shkatërruar...” [Hadithin e shënon Tirmidhiu, për të cilin thotë se është hasen]

O ti që nuk e fal namazin me xhemat, veçanërisht namazin e sabahut! A nuk ke ambicie të jesh me këta njerëz që i ka lavdëruar Allahu?! Përse i hap rrugë shejtanit?! Përse pranon që shejtani të të urinojë në veshë? Në prani të të Dërguarit të Allahut, paqja dhe mëshira e Tij qofshin mbi të, qe përmendur një njeri i cili kishte fjetur deri pas agimit. I Dërguari, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, tha: “Shejtani i ka urinuar në veshë.” [Hadithin e shënojnë Buhariu dhe Muslimi]

O vëllai im!

Në momentin kur je duke e shijuar kënaqësinë e fjetjes, kujtoji vuajtjet dhe dhimbjet që t’i shkaktton ajo. Madje, të mjafton thënia (e sipërpërmendur) e të Dërguarit, paqja dhe mëshira e Allahut



“Atij që shkon në xhami Allahu ia ngrit nga një pozitë në Xhenet sa herë që shkon.”

~ Hadith ~

qofshin mbi të, “... bëhet shpirtlig dhe përtac.” Gjithashtu, të mjafton thënia e tij në hadithin e ëndrrës: “Sa i përket njeriut të cilit i shtypej koka me gurë është ai i cili e merrte Kuranin e më pas e kundërshtonte, si dhe flinte gjatë namazit të detyrueshëm.” [Hadithin e shënon Buhariu] Meqë ai e parapëlqeu gjumin kundrejt namazit, meriton t’i shtypet koka me gurë. Shpërblimi është paralel me llojin e veprës. Bëhu prej atyre që e falin sabahun, në mënyrë që të jesh nën mbrojtjen e Allahut, të shkruhesh në librin e të mirëve, të arrish lumturi e nur dhe të shlyhesh nga libri i dyfytërsisë! I Dërguari, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: “Nuk ka namaz më të vështirë për dyfytëreshat sesa namazi i sabahut dhe ai i jacisë. Nëse do t’ua dinin vlerën, do të vinin, madje edhe duke u zvarritur.” [Hadithin e shënojnë Buhariu dhe Muslimi]

O vëllai im!

Llogarite veten tënde, bëhu i sinqertë me Zotin tënd, çele ditën me një pendim që t’i shlyen të gjitha mëkatet e mëparshme! Kujtoji dhuntitë që t’i ka dhënë Allahu! Gjithherë lute Atë të të ndihmojë dhe lëri muhabetet e natës, sepse ato janë shkaku kryesor i ikjes së namazit! Pos kësaj, merr masa që të ndihmojnë në këtë me lejen e Allahut, siç janë: fjetja me avdes pasi ta kesh kryer dhikrin (lutjet) e fjetjes e ta kesh kurdisur alarmin! Nëse edhe pas kësaj ke frikë se nuk do të zgjohesh, atëherë porosite dikë të familjes a ndonjërin nga fqinjët të

të zgjojë apo të të thërrasë në telefon! Kur të zgjohesh, menjëherë përmende Allahun dhe ngrihu me shpejtësi nga shtrati, e mos u përpelit herë në njërin krah, e herë në tjetrin. Mos lejo të të mashtrojë shejtani duke të thënë ‘pusho veç edhe pak’, ngase pikërisht kjo gjë është prej mashtrimeve të tij!

Shmangi mëkatet, veçanërisht shikimin e ndaluar, ngase mëkati është shkak i largimit nga nënshtrimi ndaj Zotit! Bëhu i vendosur dhe kujtoje shpërblimin e atyre që shkojnë në xhami, zemrat e të cilëve janë të lidhura me të! Të tillët do të jenë një prej shtatë grupeve të njerëzve, që do të jenë nën hijen e Allahut ditën kur nuk do të ketë hije tjetër pos hijes së Tij. Ata janë të lumturit dhe të suksesshmit e kësaj jete, kurse në botën tjetër janë banorë të Xhenetit. I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Tij qofshin mbi të, ka thënë: “Tri grupe njerëzish janë të garantuara nga Allahu. Po qe se jetojnë, do të kenë furnizim të mjaftueshëm, e po qe se vdesin, Allahu do t’i fusë në Xhenet. Ai që niset për në xhami është njëri prej atyre që e kanë garancinë e Allahut.” [Hadithin e shënojnë Ebu Davudi dhe Ibn Hibani]

E lus Allahun të më lumturojë mua e këdo që e lexon këtë shkrim, në këtë e në botën tjetër, si dhe ta fitojmë kënaqësinë dhe Xhenetin e Tij.

Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi Muhamedin, familjen dhe shokët e tij.





Fëmija që falej natën

EBU JEZID EL-BUSTAMI ishte fëmijë kur i mësoi fjalët e Allahut: “*O ti i mbuluar! Çobu (të falesh) gjithë natën, përveç një pjese të saj!*” Kuran, El-Muzzemmil, 1-2. Atëherë e pyeti babanë: “Babi, kujt i drejtohet Allahu me këto fjalë?”

-Të Dërguarit tonë, Muhamedit, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, - iu përgjigj babai.

-E përse nuk vepron edhe ti si i Dërguari i Allahut, o babi?! - vazhdoi djaloshi.

-Biri im, Allahu e ka veçuar të Dërguarin e Allahut, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, duke ia bërë obligim namazin e natës, kurse ne të tjerët nuk jemi obliguar me të, - ia ktheu babai.

Atëherë fëmija heshti.

Mirëpo, kur i mësoi fjalët e Allahut: “*Natyrisht, Zoti yt e di se ti (o Muhamed) falesh më pak se dy të tretat e natës, ndonjëherë gjysmën ose një të tretën e saj, si edhe disa prej atyre që janë me ty.*” Kuran, Surja El-Muzzemmil, 20, iu drejtua babait të tij:

-Babi, po dëgjoj se disa njerëz faleshin natën. Cilët janë ata?!”

-Ata janë sahabët, shokët e të Dërguarit, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, biri im, - ia ktheu babai.

-Po përse e lë atë që vepronin shokët e të Dërguarit (Allahu qoftë i kënaqur me ta)? - pyeti sërish djaloshi.

-Ke të drejtë, biri im. Nuk do ta lë më namazin e natës, inshallah (në dashtë Zoti).

Vërtet që nga ajo natë më nuk e pat lënë namazin e natës.

Një natë Ebu Jezidi u zgjua dhe e pa babanë e tij duke u falur, kështu që i tha:

-Babi, më mëso të pastrohem dhe të falem si ti.

-Biri im, shko fli, ngase ende je i vogël! - ia ktheu babai.

-Kur të vijë Dita e Kiametit e njerëzit të dalin të vetmuar para Allahut për të parë atë që kanë punuar, Zotit tim do t'i them: "Zoti im, unë i kam thënë babait tim: "Më mëso të pastrohem që të falem bashkë me ty", kurse ai nuk ka pranuar dhe më ka thënë: "Shko fli, sepse ende je i vogël." - ia ktheu i biri.

Në këtë rast, babai i tha:

-Për Zotin, nuk do të veproj ashtu.

Atëherë ai e mësoi, dhe që nga ajo natë edhe djaloshi falej natën, bashkë me babanë e vet.

Marrë nga libri: "Enbau nuxhebai'l-ebnai" f. 185-187.

“Natyrisht, Zoti yt e di se ti (o Muhamed) falesh më pak se dy të tretat e natës, ndonjëherë gjysmën ose një të tretën e saj, si edhe disa prej atyre që janë me ty.” ~ Kuran



HAMUD ES-SELIJM

Aisheja, Allahu qoftë i kënaqur me të, tregon se i Dërguari i Allahut, Muhamedi, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, ka thënë: *“O umeti i Muhamedit! Askush nuk është më xbeloz se Allahu kur e sheh robin a robëreshën e Tij duke bërë kurvëri. O umeti i Muhamedit! Sikur të dinit atë që di unë, do të qeshnit pak e do të qanit shumë.”*

Dëlirësia ose ndershmeria nënkupton përmbajtjen e vetes nga epsheet e ndaluara dhe gjërat e pahijshme. Dëlirësia është virtyt i lartë i besimit dhe zbukurim për burrin dhe gruan, në këtë dhe në botën tjetër. Ajo na e ruan imanin dhe na e vërteton devotshmërinë tonë. Përmes saj e fitojmë kënaqësinë e Zotit dhe e ruajmë jetën e shëndetin tonë. Njëkohësisht, ajo është edhe mjet për jetë të lumtur bashkëshortore, ngase

Dëlirësia

bashkëjetesa ndërtohet mbi dëlirësi dhe pastërti.

Në lidhje me këtë, Allahu i Lartësuar në Kuran thotë: “Ata që nuk kanë mundësi për martesë, le ta përmbajnë veten, derisa Allahu t’i begatojë me dhuntinë e Tij.” (Nur, 33)

Abdullah ibn Mesudi tregon se i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Tij qofshin mbi të, thoshte: *“O Allahu im, më udhëzo, më bëj të devotshëm e të dëlirë dhe më pasuro.”* (Shënon Muslimi)

Me gjasë si sihariq më i mirë për burrin dhe gruan e dëlirë do të shërbente *hadithi i shtatë llojeve të njerëzve*, që do të jenë nën hijen e Allahut, në ditën kur nuk do të ketë hije tjetër pos hijes së Tij, në të cilin, në mes tjerash, ceket: *“...burri që ftohet nga një grua e bukur dhe me pozitë, kurse ai (e refuzon e) i thotë: “Unë i frikësohem Allahut, Zotit të botëve.”* (Shënojnë Buhariu dhe Muslimi) Ky hadith e

nënkupton edhe gruan e dëlirë, të ftuar nga ndonjë burrë, kurse ajo i thotë: “Unë i frikësohem Allahut.”

Vallë, cili njeri me arsye të shëndoshë do ta linte këtë shpërblim?! Cila është ajo kënaqësi që do të mund të barazohej me këtë dhunti madhështore?!

Dëlirësia ka dobi të shumta, disa prej tyre janë:

-Përmes saj arrihet jetësimi i imanit. Allahu i Lartësuar i përshkruan besimtarët duke thënë: “...dhe ata që e ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme).”

-Shpëtimi nga punët e liga dhe dëmet e tyre.

-Pastërtia e individit, pastrimi i shoqërisë.

-Burri dhe gruaja e dëlirë në Ditën e Gjykimit do të jenë nën hijen e Allahut.

-Dëlirësia është nder në këtë botë dhe shpëtim nga Zjarri në botën tjetër. I Lartësuar thotë: “E, nëse përmbahen, është më mirë për to. Allahu i dëgjon dhe i di të gjitha.”

-Përmbajtja nga punët e liga është mjet për martesë të suksesshme.

-Përmbajtja nga punët e liga e dëshmon qëndrueshmërinë kundrejt mëkateve.

-Dëlirësia është mburojë e familjes: Allahu ia ruan nderin atij që ia ruan nderin njerëzve.

Njeriu mund ta edukojë veten e tij në dëlirësi duke i zbatuar urdhrat e Allahut dhe duke u larguar nga ndalesat e Tij. I Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Tij qofshin mbi të, ka thënë: “*Atë që përpiqet të jetë i dëlirë, Allahu e bën të dëlirë.*” Pra, atij që e kërkon dëlirësinë, Allahu ia jep atë.

Abdullah ibn Mesudi tregon se i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Tij qofshin mbi të, thoshte: “O Allahu im, më udhëzo, më bëj të devotshëm e të dëlirë dhe më pasuro.”

(Shënon Muslimi)

Është si lulja në shkretëtirë

Motër e nderuar, kur ta veshësh mbulesën në shenjë nënshtrimi ndaj Krijuesit tënd, e jo për shkak të burrit apo babait, dhe kur me krenari vendos të jetosh si muslimane, vërtet atëherë do të shfaqje shkallë të lartë të imanit tënd.

Motër e nderuar, kur t'u përmbahesh rregullave islame të veshjes, të tjerëve u bëhet e pamundur të të trajtojnë si copë mishi, kështu që nuk u mbetet zgjidhje tjetër vetëm se të të vlerësojnë në bazë të aftësive, inteligjencës dhe kualiteteve të tua, e jo për trupin e dukjen tënde. Ti meriton një nder të madh. Ti je sikur lulja në shkretëtirë, sikur hëna në errësirë, vetëm atëherë kur me zbatimin e ligjeve të Allahut dallohesh nga të tjerët, që nuk i përfillin ato (ligjet e Krijuesit).

Me të drejtë mund të themi se me pastërtinë, moralin dhe pamjen tënde islame je dritë në këto ditë tona të errëta. Ti me dëshirën tënde të madhe dhe me bindje të fortë je nisur rrugës, të cilën e ndiqnin edhe gratë e të Dërguarit, paqja dhe lavdërimi i Zotit qofshin mbi të, dhe të gjitha besimtaret e asaj kohe. Ti je e çliruar dhe shpërfill mendimet e të tjerëve. Gjëja e vetme e rëndësishme për ty është kënaqja e Zotit tënd.

Ti u përmbahesh *rregullave islame* me përpikëri. Ti ia ke caktuar vetes vetëm një qëllim: *arritjen e një shkalle sa më të lartë në*

Xhenet. Ti je dritë që ua ndriçon rrugën të tjerëve. Ti gjithmonë bart me vete mirësi, shkëlqimi i së cilës i përfshin edhe njerëzit e tjerë. Mbulesa jote, motër e dashur, nuk është simbol nënshtrimi dhe shtypjeje, por është simbol i lirisë, i lirisë, dhe, po e ripërsëris: i lirisë! Me bartjen e mbulesës ti ke vendosur që të mos jesh e ndikuar nga idetë dhe pikëpamjet e njerëzve të ndryshëm.

Me mbajtjen e mbulesës ke zgjedhur që mënyra jote e jetesës të jetë në përputhje me rregullat e Allahut. Ti ke zgjedhur që të mos jesh robëreshë e njerëzve, por robëreshë vetëm e Allahut, Zotit të njerëzve. Me bartjen e mbulesës ti ke zgjedhur që për çdo sekondë të jesh në adhurim, ngase çdo sekondë që muslimania e kalon me mbulesë konsiderohet sekondë adhurimi.

Motër e nderuar, Islami është ai që të çmon dhe të nderon. Islami e ruan dinjitetin dhe feminizmin tënd. Islami është i tillë, që si mur u del në rrugë atyre që dëshirojnë të të përdorin si mall të lirë për qëllimet e tyre të ulëta. Islami është ai i cili të mbron duke ua mbyllur dyert të gjithë atyre që për

shkak të kënaqësive të veta dëshirojnë të të shfrytëzojnë e të të keqtrajtojnë.

Motër e dashur, padrejtësia më e madhe që të bëhet është kur shtrembërohet e drejta, duke thënë se ndershmëria e devotshmëria janë shenja të prapambetjes dhe padrejtësisë (ndaj femrave), ndërsa amoralitetin, veprat e këqija dhe degjenerimin i paraqesin si shenja të emancipimit. Kështu ndodh sot kur femra vendos t'u përmbahet rregullave islame të veshjes. Ajo etiketohet si *e prapambetur*, ndërsa kur "zhvishet" dhe ashtu ecën nëpër rrugë, atëherë në sytë e tyre ajo është e emancipuar dhe e përparuar.

Motër, nëse disa njerëz të urrejnë për shkak të nderit tënd, për shkak të zbatimit të urdhrave të Allahut, për shkak të mbulesës sate, atëherë dije se Allahu, Zoti i atyre njerëzve, është duke të begatuar! Gjithashtu

dije se urrejtja që kanë në zemrat e tyre për shkak të moralit tënd do të jetë arsye për ngritjen e pozitës sate në Xhenet!

Ti je shpresa e këtij umeti. Ti je e bija e Hatixhes, Aishes, Hafses dhe Haules, të cilat janë përmendur në shpallje. Pra, motër e ndershme, mos lejo të të njollosin! Allahu i Lartësuar të ka nderuar dhe të ka dhënë pozitë të lartë. Ai e shikon nderin tënd e për të i ka vendosur këto rregulla duke ta bërë obligim mbulesën. Nëse ti u përmbahesh këtyre rregullave, atëherë të jesh e bindur se do ta fitosh kënaqësinë e Allahut dhe do të jesh prej atyre që e fitojnë Xhenetin!

Përktheu: Arsim SYLA

“Ti meriton një nder të madh. Ti je sikur lulja në shkretëtirë, sikur hëna në errësirë, vetëm atëherë kur me zbatimin e ligjeve të Allahut dallohesh nga të tjerët, që nuk i përfillin ato (ligjet e Krijuesit).”



DOBITË E NAMAZIT PËR GRUAN SHTATZËNË



DR. AHMED MUSTAFA MUTEUELI

Hyrje e rëndësishme

Ae dini se shumë mjekë bashkëkohorë kanë përcaktuar ushtrime të veçanta fizike për gratë shtatzëna?

A e dini se për shtatzënë ekzistojnë programe të veçanta gjatë periudhës së shtatzënisë, njëherazi edhe gjatë asaj të paslindjes, për ta kompensuar lënien e lëvizjeve të domosdoshme?

A e dini se janë bërë studime të posaçme, të cilat i kanë vërtetuar dobitë e disa ushtrimeve të caktuara për shtatzënat dhe ndikimin e tyre të shkëlqyeshëm në procesin e shtatzënisë dhe atë të lindjes?

A e dini se pothuaj nuk ka spital në të cilin nuk gjenden figura apo vizatime që i

sqarojnë ushtrimet, të cilat janë të veçanta për gratë shtatzëna dhe për ato që janë pak para lindjes?

A e dini se komplikimet e shtatzënisë, ato të lindjes dhe grisja e indeve gjatë lindjes janë më të rralla tek ato gra që i bëjnë këto ushtrime të veçanta?

Për fund (po deshët mos besoni) a e dini se këto lëvizje të veçanta të këtyre ushtrimeve janë të njëjta me ato të namazit?!

Informatë e rëndësishme mjekësore

Në ditët e sotme, kur shtatzëna shkon në spital për të lindur, hyn e frikësuar, e brengosur dhe e shqetësuar për shkak të mungesës së vetëbesimit dhe moskujdesit të mjaftueshëm ndaj embrionit të saj.

Rrjedhimisht kjo i shkakton shtrëngime në muskuj, si dhe dhimbje. Dhimbjet i shkaktojnë asaj sërish frikë, e kështu me radhë... Prandaj, qetësia shpirtërore, ajo e muskujve dhe gjendja e qëndrueshme shpirtërore dhe shëndetësore janë të domosdoshme.

Studime të rëndësishme

Shumë studime kanë dëshmuar se kryerja e disa ushtrimeve të veçanta për shtatzënat e lehtëson procesin e lindjes. Andaj, mjekët në përgjithësi i këshillojnë shtatzënat t'i bëjnë këto ushtrime. Madje, pothuajse në asnjë spital nuk mungojnë disa figura apo vizatime në të cilat sqarohen ushtrimet e tilla.


Njëkohësisht këto studime dëshmojnë se komplikimet e shtatzënisë, numri i lindjeve me operacione cezariene dhe grisja e indeve gjatë lindjes janë më të rralla tek ato gra që i kryejnë këto ushtrime, krahasuar me ato që nuk bëjnë ushtrime të tilla.

Befasia!!!

Këto ushtrime, lëvizje dhe pozita i ngjajnë tërësisht lëvizjeve dhe pozitave të namazit!

Ushtrime të veçanta


1. Ushtrimi i lakimit të kurrizit te poshtë. Ky ushtrim i ngjan rukusë në namaz.



2. Ushtrimi i uljes galiç dhe ngritjes në këmbë, i cili i ngjan ngritjes dhe uljes në namaz.



3. Ushtrimi që quhet "vendosja e gjoksit në gjunjë" (Knee – Chest Position). Ky ushtrim i ngjan sexhdesë në namaz.



4. Ushtrimi i uljes dhe pushimit, i cili i ngjan uljes në namaz.



“Sikur ta dinin specialistët se ç’lëvizje dhe pozita përmban namazi, do ta kuptonin se ai është mënyra më e mirë e ruajtjes dhe shërimit sesa këto ushtrime që i ngjajnë atij (namazit).”

Tashti!

Sikur ta dinin specialistët se ç’lëvizje dhe pozita përmban namazi, do ta kuptonin se ai është mënyra më e mirë e ruajtjes dhe shërimit sesa këto ushtrime që i ngjajnë atij (namazit). Njëkohësisht do t’i këshillonin shtatzënat ta praktikonin. Madje do ta bënin atë (namazin) rregull në jetën e tyre për të gjitha pacientet. Sa rregull dhe ushtrim i mirë që është namazi.

Fundja, mjafton që ai është adhurim ndaj Allahut, afrim drejt Tij dhe kënaqje për Të! Në të ka shpërblim të madh. Madje namazi është rruga e Xhenetit dhe shpëtimit nga Zjarri. Të vërtetën e ka thënë i Dërguari ynë i zgjedhur, Muhamedi, sal-lallahu alejhi ue sel-lem, kur ka thënë: “O ju njerëz! Falini pesë namazet tuaja, agjërojeni muajin tuaj (Ramazanin), jepeni zekatën e pasurisë suaj dhe bindjuni prijësve tuaj, të hyni në Xhenetin e Zotit tuaj!” [Hadithin e transmeton Tirmidhiu, ndërsa Imam Albani e ka cilësuar si të shëndoshë.]

Dobitë trupore dhe shpirtërore të namazit

1. Shumica e muskujve dhe organeve të trupit fitojnë elasticitet.

2. E lehtëson lëvizjen e shtyllës kurrizore për ta ruajtur qëndrueshmërinë e trupit dhe drejtpeshimin.

3. E aktivizon qarkullimin e gjakut në zemër dhe i aktivizon arteriet, venat e trurin. E te shtatzënat kjo ndikon që t’ia dërgojë ushqimin embrionit me rregull nëpërmjet gjakut dhe ndihmon në zhvillimin e natyrshëm të embrionit.

4. Namazi e ruan elasticitetin e nyjave të legenit, të gishtërinjve dhe të muskujve të barkut, që i jep atij rëndësi të veçantë dhe ka ndikim të madh në ruajtjen e drejtpeshimit të nënës shtatzënë.

5. Namazi e ngrit gjendjen morale, vetëbesimin, kujdesin ndaj trupit dhe fuqinë e përqendrimit. Në të njeriu e gjen qetësinë e trupit, të shpirtit dhe atë të zemrës. Nuk ka fjalë më të mirë e më të përshtatshme për këtë gjë sesa thënia e të Dërguarit të Allahut, Muhamedit, sal-lallahu alejhi ue sel-lem: “*Qetësona me namaz, o Bilal!*”

Dobitë e namazit pas lindjes

Sa i përket dobive trupore të namazit pas lindjes dhe pastrimit, ai u jep forcë muskujve të legenit, të barkut dhe atyre të gjoksit. Me këtë rast, shtylla kurrizore ndikohet nga kjo veprimtari e muskujve, e cila e bën atë të qëndrojë drejt. Njëkohësisht nyjat e legenit dhe ato të gishtërinjve bëhen më elastike dhe më të gatshme për lëvizje, gjë që ia mundëson gruas t’i kthehet eleganca, bukuria dhe fuqia e saj. [Adnan Et-Tarsha, “Es-salatu uer-rijadatu uel-beden” (Namazi, sporti dhe trupi).]

Një pohim i shkëlqyeshëm mjekësor

Doktoresha Nexhua Ibrahim, profesoreshë në Fakultetin e Mjekësisë së Tantasë dhe njëherazi doktoreshë e grave dhe e lindjes në qendrën shëndetësore të Riadit, pohon se, zakonisht gruaja shtatzënë, veçanërisht në

muajt e fundit të shtatzënisë rëndohet nga embrioni. Por, kur ajo e fal namazin, lëvizjet e tij (namazit) ndihmojnë në aktivizimin e qarkullimit të gjakut dhe pengimin e rrezikut të variçeve të këmbëve, siç u ndodh disa grave.

6. Në lëvizjet dhe pozitat e namazit qëndron shëndeti i trupit dhe ruajtja nga vështirësitë në tretje, e cila i godet shtatzënat.

7. Rukuja dhe sexhdeja janë të dobishme për forcimin e muskujve të barkut dhe ndihmojnë në ngushtimin e lukthit dhe kryerjen e funksionit të tij në mënyrën më të mirë. Ekzistojnë ushtrime të veçanta për shtatzënat, të cilat i ngjajnë në tërësi rukusë dhe sexhdesë në namaz. Kjo është shumë e rëndësishme për shtyrjen e embrionit gjatë zhvillimit të tij të vazhdueshëm në legen. Kjo e ndihmon lindjen e natyrshme dhe ruan nga lindja cezariane. Njëherazi kjo është dëshira dhe shpresa e çdo gruaje shtatzënë.

“O ju njerëz! Falini pesë namazet tuaja, agjërojeni muajin tuaj (Ramazanin), jepeni zekatin e pasurisë suaj dhe bindjuni prijësve tuaj, të hyni në Xhenetin e Zotit tuaj!”

Shkëputur nga libri: *“El-mensu’atu edh-dhebebijje fi i’xhazji el-Kur’ani el-kerijm ues-sunneti en-nebeuijeh”*, Dr. Ahmed Mustafa Muteveli.

Përktheu: Jusuf Kastrati



ÇELËSAT E LUMTURISË BASHKËSHORTORE



PREJ ÇELËSAVE të lumturisë bashkëshortore janë:

1. Pritja e mirë.

Në të bëjnë pjesë:

- Fytyra e hapur dhe buzëqeshja.
- Zbukurimi dhe parfumimi.
- Lajmet e gëzueshme.
- Fjalët e ëmbla dhe mallëngjyese.
- Përgatitja e ushqimit sa më mirë që është e mundur.
- Kujdesi për pastërtinë e dhomës dhe fëmijëve.

2. Të folurit ëmbël dhe thirrja e butë

- Duke i thënë fjalë të mira e të ëmbla dhe duke e thirrur me emrat që më së shumti i pëlqen.
- Zbukurimi dhe parfumimi.
- Allahu është i Bukur dhe e do bukurinë.
- Hijeshia është nga ligjet e natyrshmërisë.
- Zbukurimi është virtyt i grave të devotshme.

3. Intimiteti (lidhja e ngushtë)

- Përgjigjja e menjëhershme ndaj kërkesës së burrit ndikon në dëlirësinë dhe gëzimin e tij.
- Ruajtja e shoqërisë nga punët e liga.
- Bëhu aktive gjatë marrëdhënieve, e mos u bëj sikurse i vdekuri para duarve të atij që e lan, por kushtoji kujdes të veçantë rregullave të takimit!

I Dërguari i Allahut, lavdërimi dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, ka thënë:

“Në qoftë se burri e thërret gruan e vet për të bërë marrëdhënie intime, ndërsa ajo kundërshton dhe ky fle i hidhëruar, atë (gruan) e mallkojnë melekët deri në agim.” [Mutefekun alejh. Hadithin e përcjell Ebu Hurejra. Buhariu, 3237; Muslimi, 1436]

4. Bindja ndaj burrit në gjëra të lejuara

Për bindjen ndaj burrit ka shpërblim madhështor. Kjo shihet qartë në hadithin vijues:

“Në qoftë se gruaja i fal pesë kohët e namazit, e agjëron Ramazanin, e ruan organin e saj dhe i bindet burrit, do të hyjë në Xhenet nga cilado portë që dëshiron.” [Hadithin e

shënon Ibn Hibani, 4163; përcjellë nga Ebu Hurejra]

Gruaja duhet t'i pasojë nënat e besimtarëve në bindjen e tyre ndaj të Dërguarit, lavdërimi dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, si: Fatimen, të bijën e të Dërguarit, Esmanë, të bijën e Ebu Bekrit (Allahu qoftë i kënaqur me to) dhe gratë e tjera të devotshme, në mënyrë që ta fitojë lumturinë në këtë dhe në botën tjetër.

5. *Besnikëria*

Besnikëria ka ndikim të veçantë. Ndonjëherë ndodh që burrin e godet ndonjë fatkeqësi në shëndet ose pasuri, gjë që ia ndryshon tërësisht gjendjen. Këtu shihet sinqeriteti ose ngurtësia e gruas. Në këtë rast gruaja duhet të qëndrojë pranë burrit me shpirtin e saj dhe me çdo gjë që ka mundësi, ngase kjo ia lehtëson burrit fatkeqësinë dhe e shton dashurinë ndërmjet tyre.

Mos harroni që të bëheni bamirës midis jush! (El-Bekare, 237)

Lëmosha që gruaja ia jep burrit të saj ose që e jep për të konsiderohet besnikëri, meqë me këtë arrihet: 1. shpërblimi i afërsisë, dhe 2. ai i lëmoshës.

6. *Nderimi i familjes dhe i mysafirëve të burrit*

Gruaja e devotshme e nxit dhe e ndihmon burrin e saj në bamirësi ndaj prindërve dhe

të afërmeve të tij, në mënyrë që ai ta fitojë shpërblimin madhështor dhe vetë ajo të jetë pjesëmarrëse në atë shpërblim.

Ndërsa, po që se gruaja sillet keq ndaj prindërve të burrit, atëherë ajo bëhet shkaktare për ngatërresa në familje dhe që burri i saj të bjerë në sprovë. Kësisoj shkatërrohet burri dhe bashkë me të edhe gruaja, rrjedhimisht e tërë familja.

I Dërguari i Allahut, lavdërimi dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, ka thënë:

“Qoftë i poshtëruar, qoftë i poshtëruar dhe sërish qoftë i poshtëruar!”

I thanë: “Kush, o i Dërguari i Allahut?!”

Tha: “Ai që e ka të gjallë njërin apo të dy prindërit e tij në pleqëri dhe nuk e ka fituar Xhenetin.” [Hadithin e shënon Muslimi, 2551; përcjellë nga Ebu Hurejra]

Nëse prindërit e burrit bëjnë ndonjë gabim ndaj teje, atëherë duro dhe me këtë kërkoje kënaqësinë e Allahut. Mos e kthe gabimin me gabim, sepse Allahu i mbron besimtarët dhe Ai do të bëjë që prindërit e burrit të ndihen të kënaqur me ty, meqë Ai i Vetmi i ka zemrat në dorë. Dhe, mos harro asnjëherë se, siç ia bën ti dikujt, ashtu do të ta bëjnë ty.

7. *Ruajtja e fshehtësive të burrit*

Allahu i ka lavdëruar gratë që i ruajnë fshehtësitë, duke thënë:

“NË QOFTË SE GRUAJA I FAL PESË KOHËT E NAMAZIT,
E AGJËRON RAMAZANIN, E RUAN ORGANIN E SAJ DHE
I BINDET BURRIT, DO TË HYJË NË XHENET NGA CILADO
PORTË QË DËSHIRON.”

~ HADITH ~

“Gra të mira janë ato të dëgjueshmet, që ruajnë fshehtësitë që ka urdhëruar Allahu.” (En-Nisa, 34)

Po ashtu edhe i Dërguari i Allahut, lavdërimi dhe bekimi i Tij qofshin mbi të, e ka lavdëruar atë grua që i ruan fshehtësitë e burrit të saj, duke thënë:

“Gruaja më e mirë është ajo që, kur e shikon, të gëzon; kur e urdhëron, të bindet dhe kur ti nuk je i pranishëm, ajo e ruan pasurinë tënde dhe veten e saj.” [Hadithin e shënojnë Tajalisiu, 2444, dhe Nesaiu, 3231; përcjellë nga Ebu Hurejra.]

Si t'i ruajë gruaja fshehtësitë e burrit të saj?

- T'i mbajë sekret problemet dhe kundërshtitë që ndodhin në mes tyre dhe t'i ruajë sekretet e dhomës së gjumit.

- T'i ruajë fëmijët, duke i edukuar mirë, duke i mësuar dhe duke u kujdesur për ta.

- Ta ruajë pasurinë e burrit, qoftë para a gjësende. Pra, të mos bëjë asgjë me pasurinë e tij pa marrë leje nga ai, qoftë shpenzim

apo shpërdorim.

- Ta ruajë veten dhe nderin e saj: të mos dalë pa lejen e burrit, të pajiset me rregullat islame në veshje. Pra, të mos zhvishet, të mos parfumohet dhe të mos shoqërohet me burra të huaj.


- Të mos lejojë askënd të hyjë në shtëpi pa lejen e burrit.

Thënë shkurt, gruaja është bareshë në shtëpinë e burrit dhe përgjegjëse për kopenë e vet. Asaj nuk i lejohet të shpenzojë, të shpërdorojë a të japë lëmoshë pa lejen e burrit të saj. Nuk duhet ta mendojë burrin me kërkesa të shumta, por ta nxisë atë të shpenzojë në rrugën e Allahut.

Pos kësaj, gruaja duhet t'i kushtojë kujdes të veçantë edukimit të fëmijëve në forcimin e imanit dhe pajisjes së tyre me moral islam, ashtu siç duhet të kujdeset për pastërtinë dhe shëndetin e tyre.

8. Shtëpia - vend adhurimi

- Shtëpinë bëje vend për përmendjen e Alla-



“GRUAJA E DEVOTSHME E NXIT DHE E NDIHMON BURRIN E SAJ
NË BAMIRËSI NDAJ PRINDËRVE DHE TË AFËRMVE TË TIJ, NË
MËNYRË QË AI TA FITOJË SHPËRBLIMIN MADHËSHTOR DHE
VETË AJO TË JETË PJESEMARRËSE NË ATË SHPËRBLIM.”

hut, duke lexuar Kuran, e në veçanti suren Bekare. Pasuroje atë me librari, ligjërata islame dhe me një tabelë, në të cilën do të shkruhej nga një detyrë për secilin anëtar të familjes. Njëri nga anëtarët e familjes i cakton detyrat, kurse të tjerët i zbatojnë.

- Përgatite ushqimin mirë! (Qëllimi i mirë + mundi dhe lodhja = shpërblimi i madh)

- Shtëpinë bëje faltore, mbaj ligjërata për gratë e farefisit dhe shoqet e tua. Ftoji në vizitë të devotshmit dhe lidhi fëmijët e tu me ta. Fal në të namaz të teravive dhe mbaj ndonjë fjalim të shkurtër.

- Caktojeni një ligjëratë javore me bashkëshortin dhe fëmijët.

- Agjëroni të gjithë së bashku, të paktën një ditë në çdo muaj.

- Kujdesu për pastërtinë dhe rregullimin e shtëpisë.

- Vendos ndonjë arkë të bukur bamirësie në ndonjë kënd të shtëpisë dhe shkruaj në të ndonjë fjali që nxit në bamirësi.

9. Ndhimoheni njëri-tjetrin në mirësi dhe devotshmëri

- Ndhimesa e ndërsjellë në bindjen ndaj Allahut, siç janë: namazi, përmendja e Allahut, mbajtja e lidhjeve farefisnore dhe thirrja në rrugën e Allahut.

- Ndhimesa e ndërsjellë në edukimin e fëmijëve, ku nëna shfaq dhembshuri, kurse babai kujdeset më shumë për disiplinimin e

tyre.

10. Durimi

Gruaja muslimane duhet të jetë e durueshme, si në mirëqenie, ashtu edhe në fatkeqësi. Njëkohësisht duhet të durojë çdo lëndim ose gabim që i vjen nga burri i saj, e me këtë duke shpresuar shpërblim nga Zoti i Madhërishëm.

Islami na ka nxitur të jemi durimtarë, sepse për ta ka shpërblime madhështore.

I Dërguari i Allahut, lavdërimi dhe bekimi i Zotit qofshin mbi të, ka thënë:

“Nuk ndodh që muslimanin ta godasë ndonjë lodhje, sëmundje, lëndim ose brengë, madje as t’i hyjë ndonjë gjemb, e që Allahu me këtë të mos ia shlyejë mëkatet.” [Mutefekun alejh. Hadithin e përcjellin Ebu Seidi dhe Ebu Hurejra. Buhariu, 5642; Muslimi, 2573]

Andaj, të përgëzohet motër durimtare për fitimin e kënaqësisë, mëshirës së Allahut dhe për faljen e mëkateve.

Motër e dashur, mbase mund të thuash se kjo është e vështirë të praktikohet. E pranoj se është ashtu, por ti e di se Xheneti është rrethuar me vështirësi, kurse Xhehenemi me epshe. Nëse e kërkon rrugën më të shpejtë për në Xhenet, atëherë dije se kjo është rruga më e shpejtë dhe më e shkurtër, porse duhet të kërkosh ndihmë nga Allahu i Lartësuar. Prandaj, vazhdimisht trokite

portën e qiellit, në mënyrë që Allahu të të ndihmojë në zbatimin e urdhrave të Tij dhe ndjekjen e të dashurit të Tij, Muhamedit, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, dhe çdoherë llogarit në shpërblimin e Allahut. Pra, le të jetë gjendja jote gjithmonë ashtu siç thotë Allahu në Kuran:

“Unë nxitova te Ti, o Zoti im, për të fituar kënaqësinë Tënde.” (Ta Ha, 84)

Po, motër e dashur. Beto hem në Allahun se lumturia e vërtetë është në kënaqjen e Zotit tënd, andaj kujdesu për këtë, sepse kjo botë është e shkurtër dhe me pak mund ke mundësi ta arrish lumturinë e përjetshme, në të cilën nuk ka brenga e as shqetësime. Vetëm kështu mund të jetësohet lumturia e vërtetë. Atëherë, bëje tërë jetën tënde vetëm për Allahun; zakonet dhe adhurimet e tua, rehatinë dhe mundimet, gëzimin dhe hidhërimin, dashurinë dhe urrejtjen. Pra, bëji të gjitha këto vetëm për Allahun. Atëherë, eja motër e dashur që nëpërmjet lumturisë së kësaj bote së bashku ta fitojmë lumturinë e botës tjetër. I Lartësuarit thotë në Kuran:

“Thuaj: “Në të vërtetë, namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin

vetëm Allahut, Zotit të botëve. Ai nuk ka asnjë ortak. Kështu jam urdhëruar dhe unë jam i pari që i nënshtrohem Atij”. Thuaj: “A mos vallë do të kërkoj unë tjetër zot, përveç Allahut, kur Ai është Zoti i gjithçkaje? Kushdo që bën diçka, punon për vete dhe askush nuk ngarkohet me barrën e tjetrit. Pastaj të gjithë do të ktheheni te Zoti juaj dhe Ai do t’ju tregojë për kundërshtitë që kishit mes jush.” (El-En’am, 162-164)

Pa dyshim që jeta bashkëshortore kërkon vetëmohim nga të dyja palët, në mënyrë që ajo të ketë sukses, të lulëzojë dhe t’i mënjanojë problemet që shfaqen në të. Pra, assesi nuk guxojmë ta mohojmë se përgjegjësia bie mbi të dy bashkëshortët. Çdonjëri nga ata e ka përgjegjësinë, për të cilën do ta pyesë Allahu në Ditën e Gjykimit.

Kështu që, së pari dëshiroj ta kujtoj bashkëshorten për përgjegjësinë e saj dhe rolin që duhet ta luajë ajo në kapërcimin e pengesave që shfaqen në shtëpinë e saj të lumtur.

Shkëputur nga libri “*Kejfe tekunine zeuxbeten naxhibha*”, i autores Fatin Amara

Përkthet: Jusuf Kastrati



SHEMBUJ TË NDRITSHËM NGA SHTËPIA E TË DËRGUARIT

~ MUHAMED EL-HEBDAN ~

Kushdo që lexon rreth jetës së të Dërguarit të Allahut, Muhamedit, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, mahnitet nga sjellja e tij e mrekulueshme me të gjitha shtresat e shoqërisë, veçanërisht me familjen e tij. Si vërtetim për këtë mjafton lavdërimi që ia bëri Zoti në Kuran, kur tha: *“Vërtet, ti je në një shkallë të lartë morali.”* (Kuran, 68:4)

Ndërsa, Aisheja (Allahu qoftë i kënaqur me të) thoshte: *“Moral i të Dërguarit të Allahut ishte Kurani.”* Muslimi, 746]

Në vijim do t’ju paraqesim disa shembuj lidhur me sjelljen e të Dërguarit në raport me familjen e tij.

Sjellja e të Dërguarit me gratë e veta

Jeta e të Dërguarit, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, në shtëpi dhe në mes grave të tij ishte shembulli më i mirë për dashuri, dhembshuri, thjeshtësi, ndihmesë dhe fjalë të ëmbla, e jo të hidhura e rënduese. Ai thoshte: *“Më i miri ndër ju është më i miri me familjen e tij. Unë jam më i miri me familjen time.”* [Këtë hadith e shënojnë Tirmidhiu, 3895; Ibn Maxheja, 1977; dhe Darimiu në Sunenin e tij, 2260.]

Kur e studiojmë Kuranin dhe Sunetin, shohim se si ka qenë i Dërguari i Allahut, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, në shtëpi, respektivisht me gratë e tij.

Esuedi thotë se e kishte pyetur Aishenë (Allahu qoftë i kënaqur me të) se çfarë vepronte i Dërguari i Allahut, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, në shtëpinë e tij. Ajo i qe përgjigjur: *“Ishte*



**“MORALI I TË DËRGUARIT TË
ALLAHUT ISHTE KURANI.”**

~AISHEJA~

gjithnjë në shërbim të familjes, por kur vinte koha e namazit dilte për t'u falur.” [Këtë hadith e shënon Buhariu, 676]

Urveja përcjell nga Aisheja (Allahu qoftë i kënaqur me të) se kjo e fundit ishte pyetur se ç'bënte i Dërguari i Allahut, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, në shtëpinë e tij. Ajo i qe përgjigjur: *“Ai i qepte rrobat e veta, i ndreqte nallanet dhe i bënte punët që i bëjnë burrat në shtëpitë e tyre.”* [Këtë hadith e shënon Ahmedi]

Gjithashtu Amreja përcjell nga Aisheja (Allahu qoftë i kënaqur me të) se ajo është pyetur se cila ishte puna e të Dërguarit, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, në shtëpinë e tij. Ajo i qe përgjigjur: *“Ishte njeri, sikurse të tjerët: i arnonte rrobat e veta, e milte dhinë dhe i shërbente vetes.”* [Këtë hadith e shënojnë Tirmidhiu në “Esh-shemail”]

Gjithashtu, përcillet se Aisheja (Allahu qoftë i kënaqur me të) ka thënë: *“Njëberë, ndërsa isha me të përmuajshmet, po pija (në një gotë). Pastaj atë (gotën) ia dbashë të Dërguarit*

të pinte, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të. Ai i vendosi buzët mu në vendin që kisha pirë unë dhe filloi të pinte. Mandej nisa të ha një copë mishi e pastaj ia dbashë të Dërguarit, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, e ai e vendosi gojën e tij në vendin që kisha ngrënë unë.” [Këtë hadith e shënon Muslimi, 300]

I Dërguari i Allahut, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, ishte aq i thjeshtë, saqë bënte gara me gruan e tij, siç përcillet nga nëna e besimtarëve, Aisheja (Allahu qoftë i kënaqur me të) e cila ka thënë: “Dola me të Dërguarin e Allahut në disa udhëtime të tij. Në atë kohë isha e re dhe truphollë. Ai i urdhëroi njerëzit ta vazhdonin rrugën, kurse mua më tha: “Eja të garojmë!” Garova me të dhe fitova. Nuk ma përmendi këtë gjë për një kohë të gjatë, derisa u plotësova në trup dhe e harrova atë (garën). Kur dola me të një herë tjetër në disa udhëtime të tij, ai sërish u tha njerëzve ta vazhdonin rrugën. Pasi u larguan njerëzit, më tha: “Eja të garojmë!” Garova me të, mirëpo kësaj here ai u tregua ngadhënjimtar. Atëherë filloi të qeshte dhe thoshte: “Një me një”. [Këtë



“MË I MIRI NDËR JU ËSHTË MË I MIRI ME FAMILJEN E TIJ. UNË JAM MË I MIRI ME FAMILJEN TIME.”

~HADITH~

hadith e shënon Ahmedi në Musnedin e tij, 6/264]

Madje, ndonjëherë ka ngjarë që Aisheja (Allahu qoftë i kënaqur me të) ia ka ngritur zërin të Dërguarit, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të. Kështu, përcillet nga Numan ibn Beshiri se ka thënë: “Një ditë prej ditësh Ebu Bekri vajti në shtëpinë e të Dërguarit, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, dhe kërkoi leje për të hyrë. Mirëpo, në atë çast dëgjohej Aisheja teksa ia ngrinte zërin të Dërguarit të Allahut, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të. Kur iu dha leja, hyri. E kaqi Aishenë dhe i tha: “Oj bija ime! A të Dërguarit të Allahut po ia ngre zërin?!” Transmetuesi tha: “Atëherë, i Dërguari i Allahut ndërhyri në mes tyre. Kur doli Ebu Bekri, i Dërguari i Allahut i tha asaj për t’u pajtuar: “A nuk e sheh që unë ndërhyra në mes teje dhe tij (a nuk e sheh që të shpëtova)?!” Pastaj, Ebu Bekri u kthye dhe kërkoi leje për të hyrë sërish, mirëpo e gjeti të Dërguarin e Allahut teksa e bënte Aishenë të qeshte. Kur iu dha leja dhe hyri, tha: “O i Dërguari i Allahut, ma mundësoni të marr pjesë në paqen tuaj, ashtu siç më bëtë të marr pjesë në luftën tuaj!” [Këtë hadith e shënojnë Ahmedi në Musnedin e tij, 4/272]

Ndërsa Enesi në hadithin e tij rreth Safijes (Allahu qoftë i kënaqur me ta)

ka thënë: “E kam parë të Dërguarin, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, teksa e mbulonte atë (Safijen) me një mbulesë. Mandej ulej pranë devesë së tij duke e vendosur gjurin. Pastaj Safija e vendoste këmbën e saj mbi gjurin e tij, në mënyrë që të hiqte.” [Këtë hadith e shënon Buhariu, 4211]

Kurse Aisheja (Allahu qoftë i kënaqur me të) ka thënë: “Një ditë të Dërguarit, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, ia solla një lloj gjelle me mish dhe miell, të cilën e përgatita për të. Atëherë i thashë Seudes: “Ha dhe ti!”, mirëpo ajo refuzoi. Kurse i Dërguari, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, ishte ulur në mes meje dhe saj. Asaj i thashë: “O do të hash, o do të ta përhyej fytyrën.” Por, ajo sërish kundërshtoi. Atëherë e futa dorën në gjellë dhe ia përleva fytyrën me të. I Dërguari filloi të qeshte dhe mori (gjellë) me dorën e tij për Seuden dhe i tha: “Përhyeja edhe ti fytyrën asaj!” dhe vazhdoi të qeshte”. [Është përmendur në “Mexhme’ ez-zeuaid”, 4/315]

Marrë nga libri: “Dhulmu’l-mer’eb”,
Muhamed El-Hebdan

RAPORTET E KËQIJA MES NUSEVE DHE VJEHRRAVE

Falënderimet takojnë Allahut, kurse përshëndetjet dhe selamet të Dërguarit të Tij, familjes dhe shokëve të tij.

Pothuajse nuk ka shtëpi pa probleme mes nuses dhe vjehrrës. Në disa shtëpi ato janë të vogla, kurse në disa të tjera më të mëdha. Madje aq të mëdha sa mund të çojnë deri te ndarja në mes të burrit dhe gruas apo të shkaktojnë grindje dhe ftohje të raporteve në mes të burrit dhe nënës, e pastaj edhe babait të tij.

Shkaku kryesor i këtyre problemeve është sjellja e keqe e nuses përballë nënës së burrit, pasuar nga mendimi i keq për vjehrrat ose si pasojë e presionit të ndokujt prej të afërmeve të saj. Por, nganjëherë këto probleme vijnë edhe si rezultat i disa sjelljeve të nënës së burrit kundrejt nuses së saj. Sjelljet e tilla vijnë si rezultat i disa paragjykimeve që i ka vjehrra, e cila mendon se, para martesës së djalit, ai ishte i tëri i saj, kurse sot ka ardhur në shtëpi dikush me të cilën duhet ta ndajë djalin e vet. Prandaj, ajo përpiqet ta ruajë gjendjen e mëparshme me çdo kusht dhe në çfarëdo mënyre.

Roli i burrit në këtë rast mund të jetë: roli i gjykatësit ose ai i të urtit. Nëse bëhet gjykatës dhe e arrin pajtimin e nënës me gruan, ky pajtim nuk do të zgjasë shumë dhe sërish do të kthehen problemet. Nëse vepron me urtësi, nuk mund të punojë gjithherë në bazë të drejtësisë, që të mos e lëndojë nënën ose të mos e hidhërojë gruan, prandaj ndodh që shkon në punë dhe mendon për problemet ose i diskuton me shokë për të gjetur zgjidhje.

Ai'herë, cila është zgjidhja e këtyre problemeve?

Zgjidhja është e lehtë dhe në dorën e nuses, po qe se u përmbahet këshillave vijuese:

1. Kije frikë Allahun në vetmi dhe prani të të tjerëve dhe kujtoji fjalët e Tij:

“Atij që i frikësohet Allahut, Ai do t'i gjejë rrugëdalje (nga çdo vështirësi) dhe do t'i japë risk prej nga nuk e pret.” (Et-Talak, 2-3)

2. Forcoje imanin e bindjen tënde dhe të jesh e sigurt në premtimin e Zotit të botëve, i Cili thotë:

“Allahu, në të vërtetë, i mbron besimtarët.” (El-Haxh, 38)

3. Mos e përgojo vjehrrën dhe mos shpif

kundër saj, jo vetëm në prani të burrit, por as në prezencë të prindërve të tu. Mos harro ç'pasoja sjell përgojimi dhe bartja e fjalëve.

4. Burri yt e do nënën e vet dhe ti nuk mund t'ia largosh atë dashuri nga zemra, kështu që mos u mundo. Mos e informo atë për të këqijat e nënës së tij, nëse dëshiron të të dojë shumë.

5. Po qe se burri të pyet për sjelljet e nënës së tij, thuaji: Allahu e shpërbleftë dhe ia faltë gjynahet, e mos i thuaj diç tjetër, dhe kujtoje shpërblimin e durimtarëve dhe bamirësve.

6. Nëse të ngushtohen punët, thuaj shpesh:

"Hasbij Allahu ue ni'mel-Uekil" (Mua më mjafton që e kam Allahun, Ai është mbrojtësi më i mirë).

Allahu i Lartësuar ka thënë:

"(Shpërblim kanë edhe ata) të cilëve njerëzit (bipokritë) u thanë: "Shumë njerëz po mblidhen kundër jush, prandaj frikësohuni!" e kjo gjë ua shtoi atyre besimin dhe thanë: "Neve na mjafton Allahu, Ai është mbrojtës i mrekullueshëm!" Ata u kthyen me dbuntitë dhe mirësitë e Allahut, nuk i gjeti asgjë e keqe dhe fituan kënaqësinë e Allahut. Allahu është Zotërues i mirësive të mëdha." (Al-Imran, 173-174)

7. Mos e ngrit zërin në prani të nënës së

burrit dhe ki kujdes nga fjalët e pamatura, sepse fjala e keqe i shkakton zemrës plagë që vështirë shërohen.

8. Dije se fjalët e këqija, sharjet dhe ofendimet janë armë të gruas së dobët, pa vetëbesim e me probleme psiko-shpirtërore, dhe të gruas e cila për shkak të mangësive të veta përpiqet t'i akuzojë të tjerët.

9. Të keqen ktheje me të mirë, që ta jetësosh urdhrin e Allahut të Lartësuar:

"Nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë mik i ngushtë." (Fussilet, 34)

10. Nxite burrin në respektim dhe mirësi ndaj prindërve të vet, sepse nëse ata janë të kënaqur me të, ai do të jetë i lumtur, rrjedhimisht edhe ti. Në të kundërtën, asnjëri s'do të jeni të lumtur.

11. Ki kujdes nga xhelozia ndaj vjehrrës sate dhe mos ndërmer asgjë kundrejt saj, edhe nëse vëren smirë tek ajo.

12. Bëji mirë të gjithëve, qoftë edhe nëse nuk janë familjarë të burrit tënd, sepse kjo sjell dashuri mes jush.

13. Mos u tall me vjehrrën tënde, mos i komento sjelljet e saj, mos e nënçmo dhe dije se ajo është nëna jote e dytë.

14. Nëse vjehrra të kërkon ndonjë shërbim, mundohu ta realizosh atë sipas

**“NUK BARAZOHET E MIRA ME TË KEQEN!
TË KEQEN KTHEJE ME TË MIRË E
ATËHERË ARMIKU YT DO TË TË BËHET
MENJËHERË MIK I NGUSHTË.”**

~ KURAN, (FUSSILET, 34)

mundësisë, pa nervozizëm dhe ankesë.

15. Dije se në të ardhmen edhe ti do të bëhesh vjehërr, e “atë që e mbjell, atë do ta korrësh”, dhe dije se në fund triumfi u takon të devotshmëve.

16. Mos e ngarko burrin tënd me këto probleme dhe lëre të mendojë në ndërtimin e familjes.

17. Problemet që i ke me vjehrrën mos i përcill te familja jote, por tregohu durimtare dhe falënderuese, sepse me falënderim zgjaten begatitë, kurse durimi është çelës i zgjidhjes së problemeve.

18. Mos u gëzo kur i ndodh diçka e keq vjehrrës sate, si për shembull ndonjë sëmundje, por mundohu ta ndihmosh, ta disponosh e t'i shërbesh, dhe bëj dua për të. Tërë këtë bëje duke shpresuar në kënaqësinë e Allahut, i Cili për një të mirë shpërblen dhjetëfish.

19. Fale namazin në kohën e vet, sepse namazi është shtylla kryesore e devotshmërisë së përmendur në fillim të këtyre këshillave. Gjithashtu, përmende Allahun vazhdimisht, që të jesh e lumtur dhe të kesh qetësi shpirtërore, siç thotë Allahu i Lartësuar:

“Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!” (Err-Rra’d, 28)

20. Përpiqu që herë pas here, sidomos gjatë festave, t’ia bësh vjehrrës ndonjë dhuratë, nxite edhe burrin të veprojë kështu, duke e pasur parasysh hadithin e të Dërguarit, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të: *“Shkëmbeni dhurata, që të dubeni.”*

21. Ki kujdes nga pakënaqësia a parashttrimi i pyetjeve kur burri yt i dhuron nënës së vet ndonjë dhuratë ose kur i blen diçka

që i nevojitet, sepse ajo ka më shumë të drejta tek ai sesa ti dhe familja jote.

22. Dije se ti je pjesë e të mirave të kësaj bote, siç thotë i Dërguari, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të: *“Kjo botë ka begati, e begatia më e madhe e saj është gruaja e mirë.”*

Sa i përket nënës, i Dërguari, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: *“Qëndroji pranë, sepse Xheneti është nën këmbët e saj.”*

23. Mos u mashtro me rininë, bukurinë dhe prejardhjen tënde e të tregohesh mendjemadhe karshi vjehrrës sate, sepse Allahu e urren mendjemadhësinë dhe vetëkënaqësinë.

24. Për problemet tuaja mos kërko zgjidhje në filma dhe seriale, sepse zgjidhja gjendet në mësimet islame, në të cilat ka udhëzim dhe dritë. Allahu i Lartësuar thotë:

“Juve ju erdhi prej Allahut dritë dhe Libër i qartë, me të cilin Allahu i drejton ata që ndjekin pëlqimin e Tij, në rrugën e shpëtimit, i nxjerr nga errësira në dritë me lejen dhe vullnetin e Vet dhe i shpie në rrugën e drejtë.” (El-Maide, 15-16)

25. Mbështetu plotësisht në Allahun, në përputhje me fjalën e Tij:

“Allahu i mjafton kujt do që mbështetet tek Ai.” (Et-Talak, 3)

26. Nëse u përmbahesh këtyre këshillave, me lejen e Zotit do të jesh margaritar i çmueshëm i burrit tënd, pa të cilin ai nuk mund të qëndrojë dhe do të kesh sukses në jetën bashkëshortore dhe në ndërtimin e një familjeje shembullore.

Le të jetë sllogani yt i përhershëm fjala e Allahut të Madhërishtëm:

“Atë që rubet (nga gjynabet) dhe bëhet i durueshëm, Allahu e shpërblen, se Ai kurrë nuk

“KJO BOTË KA BEGATI, E BEGATIA MË E MADHE E SAJ ËSHTË GRUAJA E MIRË.”

~ HADITH



ia humb shpërblimin punëmirëve.” (Jusuf, 90)

Këshilla për të gjithë

Në vijim do t’i paraqesim disa këshilla për nënën e burrit, nënën e gruas dhe vetë burrin.

Këshilla për nënën e burrit

1. Kije frikë Allahun në raport me djalin tënd dhe gruan e tij. Largohu nga çdo padrejtësi, qoftë në fjalë a në vepër. Në një hadith është thënë: “*Në Ditën e Kiametit padrejtësitë janë errësira.*”
2. Mos u bëj sikur ortake për nusen tënde, por bëju nënë e dytë dhe këshilluese e saj.
3. Mos prit nga një vajzë e re që të jetë e përsosur dhe e përkryer, sepse ajo është në fillim të jetës së saj.
4. Mos i përhap të metat e nuses sate dhe ndihmoji që të fitojë vetëbesim, sepse në

të kundërtën do të të urrejë.

5. Shtoji lutjet për të dhe djalin tënd, sepse, si nënë që je, lutja jote pranohet. Gjithashtu nxite burrin tënd të bëjë lutje për të sepse edhe atij, si prind që është, i pranohet duaja.
6. Mos ndiej pakënaqësi nga ndonjë dhuratë që djali yt ia bën gruas së tij a nga ndonjë udhëtim i tij familjar së bashku me gruan e tij, dhe dije se gjëra të tilla, bile edhe më të mira, do të bëjë për ty.
7. Shfaqi të mirat e nuses sate para djalit tënd, anashkaloji të këqijat e saj, nëse nuk kanë të bëjnë me nder dhe fe, dhe mos u mundo të fusësh te djali yt urrejtje kundër saj.
8. Dije se ti je nënë, kurse ajo bashkëshorte dhe që të dyja keni të drejta, andaj ndihmoji birit tënd që t’jua japë të dyjave të drejtat që ju takojnë.
9. Mos shfaq neveri përballë familjes së

nuses sate dhe mos harro sa herë ke shkuar tek ata, e sa rrugë ke bërë, kur e kërkoje dorën e saj për djalin tënd. Gjithashtu, mos i harro premtimet dhe shpresat për mirësjellje që ua ke dhënë atyre menjëherë pas martesës.

10. Respektoje familjen e nuses, që nusja të të respektojë ty.

Këshilla për nënën e nuses

1. Mos ndërhyj në punët familjare mes bijës sate dhe burrit të saj, sepse çdokush i ka problemet e veta.

2. Këshilloje vajzën tënde vazhdimisht për mirësi, sepse *“Feja është këshillë”*.

3. Nëse vajza jote të vjen e hidhëruar, lere të shprehet, pastaj këshilloje dhe tregoja gabimet e saj, nëse ka. Assesi mos kontribuo në ndarjen e saj nga burri dhe përmendi asaj shembuj nga jeta e përditshme, sepse prej tyre përfiton i

mençuri.

4. Bëhu nënë e dytë për dhëndrin tënd, kujdesu për të, respektoje dhe mos e ngarko me diçka që nuk mund ta përballojë.

5. Tregoja bijës sate mirësitë dhe burrërinë që ke vërejtur te burri i saj dhe mos ia përmend të metat e tij, sepse mund ta urrejë atë.

6. Largohu nga çdo gjë me të cilën mund të akuzohesh në rast të problemeve në mes të vajzës dhe burrit të saj, sepse zakonisht shoqëria në këto raste e akuzon nënën e djalit dhe atë të vajzës.

Këshilla për burrin

1. Kije frikë Allahun në çdo situatë, dhe, nëse sprovohesh, duro, duke shpresuar në shpërblimin e Allahut të Madhërishëm.

2. Ruaje gjuhën tënde nga të folurit e ndaluar, nderin tënd nga imoraliteti dhe



dije se mëkati ndikon në sjelljet e gruas sate.

3. Jepja çdokujt atë që e meriton dhe mos i bëj padrejtësi nënës sate nga dashuria e madhe për gruan, sepse Xheneti është në këmbët e nënës.

4. Mos lësho pe nga burrëria dhe nga të drejtat që t'i ka dhënë Allahu, siç janë: të qenët zot shtëpie, e drejta për shkurorëzim është në dorën tënde, leja për largim nga shtrati i gruas (në rast të mosbindjes së saj) pasi ta kesh këshilluar atë dhe të është lejuar rrahja e lehtë, po qe se e kërkon nevoja.

5. Mos e lejo gruan të të flasë për të metat e nënës sate dhe tërhiqja vërejtjen nga bartja e fjalëve dhe përgojimi.

6. Respektoj prindërit dhe vëllezërit e gruas sate, nëse dëshiron të fitosh dashurinë e tyre.

7. Largohu nga shkurorëzimi me kushtëzim (p.sh. të thotë: nëse bëhet ndonjë punë ose nëse nuk bëhet ndonjë çështje e caktuar, atëherë gruaja ime është e shkurorëzuar) sepse mahia dhe

serioziteti në çështjen e shkurorëzimit e kanë dispozitën e njëjtë. Mos fut në shtëpinë tënde revista të ndyra dhe mos e lejo gruan të shikojë filma të pavlerë.

8. Mos e ndiz zjarrin në mes të gruas dhe nënës sate e pastaj të mos mund ta fikësh atë.

9. Shpeshtoji duatë, largohu nga haramet e dukshme dhe të padukshme, largohu nga shokët e këqij dhe mos e bëj shprehi daljen e vazhdueshme dhe vonesën jashtë shtëpisë, sepse prania jote në shtëpi është mburojë për familjen tënde. Kujtoje çdoherë fjalën e Allahut të Lartësuar:

“Vërtet, Allahu është me ata që e kanë frikë dhe që janë punëmirë.” (En-Nahl, 128)

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve.

Përktheu nga arabishtja: Arben Ahmetaj

LE TË JETË SLLOGANI YT I PËRHERSHËM
FJALA E ALLAHUT TË MADHËRISHËM:
**“ATË QË RUHET (NGA GJYNAHET) DHE
BËHET I DURUESHËM, ALLAHU E
SHPËRBLËN, SE AI KURRË NUK IA HUMB
SHPËRBLIMIN PUNËMIRËVE.”**

KURAN, (JUSUF, 90)

Babi, a mund të m'i huazosh 10 euro?

Babai u kthye vonë nga puna, i lodhur e i kapitur. I biri i tij pesëvjeçar po e priste me padurim te dera e shtëpisë.

-Babi, a mund të të pyes diçka?

-Natyrisht, biri im. Ç'ka ndodhur? - ia ktheu babai.

-Babi, sa të paguhet ora?

-Kjo s'të hyn fare në punë? Pse bën pyetje të tilla? - iu përgjigj me plot zemërim.

-Epo, thjesht dua ta di. Të lutem, më thuaj sa të paguhet ora? - e luti më tej vogëlushi.

-Meqë patjetër dashke ta dish, i fitoj 20 euro në orë.

-Oh! - psherëtiu vogëlushi. -Babi, të lutem, a mund të m'i huazosh 10 euro?

Babai u tërbua.

-Nëse ky qenka qëllimi yt i vetëm, pse dëshiron të dish sa fitoj që t'i marrësh ca para për të blerë ndonjë lodër të marrë a diçka koti? Shko menjëherë në dhomën tënde dhe fli! Mendo ç'egoist je. Unë dërrmohem për orë të tëra çdo ditë, e nuk kam kohë për këso lojëra qesharake.

Vogëlushi shkoi qetas në dhomën e vet dhe e mbylli derën.

I ati zemërohej gjithnjë e më shumë për shkak të pyetjeve të vogëlushit. Si guxon të më bëjë pyetje të tilla vetëm që të nxjerrë ca para?! Pas një ore, prindi u qetësua dhe filloi të mendojë se mos ishte treguar pak i ashpër ndaj të birit. Ndoshta ai kishte diçka që duhej të blinte me këto 10 euro! Pos kësaj, ai nuk më kërkon shpesh para. Vajti te dera e dhomës së fëmijëve dhe e hapti atë.

-Kolopuçi im, fjete? - e pyeti ai.

-Jo babi, ende jam i zgjuar, - iu përgjigj djaloshi.

-Mendoj se u solla pak ashpër ndaj teje, - i tha i ati. -Ishte një ditë e gjatë dhe e lodhshme, e kështu e shfryva mllefim tim në ty. Ja ku i ke 10 eurot që m'i kërkove.



Vogëlushi u ngrit menjëherë i ngazëllyer.

-Oh, babi, të falënderoj shumë! - thirri ai.


Pastaj nxori me vrull ca kartëmonedha të zhubrosura nën jastëkun e tij. Kur babai kuptoi se djaloshi kishte para, u zemërua sërish. Djaloshi i numëronte paratë me kujdes dhe pastaj e shikonte babanë e tij.

-Përse kërkon edhe më tej para prej meje, kur ti paske?! - e pyeti babai.

-Ngase nuk kisha mjaftueshëm, e tani kam! - ia ktheu djaloshi. -Babi, tash i kam 20 euro. A mund ta blej një orë nga koha jote, që ta kalosh me mua?

Përktheu nga gjermanishtja: Jusuf Kastrati

“Babi, tash i kam 20 euro. A mund ta blej një orë nga koha jote, që ta kalosh me mua?”



Si ta kultivojmë **VETËBESIMIN** te fëmija

VETËBESIMI nuk është cilësi që mund të fitohet brenda ditës a natës. Njeriu i pavendosur ka nevojë për përpjekje të vazhdueshme që t'i kthehet vetëbesimi. Për këtë arsye prindërit vazhdimisht duhet të punojnë për të mbjellë vetëbesim në zemrat e fëmijëve që në moshën e fëmijërisë, në mënyrë që ata të kenë personalitet të fortë dhe vetëbesim.

Në vijim do të paraqesim disa faktorë, të cilët u ndihmojnë prindërve si ta kultivojnë vetëbesimin te fëmijët e tyre:

1. Lavdëroje fëmijën tënd në prani të të tjerëve.
2. Mos e bëj atë që ta kritikojë veten.
3. Gjatë bisedës me të përdor fjalë të tilla: “mundësisht” dhe “faleminderit”.
4. Trajtoje atë si fëmijë dhe lëre ta përjetojë fëmijërinë e vet.
5. Ndihmoje, që vetë të marrë vendime.
6. Mësoja notin.
7. Shpalle mysafir nderi në ndonjë ndejë.

8. Pyete ç'mendim ka rreth ndonjë çështjeje dhe ndonjëherë vepro sipas tij.
9. Caktoja një kënd në shtëpi për t'i kryer punët e veta dhe shkruaja emrin në gjërat që i bën ai.
10. Ndihmoje në përzgjedhjen e shoqërisë.
11. Bëje që ta kuptojë rëndësinë e vetvetes dhe se Allahu i ka dhënë forcë.
12. Mësoje të falet bashkë me ty dhe mbilli në të parimet e besimit në Allahun.
13. Mësoja aftësitë e shprehjes së mendimit, prezantimit dhe mënyrën e komunikimit me njerëz.
14. Mësoje si t'u qaset informatave dhe si t'u përmbahet atyre.
15. Mësoje t'ia caktojë vetes disa parime dhe detyra, të cilave do t'u përmbahet.
16. Mësoje si jepet ndihma e parë.
17. Përgjigju të gjitha pyetjeve që t'i bën.
18. Përmbushe premtimin që ia bën.
19. Mësoje të përgatisë ushqime të thjeshta, siç është skuqja e vezëve, nxejja e bukës etj.
20. Mësoja rëndësinë e duasë (lutjes).
21. Mësoje të bashkëpunojë në grup.
22. Nxite të parashtrijë pyetje.
23. Bëje të mendosh se ka pozitë të lartë në mesin e shokëve të vet.
24. Sqaroja shkaqet e çdo vendimi që ti merr.
25. Qëndro me të në ditën e parë të shkollës.
26. Rrëfeji tregime të fëmijërisë sate.
27. Bëje fëmijën tënd ta luajë rolin e mësuesit, ndërsa ti luajë rolin e nxënësit.
28. Mësoje fëmijën tënd si të gjendet në rast se e humb rrugën.
29. Mësoje t'i thotë "jo" çdo lloj gabimi.
30. Mësoje të bëhet dorëhapur.
31. Jepi para të mjaftueshme.
32. Nxite të mësojë përmendsh dhe t'i përsërisë gjërat që i mëson.
33. Mësoje si të vetëmbrohet.
34. Sqaroja gjërat në të cilat ka mëdyshje.
35. Kurrë mos e kërcëno.
36. Paralajmëroje para se të gabojë.
37. Mësoje si të ballafaqohet me dështimin.
38. Mësoje t'i kursejë paratë.
39. Provo ndonjë gjë të re për ty dhe fëmijën tënd, duke i ditur paraprakisht rezultatet.
40. Mësoje t'i rregullojë gjërat e veta dhe t'i rendisë ato.

41. Ndajini bashkërisht ëndrrat dhe ambiciet dhe nxite të ketë ambicie të larta.
42. Mësoja dallimet në mes gjinisë mashkullore dhe asaj femërore nëpërmjet ajeteve kuranore.
43. Mësoja parimet dhe vlerat e mirëfillta.
44. Mësoje të bartë përgjegjësi për sjelljet e veta.
45. Lavdëroje për punët që i kryen dhe sukseset që i arrin.
46. Mësoje si të sillet me kafshët shtëpiake.
47. Kërkoji falje për çdo gabim që i bën.
48. Ndonjëherë bëji ndonjë befasi.
49. Ndhmoje ta bëjë shprehi që për çdo ditë të lexojë Kuran.
50. Tregoji se e do dhe përqafoje fort, sepse sidomos kjo gjë ia rrit vetëbesimin.

Burimi: www.denana.com






Si ta drejtosh një kritikë

Pothuajse nuk ka dialog në të cilin mungojnë kritikata. Mirëpo me qëllim që kritika të ushtrojë ndikim, për të qenë e pranuar dhe për t'u arritur përmirësimi i sjelljes, medoemos duhet të merren parasysh rregullat vijuese:

1. Sigurohu në vërtetësinë e të dhënave që të shtyjnë ta kritikosh ndokënd. Pra, mos e bazo kritikën tënde në burime të pasigurta, siç janë fjalët: “kanë thënë”, “thuhet” ose “thonë”!
2. Pëlqehet që para se ta kritikosh ndokënd, të fillosh nga pikat në të cilat pajtoheni.
3. Mos i kritiko të tjerët kur je i nervozuar. Së pari qetësohu, ngase kjo është një kohë e ndjeshme që kërkon nga ti të jesh sa më objektiv!
4. Mos kritiko në shumë gjëra përnjëherë, në mënyrë që bashkëbiseduesi të mos mendojë se dëshiron ta poshtërosh!
5. Ji i qartë gjatë kritikës dhe përmend argumente të qarta!
6. Kritikoje sjelljen e jo personin. Pra, përqendrohu në ngjarjen ose gabimin që është bërë, e jo në individë!
7. Synimi yt gjatë kritikës të jetë përmirësimi e jo sulmi a ngadhënjimi ndaj të tjerëve!
8. Shfaq mirëkuptimin dhe butësinë tënde ndaj atij që ia drejton kritikën, sepse kjo gjë të ndihmon ta fitosh besimin e tij!
9. Mos e akuzo bashkëbiseduesin se gabimi i tij ka ardhur si rezultat i qëllimit të tij të keq!
10. Mos e ngarko bashkëbiseduesin me më shumë kritika sesa që mund t'i bartë, në mënyrë që të mos dëshpërohet!
11. Po qe se bashkëbiseduesi nuk i ka në rregull gjërat thelbësore, atëherë mos u lodh t'i kritikosh sjelljet dytësore, por fillo nga parësorja!
12. Përqendrohu në ato sjellje që bashkëbiseduesi mund t'i ndryshojë dhe përpiqu t'ia përmendësh gjërat që mund të jenë zëvendësim për to!

Marrë nga libri: “Ed-delijl el-’ilmij lil-hiuar el-benna”, Ahmed El-Mezjed

DISA DALLIME NDËRMJET KURANIT DHE BIBLËS



~ SENAD MAKU ~

“AI TA ZBRITI TY (MUHAMED) LIBRIN ME ARGUMENT, QË
ËSHTË VËRTETUES I LIBRAVE TË MËPARSHËM. AI E ZBRITI
MË PARË TEVRATIN DHE INXHILIN.”

KURAN, (ALI IMRAN, 3)

LIBRAT E SHENJTË të hebraizmit janë të bashkëpërmbledhur me librat e shenjtë të krishterimit dhe së bashku përbëjnë një përmbledhje të quajtur *Bibël*. Ky emër vjen nga greqishtja *he biblos* (apo *biblion*) “libri”, kurse në trajtën e zvogëlimit *ta biblia* (apo *bibla*) “libërthat” a “përmbledhje librash”.¹ Përbëhet nga dy pjesë kryesore: *Dhiata e vjetër* dhe *Dhiata e re*. *Dhiata e vjetër* është libri i shenjtë i hebrajve, kurse *Dhiata e re* është libri i shenjtë i të krishterëve.

Në anën tjetër, libri i shenjtë i fundit i zbritur prej Zotit të Madhëruar është Kurani, i shpallur për tërë njerëzimin. *Kuran* do të thotë “i lexueshëm”. Etimologjikisht rrjedh nga folja (arabe) *kare'e* “të lexosh”

apo “lexim”.

Kurani është Fjalë e pashoq e Allahut të Lartësuar. Ai, nëpërmjet të besueshmit Xhibril, i është shpallur vulës së të dërguarve, Muhamedit; është shkruar në *mushafë*² dhe i përcjellë në mënyrën më të besueshme deri te ne (*tevaturen*); leximi i tij është adhurim; fillon me suren “El-Fatiha” e përfundon me suren “En-Nas”.³

Bibla nuk është një libër, por përmbledhje librash. Ajo, sipas versionit protestant, përmban 66 libra, kurse, sipas versionit romano-katolik, përmban 73 sosh.⁴

Bibla është një përzjerje e thënieve hyjnore me komente njerëzore të ardhura më vonë, duke falsifikuar e ndryshuar shkrimin e shenjtë dhe duke vendosur mendimet dhe fjalët e veta. (Shih: Jeremia, 8:8; Luka,

1:1-4; 1 Korintasve, 7:25). Origjinalet e këtyre librave, si të Dhiatës së vjetër ashtu dhe të ungjijve, kanë humbur. Kurani nuk përmban komente dhe ndërhyrje njerëzore, siç ka ndodhur me vetë Biblën, madje as fjalët e Muhamedit, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, nuk janë pjesë të Kuranit. Fjalët e tij quhen “hadithe”.

Në Bibël gjenden disa libra që janë shkruar shumë vite pasi të dërguarit përkatës kishin vdekur dhe jo në gjuhën e vetë atyre, kështu duke krijuar një numër vështirësish në analizimin e tyre, duke hasur në të gabime, kontradikta, mospërputhje faktesh etj., sa kohë që i tërë Kurani u shkrua gjatë jetës së Muhamedit, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, dhe u mësua përmendsh nga qindra njerëz në gjuhën origjinale.

Të “katër ungjijtë” kanonikë nuk ishin ungjijtë e vetëm. Vendimi se, ç’duhet të jetë në *Bibël* dhe çfarë nuk duhet, u mor sipas gjykimit të njerëzve. Në Islam nuk është mbajtur as edhe një konferencë, në të cilën do të përcaktohej se cila sure duhet të jetë e cila të mos jetë në Kuran. Në Dhiatën e re të “katër ungjijtë” e japin jetën dhe misionin e Jezusit (Isait), alejhi

selam, kurse Kurani nuk është biografi e Muhamedit, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, shkruar nga pasuesit e tij. Ky është një dallim shumë i madh ndërmjet Biblës dhe Kuranit.

Po t’i analizojmë disa dallime esenciale në të dy librat, do ta vërenim praninë e dallimeve themelore në besim, që i gjejmë në të dy tekstet. Këto dallime janë:

Në *konceptin e Zotit*. Bibla e përshkruan Atë si një Zot që lodhet (Eksodi, 31:17; Zanafilla, 2:2); një Zot që harron (Psalmi, 13:1; Vajtmet, 5:20); i pafuqishëm (Zanafilla, 32:28); një Zot që fle (Psalmi, 44:23; 78:65); i pamëshirshëm (Psalmi, 77:7-9); dituri e mangët e Zotit (Zanafilla, 3:8); Zoti përshkruhet në formën e njeriut (Zanafilla, 1:26; 9:6); një Zot që ka familje (Eksodi, 4:22; Ligji i përtërirë, 32:19; Ezekieli, 16:3-32; Hebrenjve, 5:5; Psalmi, 2:7); një Zot që ka nevojë për udhëheqjen e njeriut (Eksodi, 12:13); padrejtësia e Zotit (Jobi, 19:6-7); një Zot që e thyen premtimin (Levetiku, 26:44); një Zot që pendohet për atë që bën (Zanafilla, 6:6-7), dhe shumë “argumente” të tjera, që janë në kundërshtim me Qenien e Zotit të Lartësuar.

Në anën tjetër, Kurani i hedh poshtë këto



trillime. Shih ajetet që u kundërvihen këtyre citateve biblike: Kaf, 38; Ta-Ha, 52; Haxh, 74; Bekare, 255; Zumer, 53; Bekare, 115; Shuara, 11; Nahl, 74; Ihlas, 1-4; Maide, 18; Furkan, 6; En-Am, 59; Junus, 44; Nisa, 40; Ibrahim, 42; Rrum, 6; e shumë ajete të tjera.

Cilësitë e Allahut të Lartësuar, që tregohen në Kuranin famëlartë, janë absolutisht të përkryera, të përhershme. Fjalët që flasin për vetitë e Allahut të Madhëruar tërësisht dallohen nga kuptimi i fjalëve që i përdorim për ndonjë veti të qenieve të gjalla. Ndërkaq, në disa citate të Biblës i gjejmë të kundërtat e kësaj. Këto cilësi janë mbërthyer nga teprimet, tejkallimet, përdhosja e deri te degjenerimet e asaj që është thelbi i tyre, d.m.th. fjalët i janë shmangur thelbësore dhe kuptimit të së vërtetës. Vetitë e Zotit në Bibël në të vërtetë janë pasqyrim i ëndjeve, cilësive dhe dëshirave të pikëpamjeve e qëndrimeve njerëzore: Zoti cilësohet me të gjitha vetitë që cilësohen edhe njerëzit. Pra, koncepti biblik i Zotit është krejt i ndryshëm nga ai i Kuranit. E Allahu i Madhëruar, në Kuranin famëlartë, thotë: *“I Lartësuar është Zoti yt, Zot i fuqisë nga ajo që i përsbkrnajnë.”* (Saffat, 180)

Po ashtu edhe në *konceptimin e të dërguarve* ka dallime. Bibla i quan profetët mëkatarë, gënjeshtarë, tradhtarë, u jep shumë epitete të tjera, kryerje të veprave të shëmtuara e të ndyra etj. Është për ta tërhequr vëmendjen qëndrimi i Biblës ndaj të dërguarve, ngase, kur flet për ta, pothuajse të gjithë dalin si mëkatarët më të dalluar. I quan si gënjeshtarë, tradhtarë, të padijshëm, autorë (bërës) gabimesh e mëkatesh, dhe me epitete të tjera që u vishen atyre. Në Bibël hasim tregime trishtuese në lidhje me

ta, sepse i paraqet si personazhe kryesore në kryerjen e veprave më të shëmtuara dhe të ndyra. Këto veti nuk përputhen me njeriun e rëndomtë, pale t'i ketë ndonjë i dërguar, që është njeri i zgjedhur nga Allahu i Madhëruar.

P.sh: Luti, alejhi selam, bëri zina me dy të bijat e veta (Zanafilla, 19:30-38); Haruni, alejhi selam, si njeriu që e konstruktioi viçin për ta adhruar izraelitët (Ekzodi, 32:1-20); Sulejmani, alejhi selam, u martua me 700 gra dhe 300 robëresha e u bë idhujtar (1 Mbretërve, 11:3-7); Zoti e urdhëron profetin Osea që të martohet me prostitutë, e të ketë fëmijë të kurvërisë (Osea, 1:2); Jakobin e quan si *dinak* dhe *mjeshtër intrigash* të shumta (Zanafilla, 27:16; 19-36/32:24-30); Juda bëri zina me nusen e të birit, Tamarën, dhe ajo mbeti shtatzënë me të e lindi dy binjakë, Faresin dhe Zaran, e, si rezultat i kësaj zinaje nderohen Davudi dhe Sulejmani si stërgjyshërit e Jezusit-Isait, alejhim selam (Zanafilla, 38:12-30, Mateu, 1:3-16) etj.

Kurse Kurani i ngre në shkallën më të lartë të dërguarit dhe i bën shëmbëlltyrë për ne. Zoti i nderoi të dërguarit e Tij të zgjedhur, që të ishin ndërmjetësues të Allahut dhe robërve të Tij. I veçoi për ta bartur amanetin e Zotit (Shpalljen) për thirrje të vazhdueshme për të besuar në një Zot. Zgjodhi njerëz të pajisur me moral të lartë, njerëz fisnikë dhe që rrjedhin nga familjet me prejardhje të pastër, njerëz besnikë dhe të kujdesshëm në punën e tyre. Kur e lexojmë Kuranin, shohim se Zoti i Lartësuar i pajisi ata me cilësi që duhet t'i ketë çdo i dërguar, si: i drejtë, i vërtetë, besnik, i sinqertë; transmetues i Shpalljes së Zotit; i zgjuar, i mençur, i mbrojtur nga gabimet, pa të meta fizike etj.



Domosdoshmëria që çdo i dërguar t'i posedojë këto veçori a cilësi dalluese është çështje që përputhet me logjikën e shëndoshë, ngase nuk ka mundësi që një njeri i tillë të posedojë cilësi negative, të cilat i zbehin moralin e tij si pejgamber. Morali i tyre është shumë më i lartë se i njerëzve të tjerë. Po ata, në të njëjtën kohë, nuk e arrijnë gradën e hyjnisë, ngase mekanizmat kuranorë e ndalojnë një gjë të tillë, sepse shkalla më e lartë është “robëria më e lartë” ndaj Allahut të Lartësuar. Përshkrimet, shpifjet e tilla ndaj të dërguarve, jo vetëm që nuk gjenden në Kuran, por konsiderohen mëkatarë ata që ua veshin këto epitete të dërguarve të Zotit. Ja ç'thotë Allahu i Madhëruar në Kuran: *“Pasha Allahun, pajtetër do të merreni në përgjegjësi për atë që trillonit.”* (En-Nahl, 56); *“Pa dyshim ai që shpif, ka dështuar keq.”*

(Ta Ha, 61); “Po a nuk është Xhebenemi vend për jobesimtarët?” (Ankebut, 68)

Gjithashtu dallime thelbësore gjejmë edhe për sa i përket besimit në jetën e tanishme dhe të përtejme, në konceptin e shpëtimit dhe drejtimit në jetë. Po ashtu dallime kemi edhe në histori, ku Kurani dhe Bibla nuk përputhen. P.sh: tek Ademi dhe Havaja, tek Ibrahim, Ismaili, Ishaku⁵, Luti, Musai, Isai etj.

Duke e parë devijimin e popujve nga rruga e vërtetë dhe ndryshimin e librave të shpallur nga Zoti i Lartësuar, Ai që para 14 shekujsh e çoi të Dërguarin e Tij të fundit, Muhamedin me Fjalën e Tij përfundimtare, dërguar njerëzimit. Librat e mëhershëm nuk mbetën siç u shpallën. Bibla e sotme, siç thamë më lart, është një përzierje e gjurmëve të mbetura të Fjalëve të Zotit me fjalët e profetëve,

historianëve, autorëve dhe njerëzve të tjerë. Rrjedhimisht as autorët e librave nuk dihen saktësisht.

Këtë e vërteton studiuesi dhe eksperti i krishterimit të hershëm, Bart D. Ehrman⁶, i cili thotë: “Skribët profesionistë në krishterim janë shfaqur në një periudhë shumë të vonshme, aty rreth shekullit IV. Për këtë arsye, është e natyrshme që në kopjet e hershme të jenë bërë gabime të shumta gjatë kopjimit. Mirëpo, më me rëndësi është fakti se këta skribë kanë qenë të përfshirë personalisht në debatet teologjike, që kanë marrë plot jetë njerëzore në krishterimin e hershëm.... Duke pasur parasysh polemikat, konfliktet e ndryshme, mosmarrëveshjet teologjike dhe, veçanërisht debatet mbi kriptologjinë,⁷ skribët e krishterë u nxitën t’i ndryshonin fjalët e shkrimit të shenjtë, në mënyrë që t’i bënin më të dobishme për debat. Skribët e ndryshuan tekstin në dorëshkrimet e tyre, për t’i bërë tekstet më qartësisht “ortodokse” dhe më pak të “keqpërdorshme” nga kundërshtarët e tyre.⁸ Kjo ka ndodhur sa herë që skribët përgjegjës për kopjimin e tekstit kishin dashur të siguroheshin që vetë teksti të thoshte pikërisht atë që ata dëshironin të thoshte.”⁹

Islami apo Kurani është ai që e ringjalli dhe përtëriu fenë e të gjithë të dërguarve të tjerë. Vlera kryesore me të cilën Islami apo Kurani ka ardhur është sqarimi i *konceptit të Zotit*, që është edhe esenca e vërtetë e fesë. Koncepti i Zotit në krishterim ka rënë deri në atë shkallë sa Zoti të krahasohet me vetitë dhe cilësitë e njeriut, kështu duke i bërë shirk (shok) Zotit, duke e adhuruar dikë tjetër në vend të Tij etj.

Kurani është një udhëzues që e ndan dritën nga errësitat dhe na tregon në mënyrë të përkryer se ç’mund të besohet e çfarë nuk mund të besohet nga Bibla.¹⁰

Po ashtu nuk duhet harruar se Kurani flet për shumë ngjarje që përmenden edhe në Bibël. Pra, pikësëpari, ngjashmëria nuk do të thotë medoemos kopjim i një libri prej një tjetri, siç mendojnë disa, se Kurani na qenka *kopje e Biblës*. Allahu e bën të qartë në Kuran se mesazhi që Ai po shpallte nëpërmjet Muhamedit nuk ishte diçka e re, veçse ishte një vazhdim i zinxhirit të mëhershëm të porosive të dhëna nga Zoti, nëpërmjet të dërguarve të mëparshëm.

“Ne të frymëzuam ty me shpallje sikurse patëm frymëzuar Nuhin dhe pejgamberët pas tij; patëm frymëzuar Ibrahimin, Ismailin, Ishakun, Jakubin dhe pasardhësit e tij, Isanë, Ejubin, Junusin, Harunin e Sulejmanin, kurse Davudit ia patëm dhënë Zeburin.” (Nisa, 163)

“E, sa pejgamberë kemi dërguar te popujt e lashtë?!” (Zuhruf, 6)

“Secili popull kishte të dërguarin e vet, e kur u vinte i dërguari i tyre, bëhej gjykimi i drejtë në mes tyre, atyre nuk u bëhet padrejtësi.” (Junus, 47)

Është e natyrshme që mesazhi i atyre të dërguarve ishte i njëjtë, ngase ato vinin nga i njëjti Zot dhe tash, meqë në Bibël kanë mbetur gjurmë të mesazhit të vërtetë të përcjellë nga ata, nuk është aspak e çuditshme nëse edhe në Kuran gjejmë paralelizma apo përkime me ngjarje të caktuara. Nëse mendojmë se Kurani është kopje e burimeve hebraiko-krishtere (e Biblës) vetëm për faktin se të dy librat flasin për disa ngjarje të njëjta, ky është një mendim shumë naiv.

Ndërsa, për ndryshimin dhe falsifikimin e Biblës, Zoti u drejtohet njerëzve nëpërmjet Kuranit famëlartë: “Mjerë ata që me duart e tyre shkruajnë Librin, e pastaj thonë: “Kjo është prej Allahut”, që për këtë të kenë ndonjë dobi të vogël (materiale). Mjerë ata për çfarë kanë shkruar me duart e tyre dhe mjerë ata ç’kanë fituar!” (Bekare, 79)

Por, njëkohësisht, meqë Kurani na tregon për shtrembërimin e Biblës dhe falsifikimin e saj, shtrohet pyetja: a thua na tregon edhe vetë Bibla për ndryshimin e saj. Këtë më së miri na e tregojnë disa nga citatat e Biblës, si p.sh:

a) Tek Jeremia, 8:8, thuhet: “*Si mund të thoni: “Ne (hebrejtë) jemi të urtë dhe ligji i Zotit është me ne?” Por ja, pena e rreme e shkruarve e ka bërë një falsitet.*”

b) “*Kur Moisiu mbaroi së shkruari në një libër tërë fjalët e këtij ligji, u dha këtë urdhër levitëve që e mbanin arkën e besëlidhjes së Zotit, duke thënë: “Merreni këtë libër të ligjit dhe vendoseni në arkën e besëlidhjes së Zotit, Perëndisë suaj, me qëllim që të mbetet si një dëshmi kundër teje; sepse unë e njoh frymën tënde rebele dhe fortësinë e qafës sate. Ja, sot kur akoma jam i gjallë midis jush, ju u bëtë rebelë kundër Zotit; aq më tepër do të bëheni mbas vdekjes sime!” (Ligji i Përtërirë, 31:24-27)*

“Mblihdni pranë meje të gjithë pleqtë e fiseve tuaja dhe zyrtarët tuaj, me qëllim që të dëgjojnë këto fjalë dhe unë të thërras të dëshmojnë kundër

tyre qiellin dhe Tokën. Sepse unë e di që, mbas vdekjes sime, do të korrubtoheni plotësisht dhe do të largoheni nga rruga që ju kam urdhëruar, dhe ditët e fundit do të goditeni nga fatkeqësia, sepse keni për të bërë atë që është e keqe për sytë e Zotit, duke provokuar indinjatën e Tij me veprën e duarve tuaja.” (Ligji i Përtërirë, 31:28-29)

Nga kjo vërehet se Moisiu/Musai, alejhi selam, paralajmëroi dhe e dinte se Tevrat (pesëlibërshi i tij) do të shtrembërohej dhe do ta ndryshonin pas vdekjes së tij, dhe vërtet ashtu ndodhi.

c) Po ta analizojmë mirë Dhiatën e re, do të vërejmë se edhe aty kemi të bëjmë jo me Fjalën e Perëndisë, po me shkrime të njerëzve të ndryshëm dhe pa inspirimin e Tij, si p.sh:

Tek Ungjilli sipas Lukës, shkruan: “*Mbasi shumë veta ndërmorën të renditin tregimin e ngjarjeve që ndodhën në mesin tonë, ashtu si na i përcollën ata që ishin bërë nga fillimi dëshmitarë okularë dhe shërbyes të fjalës, m’u duk e mirë edhe mua, pasi i hetova të gjitha gjërat me kujdes që nga fillimi, të t’i shkruaj sipas radhës, fort i nderuari Teofil, që ti të njohësh vërtetësinë e gjërave që të kanë mësuar.” (Luka, 1:1-4)*

Nga vargu i lartshënuar tregohet qartë se:

- Së pari, Ungjilli sipas Lukës ishte vetëm një ndër shumë narracionet e shkruara në dekadat e para pas Jezusit nga njerëz të ndryshëm (*Mbasi shumë vetë ndërmorën të renditin tregimin e ngjarjeve që ndodhën në mesin tonë*);

THUAJ: “O ITHTARËT E LIBRIT, EJANI TË BIEM NË NJË FJALË TË PËRBASHKËT NË MES NESH DHE JUSH: SE DO TA ADHUROJMË VETËM ALLAHUN, SE NUK DO T’I SHOQËROJMË ATIJ ASGJË (NË ADHURIM) DHE SE NUK DO TA MBAJMË PËR ZOT NJËRI-TJETRIN, NË VEND TË ALLAHUT!” KURAN, (ALI IMRAN, 64)

- Së dyti, ky shkrim i drejtohej Teofilit personalisht nga Luka dhe jo njerëzimit nga Perëndia (*fort i nderuari Teofil, që ti të njohësh vërtetësinë e gjërave që të kanë mësuar*); dhe

- Së treti, më e rëndësishmja është se ky Ungjill nuk ishte shkruar nën frymëzimin e Zotit, por ishte shkruar pasi Luka kishte konsultuar burime të ndryshme (*pasi i hetova të gjitha gjërat me kujdes që nga fillimi*); qoftë të shkruara, qoftë gojore, origjinën e të cilave as nuk e dimë e as që mund ta verifikojmë. E njëjta gjë vlen edhe për shumë nga shkrimet e tjera të Dhiatës së re dhe asaj të vjetër.

d) Një rast tjetër ka të bëjë me Palin, me letrat e tij, të cilat në fakt përbëjnë pjesën më të madhe të Dhiatës së re, ku shihet mjaft qartë se nuk ka kurrfarë dëshmie se ai ishte i frymëzuar nga Zoti përderisa i shkruante ato letra. Në një mori rastesh ai e bën të qartë se në letra po e shprehte mendimin e tij dhe jo të Perëndisë:

“... s’kam urdhër nga Zoti, por po jap një mendim si njeri...” (1 Korintasve, 7:25)

“... sipas gjykimit tim...” (1 Korintasve, 7:40)

“...dhe mendoj se edhe unë kam Frymën e Perëndisë...” (1 Korintasve, 7:40)

“... Ja, unë, Palë, po ju them...” (Letra e Palit Galatasve, 5:2)

Siç shihet, te 1 Korintasve, 7:40 vihet në dyshim edhe frymëzimi i mësimave të Palit në tërësi. Aty tregohet se ai nuk ishte i sigurt nëse e kishte Frymën e Perëndisë apo jo. Përse duhet të besohen për fjalë të Zotit letrat e Palit, nëse ai vetë e bën të njohur aty se pohimi që ai e kishte frymën e Zotit ishte mendim i tij personal dhe nuk ishte i konfirmuar nga Perëndia.

Duke pasur parasysh se vetëm në një artikull nuk mund të shtjellohet gjithçka për sa u përket dallimeve në mes dy librave: Biblës dhe Kuranit, jam përpjekur të shtjelloj disa nga gjërat më elementare, për të dëshmuar dallimet dhe vërtetësinë e tyre në lidhje me të dy tekstet.

Këtë artikull dua ta përfundoj me Fjalët e Allahut Fuqiptotë, që në librin e Tij të fundit, në Kuranin famëlartë, thotë:

“Ky Kuran nuk është i tillë që të mund të bëhej prej dikujt tjetër përveçse prej Allahut. Përkundrazi, ai është vërtetues i shpalljeve të mëparshme dhe shpjegues i Ligjit (për njerëzit) dhe, pa dyshim, është zbritur nga Zoti i botëve!” (Junus, 37)

“Ai ta zbriti ty (Muhamed) Librin me argument që është vërtetues i librave të mëparshëm. Ai e zbriti më parë Tevratin dhe Inxhilin. Udhërrëfim për njerëz, e zbriti edhe Furkanin (dalluesin e së vërtetës nga gënjeshtria). S’ka dyshim se ata që mohojnë argumentet e Allahut, i pret ndëshkimi i rreptë. Allahu është ngadhënjyes, shpagimtar.” (Ali Imran, 3-4)

Thuaj: “O ithtarët e Librit, ejani të biem në një fjalë të përbashkët në mes nesh dhe jush: se do ta adhurojmë vetëm Allahun, se nuk do t’i shoqërojmë Atij asgjë (në adhurim) dhe se nuk do ta mbajmë për zot njëri-tjetrin, në vend të Allahut!” (Ali Imran, 64)

“Nuk ka detyrim në fe, rruga e drejtë është dalluar shumë qartë nga ajo e padrejta.” (Bekare, 256)

Kërkesa jonë e fundit është:

Të gjitha falënderimet dhe lavdërimet qofshin për Allahun, Zotin e botëve! Amin!

REFERANCAT:

1 *Bibla*, përktheu dhe shtjelloi Dom Simon Filipaj, Ferizaj, f. 11, 1994; dhe Ekrem Murtezai, “*Fjalori i feve*”, f. 62.

2 Lexo: mus-haf.

3 “*Kurani, Përkthim dhe komentim*” nga H. Sherif Ahmeti, f. 10.

4 Duhet theksuar se dallimi kryesor në mes Biblës katolike dhe Biblës protestante ka të bëjë me çështjen e librave që gjenden në të. Në Biblën katolike (*Bibla*, Përkthim dhe shtjelloi Dom Simon Filipaj, Ferizaj, 1994) dhe në atë protestante (*Bibla*, Diodati i Ri, përkthim 1991-94) dallimi qëndron në faktin se Bibla katolike ka 7 libra më tepër se Bibla protestante, kurse të dyja sektet librin e tyre e quajnë “të shenjtë”. Atëherë, shtrohet pyetja: pse ky dallim ndërmjet Biblave? Cila në të vërtetë është Fjalë e Perëndisë?

5 Lexo: Is-haku.

6 Bart Ehrman është një studiues i njohur i Dhiatës së re si dhe një ekspert i krishterimit të hershëm. Masterin dhe doktoratën i ka kryer në Seminarin Teologjik të Princentonit. Aktualisht është shef i departamentit të studimeve fetare në Universitetin “Chaper Hill” të Karolinës së Veriut. (Biografi nga libri i tij: “*Të keqçitosh Jezusin...*”, në fund të librit).

7 Kriptologjia: shkenca që merret me shifrimin dhe me deshifrimin e shkrimeve të fshehta. (Mikel Ndrecaj, “*Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja*”, Prishtinë, f. 415, 2000).

8 Bart D. Ehrman, “Të keqçitosh Jezusin” si dhe: “Përse u ndryshua Bibla”, f. 10.

9 Po aty, f. 78. Gjatë shekujve II dhe III, po ashtu gjatë kohës së Konstantinit, Bart Ehrman tregon se këta dy shekuj kanë qenë veçanërisht të pasur në ndryshime teologjike ndërmjet të krishterëve të hershëm. Në të vërtetë, dallimet teologjike ishin kaq shumë të shtrira, saqë grupe që e quanin veten e tyre të krishtera ndiqnin besime dhe praktika që shumë të krishterë sot do të këmbëngulnin se nuk kanë të bëjnë aspak me krishterimin. (Po aty, f. 78) Po ashtu Bart D. Ehrman thotë: “Ç’dobi ka të thuash se tekstet origjinale të Biblës janë të frymëzuara? Ne nuk i zotërojmë tekstet origjinale, por kemi vetëm një kopje të mbushura me gabime dhe shumica e këtyre dorëshkrimeve janë prodhuar shekuj më vonë se origjinalet.” (Po aty, f. 27). “Ishte e qartë se kishte një problem në pohimin se Bibla ishte verbalisht

e frymëzuar në çdo fjalë të saj. Siç mësuam në një nga kurset e para të ndjekura në institut, ne nuk i zotërojmë dorëshkrimet origjinale të Dhiatës së re. Ajo që ne kemi përbëhet nga kopje të këtyre shkrimeve, të bëra vite më vonë. Mbi të gjitha, asnjëra prej këtyre kopjeve nuk është krejtësisht e saktë, duke qenë se skribët që i kanë prodhuar ato, pa dashje ose qëllimisht, i kanë ndryshuar në vende të ndryshme. Të gjithë skribët e kanë bërë këtë. Kështu, në vend që të kemi fjalët e frymëzuara të autorëve (d.m.th. origjinalet) e Biblës, ajo çka kemi janë vetëm kopje të shkruara në gabime të shumëfishimeve.” (Po aty, f. 23)

10 Dallimi ndërmjet Kuranit dhe Biblës qëndron në faktin se Kurani vazhdimisht pohon burimin e tij hyjnor nga Zoti i botës. (Shih këto ajete: Ali Imran, 164; Nisa, 82; Nisa, 105; Junus, 57; Nahl, 64; Fussilet, 53; Ali Imran, 3; Ibrahim, 1) Feja islame është fe e argumentuar me Kuran, ashtu siç u argumentua që Kurani është burim hyjnor, nga Zoti i Plotfuqishëm, sa kohë që në Bibël nuk gjejmë ndonjë citat që ta argumentojë krishterimin. Askund në Bibël nuk keni për të gjetur se Zoti i drejtohet popullit të Musait, ose pasardhësve të këtij populli, duke u thënë se feja e tyre quhet *judaiçëm*, ose se iu shpall pasuesve të Krishtit, që feja e tyre quhet *krishterim*. Me fjalë të tjera, nocionet *judaiçëm* dhe *krishterim* nuk kanë pasur origjinë dhe miratim hyjnor. Vetëm shumë kohë pas largimit të Jezusit nga kjo botë, fesë së tij iu vu emri *krishterim*. E, sa për Islamin, Kurani thotë: “*Feja e pranueshme tek Allahu është Islami, e atyre që u është dhënë libri, pasi mësuam për të vërtetën, ata vetëm nga zilia në mes tyre, kundërshtuan. E kush i mobon argumentet e Allahut, le ta dijë se Allahu shpejt do t’ia japë llogarinë.*” (Ali Imran, 19) “*E, kush kërkon fe tjetër; përveç fesë islame, atij kursesi nuk do t’i pranohet dhe ai në botën tjetër është nga të dështëpëruarit.*” (Ali Imran, 85)

Pas fjalimit në *Haxhin lamtumirës*, në të cilin i Dërguari e mbajti fjalimin e fundit, Zoti e shpalli ajetin e Kuranit: “*Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time dhe zgjodha për ju Islamin fe.*” (El Maide, 3) Këto citate të lartpërmendura tregojnë se Kurani përmban pohimin për vulën e autorësisë së Allahut dhe se feja islame është feja së cilës duhet t’i bashkohemi. Po ashtu, Zoti jo vetëm që e shpalli Kurantin, po edhe duke qenë se ai duhej të mbetej si mesazh për njerëzimin deri në fundin e botës, duhej të ruhej ashtu siç është shpallur, edhe premtimi i Zotit për ruajtjen e Kuranit është i mrekullueshëm tek thotë: “*Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kuranim dhe Ne gjithësesi jemi mbrojtës të tij.*” (El Hixhr, 9)

Dy funksione të pavënëre më parë të lidhorit

‘që’

ILMI REXHEPI

Lidhori ‘që’ është më popullori dhe më i vjetri ndër lidhorët e shqipes. Sipas mendimit më të mbështetur, ai është burimor dhe prandaj përbën pjesë të çmuar të identitetit shqiptar. Për shkak të veçorive leksikore e gramatikore që kanë lidhorët e shqipes, shkalla e zotërimit të tyre del të jetë treguesi më i qartë për shkallën e zotërimit të frymës së shqipes.

Është për t’u ndjerë keq kur dëgjon e lexon nga gjyqtarë, prokurorë, avokatë e zyrtarë policie të përdorin, thuajse në çdo paraqitje të tyre, ndërtime fjalish, nga të cilat do të krijoje përshtypjen se shqipja nuk ka fare lidhorë, ata thonë si për ta dëshmuar profesionalizmin: ‘... dhe i njëjti...’... dhe të njëjtit...’.

Megjithatë, në këtë punim nuk kemi për qëllim të parë të vëmë në pah vlera të përgjithshme të lidhorit ‘që’ dhe as të merremi me aspekte të zbatimit të normës.

Punimi, në mënyrë ballësore, hedh dritë për dy funksione sintaksore të lidhorit ‘që’. Për funksionin e gjymtyrës emërore të kallëzuesit emëror dhe për funksionin e përcaktorit kallëzuesor, të cilat funksione nuk i janë vënë re më parë këtij lidhori. Këto funksione

nuk i janë përmendur në gramatikat e shqipes, as në tekstet e tjera normative, as në studimet gjuhësore për lidhorët dhe as në shkrime të karakterit të kulturës së gjuhës, ku lidhorët të kenë qenë objekt shqyrtimi.

Me funksionin e gjymtyrës emërore të kallëzuesit emëror dhe me funksionin e përcaktorit kallëzuesor e kemi parë të dalë, siç do ta dëshmojmë, në gjuhën e shkruar dhe në gjuhën e folur dhe, çfarë kemi vërejtur karakteristike për lidhorin ‘që’ kur kryen këto funksione, nuk është i këmbyeshëm me lidhorin ‘i cili’.

Dëshmitë që jepen më poshtë në këtë shkrim e që provojnë se lidhori ‘që’ përdoret në gjuhën e gjallë, në të shkruar e në të folur, në funksionin e gjymtyrës emërore të kallëzuesit emëror dhe në

funksionin e përcaktorit kallëzuesor dhe vërejtja se ai në këto funksione nuk mund të zëvendësohet me lidhorin ‘i cili’; mjaftojnë si argumente që norma t’ia njohë dhe ta përligjë lidhorin ‘që’ në këto funksione. Prandaj, kërkojmë nga Këshilli Ndërrakademik që, në mbledhjen e radhës që u kushtohet çështjeve sintaksore, ta trajtojë edhe këtë çështje. Gjithashtu, me përmbajtjen e re që sjell ky punim, kërkojmë që të plotësohen kërret përkatës të “Gramatikës së Akademisë së Shqipërisë”, në të cilët shpjegohet se me ç’lloje përemrash shprehet pjesa emërore e kallëzuesit emëror dhe kallëzuesori.

Veç funksioneve të kryefjalës dhe të kundrinorit të drejtë, të cilat ia përligj norma, lidhori ‘që’, në gjuhën e shkruar dhe në gjuhën e folur, kryen edhe këto funksione: kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë, ndërtim parafjalor dhe me vlerë të lokucionit përemëror “gjë që” (ose të lidhorit “çka” a të ndërtimit “dhe kjo”), po këto funksione i janë vërejtur prej kohësh dhe ndaj tyre norma, sidoqoftë¹, ka marrë qëndrim: nuk i ka përligjur:

“.....si bualli që ia kanë hequr zgjedhën.....”²

“.....E sikur Allahu të mos i zmburpste disa të tjerë, do të rrënoheshin manastiret, kisha, havrat (sinagogat) e edhe xhamitë që në to përmendet shumë emri i Allahut.....”³

“Nga kuptimi i parë i kësaj fjale nuk duhet për t’u larguar, vetëm nëse faktet dhe provat e tjera në tekstin original



atë e kërkojnë, që në rastin konkret nuk është prezentë”.⁴

Në funksionin e një ndërtimi parafjalor, lidhori ‘që’ është lehtësisht i zëvendësueshëm me lidhorin ‘i cili’ dhe që të mos e përligjë në këtë funksion norma, ka ndikuar parimi i logjikëzimit të gjuhës. Që kur ka nisur të zhvillohet në shqipen mendimi sintaksor, ka nisur të shquhet më shumë prirja e zëvendësimit të lidhorit ‘që’ në këtë funksion me lidhorin ‘i cili’. Përdorimin e lidhorit ‘që’ në funksion të një ndërtimi parafjalor, pa e teorizuar, e kritikonte Faik Konica.

Kurse, për funksionin e kundrinorit të zhdrejtë pa parafjalë të lidhorit ‘që’, kujtojmë që norma duhet të ndryshojë qëndrimin: duhet ta përligjë lidhorin ‘që’ në funksionin e kundrinorit të zhdrejtë pa parafjalë, sepse përdorimi i tij në këtë funksion, veçqë ka mbështetje në gjuhën e gjallë, në të shkruar e në të folur, nuk i bie ndesh logjikës së gjuhës dhe zëvendësimi i tij me lidhorin ‘i cili’ në mjaft raste po ndjehet i dhunshëm, jonatyror. Shumë shkrimtarë, prej tyre Ismail Kadare, vazhdojnë ta përdorin me të madhe lidhorin ‘që’ në funksionin e kundrinorit të zhdrejtë pa parafjalë.

Përemri lidhor ‘që’, siç nuk e shënojnë gramatikat e shqipes, mund t’i takojë një fjalie të varur të shkallës së dytë

ndaj fjalisë kryesore me të cilën realizon lidhjen lidhori ‘që’, si në rastin:

*“Na ishte një çupë, që, ku shkelle, bëhej lëndinë, që, kur qeshte, derdhte trëndafila, që, kur qante, nxirrte margaritarë”.*⁵

T’i kthehemi thelbit të këtij shkrimi!

Funksionet me të cilat del lidhori “që” e të cilat nuk i janë vënë re, janë funksioni i gjymtyrës emërore të kallëzuesit emëror dhe funksioni i përcaktorit kallëzuesor.

Ç’janë funksioni i gjymtyrës emërore të kallëzuesit emëror dhe funksioni i përcaktorit kallëzuesor?

Kallëzuesi emëror formohet prej dy pjesësh, prej këpujës dhe prej gjymtyrës emërore. Të dyja këto pjesë formojnë një të tërë të vetme, ku kuptimi gramatikor dhe kuptimi leksikor shprehen prej dy fjalësh vërtet të ndryshme, po të lidhura ngushtë midis tyre.

Në funksionin e gjymtyrës emërore të kallëzuesit emëror mund të jetë një emër, një përemër, një mbiemër, një paskajore, një togfjalësh, që shprehin përmbajtjen leksikore të kallëzuesit emëror:

Shqipëria është vend i bukur. Rinia është pranvera e jetës. Është për të të ardhur keq niveli i arsimit në Kosovë...

Karakteristika kryesore e gjymtyrës emërore është përshtatja e saj me kryefjalën.

Ndërkaq, përcaktor kallëzuesor është gjymtyra e dytë e fjalisë me lidhje dyanësore që vihet në marrëdhënie rrethore me foljen në funksionin e

kallëzuesit (ose të një gjymtyre të dytë) dhe në marrëdhënie përcaktore me një emër a përemër kryesisht në funksionin e kryefjalës ose të kundrinës:

Dy zogj fluturuan të trembur.

Nga kallëzuesi emëror dallohet në këtë pikë, që, folja jam, duke pasur një kuptim abstrakt, është shndërruar pak a shumë në një tregues të mënyrës, të kohës dhe të vetës. Si këpujë, ajo nuk mund të funksionojë si gjymtyrë fjalie jashtë lidhjes me një fjalë tjetër, emër ose mbiemër. Përkundrazi, të gjitha foljet që pranojnë përcaktor kallëzuesor, kanë kuptim të plotë leksikor, gjë që lejon që ato të trajtohen si gjymtyrë fjalie, si kallëzues.

Ja shembujt me të cilët provohet që lidhori ‘që’ kryen funksionin e gjymtyrës emërore të kallëzuesit emëror dhe funksionin e përcaktorit kallëzuesor:

*“Ne duam vetëm të tërbeqim vëmendjen e përdoruesit të këtij fjalori që aty është dhënë fjala sinonimike shtyllë, të cilën ai, si njohës i shqipes që është, duhet ta përdorë jo vetëm siç duhet, por sipas rastit, edhe të shoqëruar ose jo me ndonjë fjalë tjetër karakterizuese, të cilën ia kërkojnë rrethanat ligjërimore përkatëse”.*⁶

*“Këndej ka shkuar dhe kodifikimi gjuhësor shqiptar, duke arritur atë që është gjuhë standarde, a gjuhë e njësuar që i thonë të tjerët”.*⁷

*“Shkova e i thashë se çka kisha ndie e më bashin sytë dhe ai si realiste besëtytës që ishte mëtha...”*⁸

“Këtu shohim përpjekjen, insistimin e rrëfimit [poetit] që njeriu të mos mbetet si koncept, si emër kuptimi që shpesh e gjejmë, gjatë gjithë

*historisë, vetëm në botën e fjalës së pavlerë që nuk thotë asgjë, sepse nuk është adekuate me qenien njerëzore”.*⁹

Zgjidhëm për faktimin e funksioneve në fjalë pikërisht gjuhën e autorëve të cituar, raporti i standardit me gjuhën e të cilëve është i natyrave ndër më të ndryshme, që të dëshmojmë se lidhori “që”, dalë me këto funksione, ka një përdorim jo të rrallë dhe në mbarë shqipen.

Nga një nga analizë jona në librin “LULET E VERËS”, na doli se lidhori “që” ka kryer të dy funksionet: funksionin e gjymtyrës emërore të kallëzuesit emëror një herë në parathënien e Sh. Bradës dhe funksionin e përcaktorit kallëzuesor një herë në vetë gjuhën e Naimit:

“Naimi si lirik i ëmbël që ishte, ka ditur...”¹⁰


“Edhe Sulltanit të mirë, Mbretit t’madh që kemi atë...”¹¹

Është për t’u theksuar se janë këto dy funksione të vetmet që mund t’i kryejë lidhori “që” e që nuk mund t’i kryejë lidhori “i cili”. Kur kryen këto funksione, lidhori “që”, herë mund të ndërëkëmbehet me ndonjë fjalë me vlerë përmendëse (anaforike) si fjalëza “siç” e herë është i pandërkëmbyeshëm. Këtu qëndron arsyeja, siç përmendëm më herët, pse duhet të përligjet në këto funksione.

Autori është mësimitdhënës i gjuhës arabe dhe i filozofisë në medresenë e Gjilanit.

Fusnotat:

- [1] Menella Totoni: Fraza me fjalë mbështetëse analitike përemërore, Studime filologjike 1-2, Tiranë 2000
- [2] Rexhep Qosja: Vdekja më vjen prej syve të tillë, Prishtinë 1998, fq. 106.
- [3] Dituria Islame, nr. 164 Mars 2004, Ballina.
- [4] Emin Behrami: Qasje studimore rreth katër përkthimeve të Kuranit në gjuhën shqipe, Prishtinë 1997, fq. 56.
- [5] Dritëro Agolli: Trëndafil në gotë, Tiranë 1978, fq. 63.
- [6] Ali Dhrimo, parathënia, Tiranë, 2002, Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe, Ali Dhrimo, Edmond Tupja, Eshref Ymeri.
- [7] Sabri Hamiti, Pejë 1996, Letra Shqipe, fq. 41.
- [8] Martin Camaj, Pejë 2000, Lirika, Magji në institutin e gjuhëve indo-evropiane, fq. 655.
- [9] Ibrahim Rugova, Parathënie, poezi, Ali Podrimja, Prizren, fq. 5. Pa vit botimi.
- [10] Lulet e Verës, Prishtinë 2002, Naim Frashëri, fq. 6.
- [11] Lulet e Verës, Prishtinë 2002, Naim Frashëri, fq. 60.



F J A L Ë T Ë A R T A

“Ndiqe rrugën e udhëzimit e mos të të dëshpërojë numri i paketë i ihtarëve të saj dhe ruaju prej rrugëve të devijimit e mos të të mashtrojë numri i madh i të lajthiturve.”

FUDAJL IBN IJADI

~

“Ne jemi një popull që Allahu e ka ngritur me Islam. Sa herë që e kërkojmë krenarinë diku tjetër, Allahu do të na poshtërojë.”

OMERI (ALLAHU QOFTË I KËNAQUR ME TË)

~

“Ai që i frikohet Allahut, Ai bën që çdokush t’ia ketë frikën atij, kurse ai që nuk i frikësohet Allahut, i frikësohet çdo gjëje.”

OMER IBN ABDUL-AZIZI

~

“Gjëja më e rëndë për robin janë gjynahet, kurse gjëja më e lehtë është pendimi. Ç’ka ai, që, më të rëndën nuk e largon me më të lehtë?!”

ZUBDEJA, MOTRA E BISHËR IBN HARITHIT

~

“Pendimi i mirë është ta njohësh gjynahun, vepra e mirë është të mos vetëmahnitesh me të dhe falënderimi i mirë është ta njohësh mangësinë tënde.”

OMERI (ALLAHU QOFTË I KËNAQUR ME TË)

“Nuk do të doja që babai im të më marrë në llogari (në Ditën e Gjykimit), ngase Zoti, karshi meje, është më i mirë sesa im atë.”

SUFJAN ETH-THEURIU

~

“Po t’ju kristalizoheshin zemrat, kurrë nuk do të ngopeshit me Fjalën e Zotit tuaj.”

OTHMANI (ALLAHU QOFTË I KËNAQUR ME TË)

~

“Errësirat janë pesë, por për secilën ka kandil:

Mëkatet janë errësirë..., kandili i tyre është pendimi.

Varri është errësirë..., kandili i tij është namazi.

Peshorja është errësirë..., kandili i saj është fjala “La ilahe il-LAl-lah”.

Ura e siratit është errësirë..., kandili i saj është bindja.

Abireti është errësirë..., kandili i tij janë punët e mira.”

EBU BEKRI (ALLAHU QOFTË I KËNAQUR ME TË)

“I devotshmi nuk merret me gabimtarët. E, njerëzit me më së shumti gabime janë ata që më së shumti i përmendin gabimet e të tjerëve.”

MUHAMED IBN SIRINI

~

“Ai që mendon se ngopja arrihet përmes ushqimit, do të mbetet i uritur; ai që mendon se pasuria e vërtetë është paraja dhe malli, do të mbetet i varfër; ai që u drejtohet krijesave kur është në nevojë, do të mbetet i privuar; ai që ndihmën nuk ia kërkon Allahut, do të mbetet i zhgënjyer.”

EBU JAKUB EN-NEHËRXHURI

~

*“Ai që është i kënaqur me veten e tij,
ka mangësi në të menduar.”*

ERDESHIRI

~

“Njeriu është i ditur për aq kohë sa është duke nxënë dije. Kur të mendojë se është bërë i dijsëm, mu atëherë bëhet i paditur.”

IBN MUBAREKU

“Nuk është dijetar kushdo që e njeh të mirën dhe të keqen, por dijetar është ai që e njeh të mirën dhe e pason, si dhe e njeh të keqen e i shmanget asaj.”

SUFJAN IBN UJEJNE

~

*Një i urtë ishte pyetur: “Prej kujt e mësove urtësinë?”
Ai i qe përgjigjur: “Prej të verbrit: ai nuk hedh asnjë hap pa e prekur së pari tokën me shkopin e tij.”*

~

“Dëshira më e shëmtuar është ta kërkosh dynjanë përmes punëve të ahiretit.”

SUFJAN ETH-THEURIU

~

“Shikimi i shpeshtë në të kotën e privon zemrën nga njohja e së vërtetës.”

IBRAHIM IBN EDHEMI

“Ditët, muajt, vitet dhe kohët më të këqija janë ato që janë më afër Kiametit.”

ABDULLAH IBN MESUDI

Është çudi me koprracin! E shpejton varfërinë, prej së cilës ikën; e humb pasurinë, të cilën e kërkon; bën jetë fukarenjsh në këtë dynja, kurse në botën tjetër llogaritet njëlloj si të pasurit.

~

Një njeri i urtë thoshte: “Prej gjërave më të çuditshme është mosçuditja me çuditërinë.”

~

Një njeri i urtë vëllait të vet i shkroi: “Vëlla! Rruaj vdekjes së kësaj bote para se të shkosh në botën ku do ta kërkossh atë (vdekjen), por nuk do ta gjessh.”

~

“Robi ka një Zot, që do ta takojë, dhe një shtëpi ku do të banojë. Ndaj, le ta kënaqë Zotin para se ta takojë dhe le ta ndërtojë shtëpinë para se ta banojë.”

IBN KAJIMI



Për të qeshur :)

Një njeri kaloi pranë Eshabit, i cili po e tërhiqte gomarin e tij dhe i tha me ironi:

-Gomarin po ta njoh, po ty jo!

-S'është për t'u çuditur, sepse gomarët njihen në mes vete, - ia ktheu ky.

Rrëfëhet se një torollak kishte dalë nga shtëpia e tij duke bartur në krah një fëmijë me këmishë të kuqe. Pas pak e harroi fëmijën, kështu që zuri ta pyeste çdo njeri që shihte:

-Mos e ke parë një fëmijë këmishëkuq?

-Mos është ai që po e mban në krah?, - ia ktheu njëri.

Toromani e ngriti kokën dhe e goditi fëmijën duke i thënë:

-Hajvan, të kam thënë që, kur të jesh me mua, mos m'u ndaj?

Një qelepïrxhi kaloi pranë disa njerëzve që po hanin derëmbyllur. Hyri tek ata nëpërmjet murit dhe u tha:

-Ma pamundësuat ardhjen nga toka, ndaj ju erdha nga qielli!

Disa hajdutë hynë në shtëpinë e Ebu Seidit dhe morën gjithë çka kishte në të. Kur dolën, me ta doli edhe ai. Filloi t'u shkojë pas duke bartur me vete disa gjëra që i kishin lënë ata. I thanë:

-Ku po shkon, o njeri dhe ç'do prej nesh?!

-Nuk më latë gjë në shtëpinë time, andaj erdha të banoj në shtëpinë tuaj, - ua ktheu.

Ata filluan të qeshin dhe kështu ia kthyen gjësendet e vjedhura.

Një grua shtatzënë, teksa ia shikonte fytyrën e shëmtuar të të shoqit, i tha:

-Mjerë për mua, nëse të ngjan ty ky që e kam në bark.

-Vërtet, mjerë për ty, nëse nuk më ngjan! - ia ktheu.

Një budalla i tha Shabiut:

-Çfarë mendon, a do të shpërblehet personi që më shau qysh në ditën e parë të Ramazanit?!

-Në qoftë se të ka thënë ahmak, besoj se po, - ia ktheu ai.

Një myshteri hyri në një restorant dhe e vari pallton në mur për të hyrë në nevojtoje. Në atë çast u ngrit shoku i tij dhe në pjesën e prapme të palltos ia vizatoi fytyrën e gomarit. Kur u kthye ai dhe e vërejti vizatimin, bërtiti:

-Cili gomar e ka fshirë fytyrën me pallton time?

Disa fqinjë të Nastradinit e lutën atë t'ua huazonte për pak kohë gomarin. Ai u arsyetua se gomari ishte në arë. Ndërsa Nastradini po fliste me fqinjët e tij, gomari filloi të pëlliste. Atëherë, fqinjët filluan ta qortonin atë:

-Si ke fytyrë të na thuash që gomari është në arë, kur ai qenka në shtëpi?!

-Subhanallah, si nuk më besoni mua, por i besoni gomarit?! - u tha Nastradini.

Një toroman ankohej nga pagjumësia. Shoku i tij e këshilloi që të numëronte deri në 500, për ta zënë gjumi. Porse, kur torollaku numëroi deri në 100, filloi ta zërë gjumi, kështu që u ngrit dhe e lau fytyrën, që ta vazhdojë numërimin deri në 500...

Thuhet se një hajdut e kishte vjedhur një gomar, mirëpo, me ta çuar në treg, ia kishin vjedhur. Kur u kthye në shtëpi, gruaja e pyeti:

-Sa e shite gomarin?

-Aq sa e bleva, - ia ktheu ky.

Një ditë Nastradini kishte shkuar për të blerë qumësht te një shitës mashtrues dhe i tha:

-E dua një shishe qumësht.

-Po ti dy shishe i paske me vetel! - i tha shitësi.

-Njërën e kam për qumësht, kurse tjetrën për ta qitur ujin, - ia ktheu Nastradini.

